



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

RAPORTI 2025 VJETOR

I AGJENCISË KADASTRALE
TË KOSOVËS



Prishtinë, Janar 2026



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

RAPORTI 2025 VJETOR

I AGJENCISË KADASTRALE
TË KOSOVËS

Prishtinë, Janar 2026

SHKURTESAT

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
DL	Drejtorati Ligjor në AKK
DK	Drejtorati i Kadastrit në AKK
DBF	Departamenti për Buxhet dhe Financa
DTI	Drejtorati i Teknologjisë së Informacionit
NJIP	Njësia e Implementimit të Projekteve
ZKK	Zyrat Kadastrale Komunale
IKIH	Infrastruktura Kombëtare e Informacioneve Hapësinore
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
RK	Rindërtimi i Kadastrit
UA	Udhëzimet Administrative
DRC	Qendra për Rimëkëmbje në Rast Fatkeqësish (ang. Disaster Recovery Center)
DTM	Modeli Digjital i Terrenit (ang. Digital Terrain Model)
DSM	Modeli Digjital i Sipërfaqeve (ang. Digital Surface Model)
DEM	Modeli Digjital i Lartësive (ang. Digital Elevation Model)
SOA	Arkitekturë e Orientuar në Shërbime (ang. Services Oriented Architecture)
SIKTK	Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë
SIKTK-HK	Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë – Harta Kadastrale
SIKTK-T	Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë – Tekstuale
ARIS	Sistemi i Informacioneve për Regjistrin e Adresave
SUUSHK	Sistemi i Unifikuar i Ueb Shërbimeve Kadastrale
KOPOS	Sistemi i Pozicionimit Satelitor në Kosovë
GG	Platforma e Interoperabilitetit (ang. Government Gateway)
ZQP	Zona e Qarkullimit Publik
REGIP	Projekti për Regjistrimin e Pronës dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore (ang. Real Estate Cadastre & Geospatial Infrastructure)
PI/GG	Platforma e Interoperabilitetit – Government Gateway
GIS	Sistemi i Informacioneve Gjeografike
ASHI	Agjencia për Shoqëri të Informacionit
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
BB	Banka Botërore


1	FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV	08
2	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	14
	2.1. Mandati dhe përgjegjësitë	14
	2.2. Struktura organizative	15
3	AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE	24
	3.1. Udhëzuesi për Rindërtimin e Kadastrit	24
	3.2. Udhëzuesi për administrimin e qasjeve në sistemet e informacionit të AKK-së, për zyrtarët publik të ZKK, AKK dhe personave të tjerë të autorizuar	25
4	ORGANIZIMET/AKTIVITETET NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL	28
	4.1. Takimet e Komitetit Ndërmarrës për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës	28
	4.2. Takimet koordinuese të donatorëve	32
	4.3. Takime koordinuese me Kryetarë të Komunave	34
	4.4. Takime koordinuese me zyrtarët e Zyreve Kadastrale Komunale për Projektin e Rindërtimit	37
	4.5. Takime koordinuese me gjeodetë dhe kompani gjeodete të licencuara	38
	4.5.1. Takim me Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës	38
	4.5.2. Sistemi ri për gjeodetët, një arsye tjetër takimi me komunitetin e gjeodetëve	39
	4.6. Thellimi i bashkëpunimit me Institucione të ndryshme publike nëpërmjet Marrëveshjeve të bashkëpunimi	41
	4.6.1. Memorandum bashkëpunimi me Kompaninë e sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria	41
	4.6.2. Memorandum bashkëpunimi me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK)	42
	4.6.3. Memorandume bashkëpunimi për Sistemin e adresave me Komunitat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok	43
	4.6.4. Memorandum bashkëpunimi me Institutin për Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë	45
	4.6.5. Memorandum bashkëpunimi me Ndërmarrjen Hidroekonomike "Ibër Lepenc"	46
	4.6.6. Memorandum bashkëpunimi për Renovimin e Zyres Kadastrale Komunale në Mitrovicë të Veriut	47
	4.6.7. Memorandum bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës	48
	4.6.8. Memorandum bashkëpunimi me Odën e Ndërmarrësuesve të Kosovës	49
	4.6.9. Memorandum bashkëpunimi me Odën e Përmbaruesve Privat	50
	4.6.10. Memorandum bashkëpunimi me Odën e Notarëve të Kosovës	51
	4.6.11. Memorandum bashkëpunimi me BIRN Kosovo	52

5	PROJEKTET KAPITALE	54
	5.1. Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive	55
	5.2. Zhvillimi dhe avancimi i Sistemeve të Informacionit Kadastral	60
	5.3. Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së	87
	5.4. Rindërtimi i kadastrit	91
	5.5. Kontrolli i kualitetit për Rindërtimin e Kadastrit	107
	5.6. Konvertimi i të dhënave në SIKTK për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave	128
	5.7. Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit	132
	5.8. Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare	135
	5.9. Kompletimi i adresave në Komunitat Veriore (Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan) dhe Novobërdë	144
	5.10. Prodhimi dhe instalimi i tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave	146
	5.11. Skanimi dhe indeksimi i dokumenteve arkivore kadastrale	148
	5.12. Renovimi i hapësirave të Zyres Kadastrale Komunale të Mitrovicës së Veriut	149
6	ORGANIZIMI DHE PËRFAQËSIMI NË KONFERENCA, PUNËTORI, GRUPE PUNUESE DHE VIZITA STUDIMORE	152
	6.1. Konferenca për lancimin e projektit për "Digjitalizimi i Shërbimeve Kadastrale"	152
	6.2. Konferenca për fillimin e projektit "Rindërtimi i Kadastrit në 115 ZK"	156
	6.3. Konferenca për media rreth projektit "Ndërlidhja e Qytetarit me Adresë Zyrtare"	158
	6.4. Shënimi i Ditës Botërore të Gjeodetit	159
	6.5. Pjesëmarrja në Takimin Teknik të Prodhuesve të të Dhënave të EuroGeographics, në Bruksel	162
	6.6. Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar dhe Konferencën INTERGEO 2025	164
	6.7. Vizita studimore në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive në Maqedoninë e Veriut	165
	6.8. Pjesëmarrja në Asambleenë e Përgjithshme të EuroGeographics në Riga, Latvi	166
	6.9. Pjesëmarrja në trajnim profesional në Cyrih, Zvicër	167
7	KOORDINIMI I PROJEKTEVE	168
	7.1. Projekti REGIP	168
	7.2. Bashkëpunimi me OSBE-në	173
8	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	176
	8.1. Aktivitetet rreth sigurisë	176
	8.2. Mirëmbajtja e dhomës së serverëve	176
	8.3. Monitorimi i infrastrukturës së TI	177
	8.4. Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC	178
	8.5. Administrimi i Sistemeve të Informacionit (SI), databazave dhe qasjeve	179

9 BUXHET DHE FINANCA	192
9.1. Buxheti	192
9.2. Raporti vjetor financiar për vitin 2025	196
9.3. Prokurimi publik	196
10 TRAJNIMET E OFRUARA	200
10.1. Trajnimet e stafit të ZKK-ve	200
10.2. Trajnim për Stafin e Operatorëve Ekonomik - Projekti për Rindërtimin e Kadastrit	200
11 LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE	202
11.1. Reformimi i procesit të licencimit (pezullimi i licencave)	202
11.2. Trajnimet e gjeodetëve dhe shpërndarja e licencave	203
12 MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR	208
13 PËRMBLEDHJE E SHËRBIMEVE DHE STATISTIKAVE PËR TË DHËNAT E OFRUARA NGA AKK	214
13.1. Statistika nga SIKTK	214
13.2. Statistika për numrin e kërkesave dhe nga institucionet dhe lëndëve të regjistruara nëpërmjet sistemeve nga përdoruesit e jashtëm	215
13.3. Statistika nga DL	218
13.4. Statistika nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të ZKK-së	219
13.5. Statistika nga DK	220
13.6. Statistika nga Sistemi i Pozicionimit Satelitor në Kosovë – KOPOS	221
13.7. Statistika nga DFA	222
14 MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE GJITHËPËRFSHIRJE	224
14.1. Intervistat në media	224
14.2. Uebfaqja zyrtare e AKK-së	228
14.3. Profili zyrtar i AKK-së në Facebook	229
14.4. Gjeoportali shtetëror	229
14.5. Barazia gjinore	230
14.6. Qasja në dokumente publike	231

15 PËRKUJTIM	234
16 KALENDARI ME NGJARJE TË NDRYSHME	238
17 PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026 - REFORMAT DHE PROJEKTET	274

The future of
Property
DigitAll



e Ardhmja e
Pronës
Çdo gjë Digjitale

1 FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore, partnerë ndërkombëtarë, bashkëpunëtorë dhe qytetarë,

Me kënaqësi paraqesim Raportin Vjetor të Agjencia Kadastrale e Kosovës, i cili pasqyron punën, arritjet dhe sfidat tona gjatë vitit që lamë pas. Ky raport përmbledh angazhimin tonë të vazhdueshëm për forcimin e sistemit kadastral, rritjen e transparencës, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe avancimin e digjitalizimit në fushën e administrimit të pronës.

Gjatë këtij viti, Agjencia ka vijuar me zbatimin e reformave të rëndësishme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me prioritetet strategjike të Qeverisë së Republika e Kosovës. Përmes modernizimit të sistemeve të informacionit gjeografik, përditësimit të të dhënave kadastrale dhe forcimit të bashkëpunimit me komunitat, kemi synuar të sigurojmë një administrim më efikas, më të saktë dhe më të besueshëm të pronës së paluajtshme.

Një theks i veçantë i është kushtuar digjitalizimit të shërbimeve, shkurtimit të afateve të trajtimit të kërkesave dhe rritjes së qasjes së qytetarëve në informacion kadastral. Po ashtu, kemi vazhduar bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe për zbatimin e praktikave më të mira evropiane në fushën e kadastrës dhe regjistrimit të pronës.

Pavarësisht sfidave, përkushtimi i stafit tonë dhe mbështetja e institucioneve partnere kanë bërë të mundur arritjen e objektivave të përcaktuara. Ne mbetemi të vendosur që edhe në vitin e ardhshëm të punojmë me integritet, profesionalizëm dhe përgjegjësi për të garantuar siguri juridike në të drejtat pronësore dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Duke ju falënderuar për besimin dhe bashkëpunimin tuaj, ju ftojme të njiheni me përmbajtjen e këtij raporti, i cili pasqyron përkushtimin tonë për një sistem kadastral modern, transparent dhe në shërbim të qytetarëve.

Mbështetja dhe përkrahja ndërinstitucionale, janë manifestuar me mbështetje konkrete edhe këtë vit. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vazhduar serinë e takimeve periodike dhe ka gëzuar përkrahjen nga Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Z. Liburn Aliu, edhe në organizimet e Komiteteve ndërminstrore për

Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, gjithashtu takimeve me kryetarë të komunave e edhe takimet me gjeodetë të licencuar. Përmes këtyre takimeve kemi shënuar një bashkëpunim të thellë e të ndërsjellë, në angazhimin e plotë të Ministrisë dhe Agjencisë për transformimin dhe fuqizimin e kadastrës në vend.

Një ngjarje shumë e veçantë e viti 2024 ishte organizimi i Konferencës së parë me tematikë “Avancimet në digjitalizimin e shërbimeve kadastrale”, me më shumë se 150 pjesëmarrës nga të gjitha vendet e rajonit dhe jo vetëm, meqë pjesëmarrës kishte edhe nga institucionet e larta të kadastrit nga Turqia, Holanda, Norvegjia, Sllovenia, mandej ekspertë të Bankës Botërore, nga platforma “Land Portal”, nga Universiteti i Prishtinës, etj.

Duke kombinuar inovacionin, bashkëpunimin rajonal dhe mbështetjen e donatorëve, ky event i jashtëzakonshëm solli në pah arritjet e shumta të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, shkëmbime të vlefshme të përvojave e eksperiencave të ndryshme me të gjithë pjesëmarrësit dhe frymëzim për suksese të mëtejshme në digjitalizimin e shërbimeve dhe të ardhmen e kadastrit.

Me qëllim të avancimit të digjitalizimit të shërbimeve dhe lehtësimit të procedurave administrative për qytetarët, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ndërmarrë një sërë inovacionesh gjatë këtij viti, disa prej të cilave janë përfunduar e disa janë në proces. Përrshembull është digjitalizuar forma e aplikimit për licencim të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete, i cili sistem është zhvilluar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe GIZ-it ku qëllimi kryesor i sistemit është të thjeshtojë proceset e aplikimit, të rrisë transparencën dhe të mbështesë zhvillimin profesional të gjeodetëve.

Përveç kësaj, edhe në vitin 2024 ka vazhduar monitorimi i performancës së disa Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK), Kompanive të Licencuara Gjeodete dhe Gjeodetëve të Licencuar. Jemi në përgatitje dhe dorëzim të gjetjeve të monitorimit tek ZKK-të dhe gjeodetët e licencuar, bashkë me vërejtjet dhe rekomandimet sipas legjislacionit në fuqi.

Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm për të garantuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave kadastrale, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, përfshirë korrigjimin/unifikimin e personave të regjistruar dy ose më

shumë herë në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë me të njëjtin numër personal, si dhe unifikimin e emërtimeve të personave juridikë. Ky vit ka shënuar gjithashtu arritjen e një suksesi të rëndësishëm, ku dy institucione të rëndësishme për shtetin, KEK-u dhe Trepça, morën certifikatat e unifikuara të pronësisë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK).

Edhe pse viti 2024 ka adresuar një mori çështjesh dhe janë shënuar rezultate fantastike, ende mbetet punë për t'u bërë. Në vitin 2025, planifikojmë të përmbyllim me sukses shumicën e projekteve të filluara vitin e kaluar dhe të fillojmë një nga projektet më të mëdha të Bankës Botërore, atë të Projektit REGIP, që është Rindërtimi i Kadastrit.

Megjithatë, përkundër sfidave dhe volumit të madh të punëve dhe aktiviteteve që priten për Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) edhe këtë vit, ne jemi të angazhuar të shfrytëzojmë kapacitetin maksimal për të arritur të gjitha qëllimet tona, për të realizuar me sukses të gjitha projektet, për të avancuar infrastrukturën teknike dhe për të vazhduar digjitalizimin e shërbimeve. Po ashtu, do të vazhdojmë bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjithë partnerët tanë, vendorë dhe ndërkombëtarë, për t'u ofruar qytetarëve shërbime kadastrale të nivelit më të lartë.

Për vitin 2025, misioni dhe vizioni i Agjencisë Kadastrale do të jetë digjitalizimi i të gjitha shërbimeve kadastrale. I përqendruar në realizimin e një sistemi kadastral tërësisht të digjitalizuar si një hap kyç në ofrimin e shërbimeve më të avancuara, ky proces transformues do të mundësojë shërbime më të shpejta, më të sakta dhe më të sigurta. Duke shfrytëzuar teknologjitë më të avancuara, Agjencia do të rrisë transparencën, njëherit përmirësojë komunikimin me qytetarët dhe kontribuojë në ndërtimin e një infrastrukture kadastrale më të qëndrueshme dhe më të besueshme për të gjithë. Viti 2025 do të jetë një vit i transformimit të thellë, që do të vendosë themelin për një sistem kadastral modern e të digjitalizuar, në përputhje me standardet më të larta.



Avni AHMETI



Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kadastrale e Kosovës



2

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2.1. Mandati dhe përgjegjësitë


Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Qeverisë së Kosovës, njëherit Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, hartografi dhe GIS, sistemin e unifikuar të adresave, infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës (SIKTK) dhe për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për ofrimin e shërbimeve kadastrale.

Duke u bazuar në ligjin në fuqi AKK, ka deleguar tek Zyrat Komunale Kadastrale detyrat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në SIKTK sipas legjislacionit në fuqi, të cilat ofrojnë shërbime për person fizik dhe juridik, si dhe për institucionet publike tashmë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.


Të drejtat, përgjegjësitë dhe në përgjithësi mandati i AKK-së është i rregulluar me Ligjin për Kadastër të Pronës Paluajtshme dhe me akte të tjera nënligjore, të gjitha të qasshme përmes linkut:

<https://akk.rks-gov.net/sq/dokumente/legjislacioni>



2.2. Struktura organizative

Struktura organizative e AKK-së është konceptuar për të garantuar efikasitet, koordinim dhe transparencë, duke reflektuar standardet më të larta të administrimit publik.



Organizimi i AKK-së përfshin pesë departamente kryesore, secila me role dhe përgjegjësi të qarta në përputhje me fushën e veprimtarisë institucionale:



DEPARTAMENTIN PËR KADASTËR



DEPARTAMENTIN PËR GJEONFORMACION



DEPARTAMENTIN PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME,



DEPARTAMENTIN LIGJOR



DEPARTAMENTIN PËR BUXHET DHE FINANCA

Më poshtë do të përshkruhet shkurtimisht veprimtaria e secilit departament:

1. Departamenti për Kadastër

Ky departament merret me koordinimin dhe zbatimin e regjistrave kadastralë dhe të pronës. Aktivitetet kryesore përfshijnë mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave për pronat dhe parcelat në të gjithë territorin e Kosovës.

2. Departamenti për Gjeoinformacion

Ky departament është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe Gjeoportalit të AKK-së. Ky departament administron Regjistrin e Adresave përmes Sistemit të Unifikuar të Adresave (ARIS), krijon dhe mirëmban të dhënat hartografike, si dhe menaxhon infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor.

3. Departamenti për Teknologji të Informacionit dhe Shërbime të Përgjithshme

Ky departament siguron një infrastrukturë të qëndrueshme dhe të sigurt të Teknologjisë së Informacionit (TI), duke përfshirë administrimin e Qendrës së Parë dhe të Dytë të të Dhënave. Përgjegjësitë e tij përfshijnë menaxhimin e sistemeve të informacionit, databazave, shërbimeve elektronike dhe ofrimin e mbështetjes teknike për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të autorizuar. Për më tepër, ky departament mbulon mbështetjen administrative dhe menaxhimin e burimeve logjistike.

4. Departamenti Ligjor

Ky departament është përgjegjës për koordinimin e procesit të hartimit të legjislacionit në fushën e veprimtarisë së AKK-së. Ky departament siguron përputhshmërinë me standardet për hartimin e legjislacionit dhe ofron këshilla ligjore e mbështetje profesionale për strukturat e tjera brenda AKK-së.

Departamenti ligjor bën propozime në Programin Legjislativ të Qeverisë projektligje nga fushë veprimtaria e AKK-së, propozimin e akteve nënligjore për Planin Legjislativ për Aktet Nënligjore si dhe bashkëpunimi me Zyrën Ligjore të Ministrisë për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Programit Legjislativ dhe për aktivitete tjera që ndërlidhen me procesin e hartimit të legjislacionit.

Në bashkëpunim me departamentet, njësitë apo personat përgjegjës për hartimin e projekt akteve normative, siguron respektimin e teknikave dhe standardeve të hartimit të legjislacionit, përputhshmërinë e akteve normative të propozuara nga AKK-ë me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Bënë shqyrtimin e kërkesave dhe vendosjen e ankesave, si organ i shkallës së dytë në procedure administrative, si dhe përfaqësimin AKK-së në kontestet gjyqësore, përkatësisht konflikte administrative.

5. Departamenti për Buxhet dhe Financa

Ky departament është përgjegjës për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe rregulloret përkatëse si dhe luan një rol kyç në administrimin financiar të AKK-së.

Në kuadër të 5 departamenteve të cekura më lartë, është paraparë të jenë gjithsej 14 sektorë të specializuar. Çdo sektor ka një strukturë të mirëpërcaktuar përgjegjësish dhe kompetencash për të siguruar efikasitet maksimal në realizimin e objektivave institucionale.

Sipas rregullores aktuale, AKK-ja ka një kuotë prej 62 zyrtarësh të aprovuar, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhat e mëparshme. Kjo rritje pasqyron angazhimin e institucionit për të adresuar kërkesat në rritje për shërbime cilësore dhe për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm. Struktura organizative e AKK-së është dizajnuar për të garantuar një ndarje të qartë të përgjegjësisë dhe për të mbështetur qëndrueshmërinë operacionale. Me këtë organizim, AKK-ja synon të rrisë efikasitetin, të përmirësojë transparencën dhe të avancojë cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe institucionet partnere.

Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron në bazë të Rregullores me Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të aprovuar me datë 08.12.2014. Bazuar në këtë rregullore AKK në strukturën e saj organizative ka gjithsej 5 departamente dhe 14 sektorë.


Numri i të punësuarve të aprovuar nga Buxheti për vitin 2024 është 52 punëtorë. Numri aktual i të punësuarve është 46, prej tyre: 31 Meshkuj & 15 Femra. Pozitat vakante janë pozita e asistentes në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv, Drejtor i Departamentit Ligjor, Drejtor i Departamentit për Gjeoinformacion si dhe një Shef Sektori.

Në Agjencinë Kadastrale janë të angazhuar edhe njëzet e nëntë (29) zyrtarë si staf mbështetës të cilët janë të financuar nga Huamarrja e realizuar nga Banka Botërore, prej tyre janë 17 meshkuj dhe 12 femra.


Po ashtu në njësitin e adresave janë të angazhuar edhe 55 zyrtar të cilët janë të angazhuar në 34 Komuna, financuar po ashtu nga Huamarrja-BB.

Roli i tyre në AKK është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e projekteve të AKK-së.


Profili i moshës së nëpunësve



Gjinia e nëpunësve



Përkatësia etnike e nëpunësve



Pagat 2025

Agjencia Kadastrale e Kosovës me kodin Buxhetor 10-205-60100-0610 ka të aprovuar:

Emërtimi i pozitës	Pozita	Klasa	Koeficienti	Nr. i pozitave
Drejtues i lartë	Drejtori i Përgjithshëm	I 2	12	1
Drejtues i mesëm	Drejtor i departamentit	I 8	8.3	3
Drejtues i ulët	Udhëheqës i divizionit	I 10	7.35	6
Specialist	Ekspert i GIS/it	I 11	7	7
Profesional 1	Zyrtar të lartë	I 13	5.7	8
Profesional 2	Zyrtar	I 15	5.1	7
Profesional 3	Zyrtar	I 17	4	6
Nëpunës teknik dhe mbështetës	Vozitës	I 21	3.86	3

Lista e ekspertëve e aprovuar nga qeveria me vendim
Nr.23/165 i datës 12.10.2023 si:

Zyrtari	Emri i pozitës	Klasa	Koeficienti	Nr. i pozitave të propozuara
Ekspert 2	Drejtor i Drejtoratit për Teknologji të Informacionit	B2 ,	15.5	1
Ekspert 4	Administrator i lartë i TI për siguri	B4,	14	2
Ekspert 4	Zhvilluese/administratore e lartë e data bazave	B4,	14	1
Ekspert 5	Administratore e Lartë e TI-së për Baza të Dhënave	B5,	12	1
Ekspert 5	Administratore e Lartë e TI-së për Sisteme Softuerike	B5,	12	1
Ekspert 5	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	B5,	12	1

Ristrukturimi

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ndërmarrë një sërë veprimesh të rëndësishme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim të rregullimit të strukturës organizative, harmonizimit të vendeve të punës dhe avancimit të menaxhimit të stafit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Me Vendimin Nr. 56/24, të datës 19.08.2024, është formuar Grupi i Vlerësimit për hartimin e përshkrimeve të vendeve të punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Grupi ka zhvilluar takime të rregullta pune dhe, në përputhje me Rregulloren Nr. 13/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, si dhe me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ka hartuar përshkrimet e vendeve të punës, të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP).

Pas shqyrtimit nga DMZP-ja, është pranuar njoftimi se përshkrimet e vendeve të punës janë në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Në pajtim me nenin 21, paragrafi 5 të kësaj rregulloreje, është dhënë pëlqimi i DMZP-së për aprovim të përshkrimeve të vendeve të punës.

Në vazhden e këtij procesi, me Vendim të datës 23.12.2024, është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Komisioni, në pajtim me nenin 66, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe me Rregulloren Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ka zhvilluar një sërë takimesh pune për realizimin e procedurave të ristrukturimit institucional, duke u bazuar në strukturën organizative të miratuar.

Më datë 21.03.2025, Raporti i Ristrukturimit është aprovuar nga DMZP-ja. Pas aprovimit të raportit, më datë 25.03.2025, DMZP-ja ka lëshuar vendimet përkatëse për zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në përputhje me rezultatet e procesit të ristrukturimit.

Gjatë muajit maj 2025 janë lëshuar akt-emërimet për të gjithë zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, vendimet e DMZP-së dhe Raportin e aprovuar të Ristrukturimit, duke siguruar kështu zbatimin e plotë të strukturës së re organizative dhe sistematizimin e burimeve njerëzore.

Rekrutimet

Gjatë vitit 2025, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka zhvilluar gjithsej gjashtë (6) procedura të rekrutimit, me qëllim plotësimin e nevojave për staf dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të institucionit.

Në kuadër të këtyre procedurave, rekrutimi për pozitën Zyrtar/e i/e Lartë për Gjeodezi, në kategorinë Specialist, është përfunduar me sukses, ku janë përzgjedhur dhe pranuar dy (2) zyrtarë. Po ashtu, procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar/e i/e Lartë Ekzekutiv është përmbyllur me sukses, me përzgjedhjen dhe pranimin e një (1) zyrtareje.

Ndërkohë, procedurat e rekrutimit për pozitat Zyrtar i Lartë i Pasurisë dhe Zyrtar Administrativ nuk kanë rezultuar të suksesshme, për shkak se asnjë nga kandidatët nuk ka arritur të kalojë testin me shkrim, sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat përkatëse të rekrutimit.

Procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar për Arkiv është përfunduar fillimisht me sukses, me përzgjedhjen dhe pranimin e një (1) zyrtari. Megjithatë, kjo procedurë është anuluar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), pas aprovimit të ankesës së paraqitur nga një kandidat pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit.



3

AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

3 AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Në vitin 2024 është dekretuar Ligji për kadastrë të pronës së paluajtshme dhe janë miratuar 11 Udhëzime administrative për implementimin e tij.

Ligji për Kadastrë të Pronës Paluajtshme ka adresuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e kadastrës duke përfshirë organizimin institucional të kadastrës në Republikën e Kosovës, përmbajtjen e kadastrit, matjet kadastrale, regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe të drejtave pronësore mbi ato prona në kadastrë, rindërtimin e kadastrit, etj.

Elementet themelore që ky ligj i trajton dhe rregullon janë:

- Procedurat e unifikuara administrative në ZKK, pasi që aktualisht ekzistojnë dy ligje (Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastrë dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme), ndërsa me këtë projektligj, do të kemi një procedurë unike dhe të integruar në një sistem,
- Organizimi vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me qëllim të rritjes së performancës, përgjegjësisë në punë, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë, duke u bazuar në sistemin kadastral të shteteve të rajonit dhe më gjerë dhe
- Trajtimi problemit më të theksuar në të drejtat pronësore që është informaliteti i lartë, prandaj formalizimi i të drejtave pronësore është synim parësor në sektorin e të drejtave pronësore pasi që të drejtat pronësore të pa formalizuara janë jashtë qarkullimit juridik, e cila do të realizohet përmes fuqizimit të rolit të komisionit për Rindërtimin e Kadastrit.

Si vazhdimësi e vitit paraprak për të kompletuar reformën ligjore përveç Udhëzimeve administrative AKK-ja ka publikuar edhe 2 Udhëzues të punës njërin për: Matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës) dhe tjetrin për Rindërtimin e Kadastrit.

3.1. Udhëzuesi për Rindërtimin e Kadastrit

Udhëzuesi për Rindërtimin e Kadastrit është publikuar në Janar të vitit 2025 dhe ka për qëllim që të sqarojë të gjitha procedurat gjatë implementimit të projekteve të RK me anë të të cilit ekspertët dhe zyrtarët profesional nga AKK, ZKK, operatorët ekonomik dhe akterët tjerë të interesit do ta kenë shumë më të lehtë realizimin e detyrave dhe obligimeve që kanë gjatë realizimit të projektit. Këto detyra dhe obligime përfshijnë të gjitha fazat që nga planifikimi i ZK për RK, informimi publik, fushata e matjeve, përpunimi i të dhënave, kontrolla e kualitetit, shikimi publik, zyrtarizimin e të dhënave të përfituara nga projekti etj.

Gjatë përpilimit të këtij udhëzuesi ka patur githëpërfshirje profesionale, pasi që kontribues me komente dhe sygjerime profesionale kanë qenë ekspertë nga AKK, ZKK, Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës, gjeodetë të licencuar dhe palë tjera të interesit.



3.2. Udhëzuesi për administrimin e qasjeve në sistemet e informacionit të AKK-së, për zyrtarët publik të ZKK, AKK dhe personave të tjerë të autorizuar

Gjithashtu gjatë vitit 2025 u publikua edhe Udhëzuesi për administrimin e qasjeve në sistemet e informacionit të AKK-së, për zyrtarët publik të ZKK, AKK dhe personave të tjerë të autorizuar.

Ky Udhëzues ka për qëllim të përcaktoj procedurat për administrimin e qasjeve në sistemet e informacionit të AKK-së, për zyrtarët publik të ZKK, AKK dhe personave të tjerë të autorizuar.

Sipas këtij Udhëzuesi për të gjithë përdoruesit e rinj AKK fillimisht do të mbajë trajnime në SIKTK, pastaj ata duhet të nënshkruajnë Deklarata konfidencialiteti për të marrë kredencialet për kyçje në sistem.





4

**ORGANIZIMET/AKTIVITETET
NË KUADËR TË
BASHKËPUNIMIT
NDËRINSTITUCIONAL**

4 ORGANIZIMET/AKTIVITETET NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL

4.1. Takimet e Komitetit Ndërmnishtor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës

Me Vendimin Nr. 10/94 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 24 gusht 2022, është formuar Komiteti Ndërmnishtor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës. Komiteti kryesohet nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ai është organ koordinues, këshillimor dhe ushtron veprimtarinë e tij sa herë që është e nevojshme për këshillimin e autoritetit përgjegjës lidhur me Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Komitetit janë:

- Ofrimi i këshillave për orientimet kryesore lidhur me administrimin e tokave dhe zhvillimin e avancimin e sistemit të IKIH në Republikën e Kosovës;
- Identifikimi i politikave dhe çështjeve strategjike;
- Ofrimi i këshillave dhe propozimi i politikave të reja, autoriteteve përgjegjëse që kanë të bëjnë me administrimin e tokave dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës;
- Koordinimi dhe monitorimi i të gjitha iniciativave brenda fushës së administrimit të tokës dhe IKIH-së me qëllim të sigurimit dhe harmonizimit të politikave nacionale, lokale, publike dhe private;
- Promovimi i çështjeve specifike për bashkëpunim dhe partneritet publiko privat;
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse në hartimin e Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës;
- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për kadastrë dhe zhvillim të qëndrueshëm, planit të veprimit si dhe Strategjisë për infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor.

Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturë Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2025 ka mbajtur takimin e pestë dhe të gjashtë të radhës që nga themelimi i tij. Paraprakisht nën organizim të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, janë mbajtur takime të ndara me përfaqësuesit e institucioneve që janë pjesë e këtij Komiteti për të diskutuar dhe përcaktuar draft agjendën e takimeve të Komitetit.

Takimi i pestë me radhë është mbajtur me datë 19 qershor 2025, ku në hapjen e punimeve të Komitetit ka marrë pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Izedin Bytyqi i cili ka theksuar se Administrimi i tokës nuk është vetëm një çështje teknike, por edhe një çështje ekonomike e sociale dhe është bazë e qëndrueshmërisë së shtetit, garantues i sigurisë ligjore për pronën dhe një mjet i fuqishëm për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale të të gjithë qytetarëve. Pa një sistem të mirëfilltë dhe të përditësuar për administrimin e tokës, nuk mund të kemi planifikim të drejtë, zhvillim të barabartë apo qasje të drejtë për qytetarët tanë.

Drejtori ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti ka theksuar se ritmi i punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës është shumëfishuar, meqë shumica e projekteve të planifikuara tashmë janë realizuar, ndërsa disa prej tyre janë ende në fazën e implementimit. Disa nga projektet që kanë përfunduar janë rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës, instalimi i emrave të rrugëve dhe numrave të ndërtesave, si dhe rrjeti i nivelimit dhe sistemit të lartësive.

Në këtë takim kanë prezantuar zyrtarë të AKK-së, Zyres së Kryeministrit dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Temat e prezentuara dhe diskutuara ishin: Rindërtimi i Kadastrit, Fuqizimi i Menaxhimit të Aseteve Publike, Vlerësimi Masiv i Tokave dhe Krijimi i Kadastrit të Përçojave

Në takim të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Bankës Botërore dhe përfaqësues nga institucione të tjera vendore.

Në fund të Komitetit u nxjerrën edhe disa rekomandime për aktivitetet e radhës në këtë fushë, gjegjësisht forcimi i bashkëpunimit të ngushtë mes AKK-së dhe Zyrës për Pronë Publike në kuadër të ZKM-së, funksionalizimi i grupit teknik për komasacionin, shqyrtimi i mundësisë që në zonat e paformalizuara, banuesve t'u jepet e drejta e shfrytëzimit të objekteve ku jetojnë, derisa të gjendet zgjidhja e plotë ligjore, Inicimi i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Tatimin në Pronë dhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të pushtetit lokal që ndërlihet me organizimin vertikal të kadastrit.



Takimi i gjashtë i Komitetit Ndërmënystror për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës, mbajtur më 21 nëntor 2025.

4.2. Takimet koordinuese të donatorëve

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të asistencës financiare e zhvillimore për Administrimin e Tokës në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2025, AKK-ja ka mbajtur dy takime koordinuese me donatorë, kryesisht ekspertë të Bankës Botërore me misione disa ditore gjegjësisht nga 16 deri 20 qershor 2025 dhe 17 deri 21 nëntor 2025.

Pjesëmarrësit në këto takime diskutuan mbi fazat aktuale dhe ato të ardhme lidhur me aktivitet në fushën e kadastrit, programet ekzistuese dhe programet e reja të financimit, të cilat kanë për qëllim avancimin dhe përmirësimin e sektorëve të rëndësishëm në fushën e kadastrit.

Donatorët nga ana tjetër kanë vlerësuar punën, angazhimin dhe rezultatet në projektet në realizim e sipër nga AKK-ja dhe premtuan vazhdimin e mbështetjes dhe koordinimit, me qëllim të arritjes së të gjitha objektivave të planifikuara nga AKK-ja për këtë periudhë kohore.

Takimet me donatorë do të ndihmojnë Agjencinë Kadastrale të Kosovës në planifikimin e aktiviteteve të rëndësishme, të cilat do të jenë të përqendruara në përmirësimin e sistemit kadastral, përmirësimin e infrastrukturës si dhe në mbështetje e financim të projekteve kapitale në Republikën e Kosovës





4.3. Takime koordinuese me kryetarë të komunave

Drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z.Avni Ahmeti, bashkë me ekipin profesional zhvilloi takime me kryetarë të disa prej komunave të përfshira në Projektin e Rindërtimit. Ai takoi Kryetarin e Komunës së Rahovecit z.Smajl Latifi, Kryetarin e Komunës së Malishevës z.Ekrem Kastrati, Kryetarin e Komunës së Dragashit z. Bexhet Xheladini dhe Kryetarin e Komunës së Gjakovës z.Ardian Gjini.

Gjatë këtyre takimeve u diskutua nga afër mbi ecurinë e projektit të Rindërtimit të Kadastrit, dinamikën dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në të, dhe mbështetjen e komunës për realizmin e suksesshëm të tij.

Në disa zona të këtyre komunave po zhvillohen matjet dhe zyrtarizimi i gjendjes faktike në terren, si dhe regjistrimi i trashëgimive dhe zyrtarizimi i transaksioneve joformale, me synim të kthimit të sigurisë juridike mbi pronën, si bazë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror.

Këto takime kishin për qëllim që nëpërmjet kryetarëve edhe njëherë tu bëhet ftesë qytetarëve që të bashkëpunojnë ngushtë me ekipet në teren, të dorëzojnë dokumentacionin përkatës dhe të jenë pjesë aktive e këtij procesi të rëndësishëm të Projektit të Rindërtimit të Kadastrit.





4.4. Takime koordinuese me zyrtarët e Zyreve Kadastrale Komunale për Projektin e Rindërtimit

Para fillimit të Fushatës së Informimit Publik në zyret e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, u mbajt një takim i frytshëm me përfaqësues të Komunave dhe Operatorëve Ekonomikë, me qëllim të koordinimit të zbatimit të projektit të rëndësishëm të “Rindërtimit të Kadastrit”.

Gjatë këtij takimi, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, i informoi të pranishmit për planin dinamik të implementimit të projektit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përgatitjeve për një fushatë gjithëpërfshirëse informimi.

Me këtë takim u fillua me përgatitje të terrenit për punën voluminoze që u zhvillua më vonë, ku suktesi i këtij projekti do të shërbejë si themel për rindërtimin e tërësishëm të të dhënave kadastrale në 1305 Zona Kadastrale në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.





4.5. Takime koordinuese me gjeodetë dhe kompani gjeodete të licencuara

4.5.1. Takim me Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës, ku u trajtuan çështje me rëndësi strategjike për profesionin e gjeodezisë.

Diskutimet u fokusuan në njoftimin e fundit të Odës së Inxhinierëve të Kosovës, në lidhje me licencimin e gjeodetëve ku u ngritën shqetësime mbi implikimet juridike dhe detyrimin për përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi.

Njëherit, u prezantua moduli i ri për gjeodetët, një mekanizëm që do të mundësojë administrimin dhe përpunimin e dokumentacionit teknik, që do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit profesional, duke garantuar integritetin e të dhënave dhe qasjen më transparente në shërbim të publikut.



4.5.2. Sistemi ri për gjeodetët, një arsye tjetër takimi me komunitetin e gjeodetëve

Me qëllim të diskutimit të kërkesave dhe zhvillimeve në Sistemin e gjeodetëve u mbajt takimi i radhës me Operatorin Ekonomik, i cili ka zhvilluar sistemet digjitale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, me ç'rast u pranua versioni i Sistemit për gjeodetët dhe kompanitë gjeodete. Sistemi i zhvilluar është prezantuar si një arritje e prekshme, drejt përpunimit më të lehtë, më të thjeshtë dhe qasjes së drejtëpërdrejtë në proceset teknike.

Sistemi i ri për gjeodetët paraqet një mekanizëm inovativ, që do të mundësojë administrimin dhe përpunimin e lëndëve teknike, duke kontribuar në ngritjen e efikasitetit profesional, si dhe duke garantuar besueshmërinë e të dhënave dhe një shërbim tejet më efikas të gjeodetëve të licencuar ndaj qytetarëve.

Ky sistem do të zbusë ndërlikimet procedurale nga marrja e shënimeve fillestare e deri te përpunimi përfundimtar, përfshirë komunikimin në kohë reale me zyrat kadastrale. Në takim ishte planifikuar të mbahet një takim gjithëpërfshirës me gjeodetë, ndërsa në të ardhmen e afërt do të fillojë edhe trajnim i posaçëm për përdorimin e sistemit të ri.



4.6. Thellimi i bashkëpunimit me Institucione të ndryshme publike nëpërmjet Marrëveshjeve të bashkëpunimit

4.6.1. Memorandum bashkëpunimi me Kompaninë e sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria

Drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, dhe Drejtori i Kompanisë Sigal Uniqa Group Austria Sh.A., z. Perparim Drini, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi, i cili ka për qëllim shkëmbimin e informacionit në mes të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Sigal Uniqa Group Austria Sh.A., përkatësisht regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e hipotekave, duke siguruar një qasje më efikase dhe më të shpejtë në Regjistrin për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme përmes ndërveprimit të shërbimeve digjitale.

Përmes këtij Memorandumi, palët kanë vendosur të krijojnë Procedura Standarde për ndërveprimin e shërbimeve digjitale të përcaktuara, duke mundësuar kështu që të dhënat e nevojshme për regjistrimin e hipotekave të merren dhe përpunohen në kohë reale, duke garantuar saktësinë dhe sigurinë e informacionit. Të dhënat që do të shfrytëzohen do të jenë të mbrojtura dhe konfidenciale, dhe do të përdoren vetëm nga personat e autorizuar për qëllime të këtij Memorandumi dhe për përmbushjen e obligimeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit në mes të
Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Kompanisë së
Sigurimeve
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A!



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency



SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

4.6.2. Memorandum bashkëpunimi me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK)

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) dhe Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. (KEK) kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në menaxhimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kadastrale brenda fushës së operimeve të KEK-ut.

Memorandumi u nënshkrua nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, dhe Drejtori Ekzekutiv i Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A z. Bekir Gërguri, duke reflektuar angazhimin e të dyja palëve për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për të përmirësuar proceset e administrimit të pronës dhe resurseve energjetike. z. Avni Ahmeti shprehu se: "Si institucion përgjegjës për administrimin e regjistrave kadastralë dhe pronësorë në Kosovë, kjo marrëveshje është një hap vendimtar drejt modernizimit të proceseve teknologjike dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, si model për bashkëpunime të tjera strategjike edhe me institucione të tjera shtetërore, gjithnjë në shërbim të qytetarëve."

Integrimi i Sistemit të Informatave Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK) me proceset teknike dhe operative të KEK Sh.A. do të mundësojë shkëmbimin elektronik të të dhënave, eliminimin e pengesave burokratike dhe rritjen e transparencës në administrimin e pronave dhe resurseve energjetike. Përveç harmonizimit të të dhënave, ky bashkëpunim do të përfshijë gjithashtu ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të dedikuara për stafin e KEK-ut dhe hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për të garantuar zbatimin efikas të marrëveshjes. Duke ndërtuar ura të forta bashkëpunimi dhe duke krijuar mekanizma të qarta veprimi, AKK synon të kontribuojë jo vetëm në përmirësimin e proceseve teknike dhe administrative, por edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit kadastrit.



4.6.3. Memorandume bashkëpunimi për Sistemin e adresave me Komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok

Në kuadër të projektit për Kompletimin e Sistemit të Adresave, i cili mbështetet nga Banka Botërore, është planifikuar edhe implementimi i sistemit të adresave në Komunat Veriore: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Pas një sërë takimesh konstruktive me kryetarët dhe përfaqësuesit zyrtarë të këtyre komunave, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), ka ndërmarrë veprime konkrete duke angazhuar zyrtarët e saj për të mbështetur nga afër procesin teknik në terren, përgatitjen e Sistemit dhe përgatitjen për fazën e emërimit të rrugëve dhe vendosjen e adresave.

Për të lehtësuar këtë proces të ndjeshëm dhe me rëndësi të veçantë, AKK ka filluar gjithashtu bashkëpunimin aktiv me komisionet komunale, të cilat janë themeluar për të mbikëqyrur dhe koordinuar fazën e emërimit të rrugëve.

Në këtë frymë të bashkëpunimit të ndërsjellë, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, së bashku me ekipin e tij, ka realizuar vizita zyrtare në të katër komunat veriore, ku janë mbajtur takime të ndara me kryetarët e komunave përkatëse, bashkarisht me ekipet përgjegjëse.

Gjatë këtyre takimeve u nënshkruan Memorandumet e Bashkëpunimit, që njehërit shënojnë formalizimin e plotë të angazhimit të ndërsjellë për krijimin e Sistemit të Adresave në këto komuna.

Në krye të diskutimeve ishte njëashtu edhe projekti për rinovimin e Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK), një tjetër hap ky i rëndësishëm drejt rritjes së kapaciteteve të resurseve dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.





4.6.4. Memorandum bashkëpunimi me Institutin për Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, dhe Drejtori Ekzekutiv i IKKL-së, z. Atdhe Hetemi, nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit, që i hap rrugë një kapitulli të ri që përcakton kornizën e bashkëpunimit ndërinstitucional për ndarjen e njohurive dhe të dhënave që AKK posedon. Me anë të këtij Memorandumi parashihet:

- Shkëmbimi i të dhënave fiziko-gjeografike digjitale që përfshijnë ortofotot e Kosovës ndër vite, kufijtë administrativë dhe kadastralë, zonat urbane/rurale, hartat topografike, adresat dhe infrastrukturën.
- Organizimi i seminareve, punëtorive dhe aktiviteteve të përbashkëta shkencore e profesionale.
- Bashkërendimi i burimeve dhe ekspertizës për projekte hulumtuese dhe zhvillimore që synojnë dokumentimin dhe zbardhjen e të vërtetës për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.



4.6.5. Memorandum bashkëpunimi me Ndërmarrjen Hidroekonomike "Ibër Lepenc"

Në Maj 2025, në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi në mes të: Agjencisë Kadastrale të Kosovës, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Avni Ahmeti si dhe Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër Lepenc", përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Faruk Mujka.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i të dhënave në mënyrë elektronike, përmes ndërlidhjes me Sistemin Informativ Kadastral për Tokën në Kosovë (SIKTK), me ç'rast:

- Përcaktohen rregullat e qasjes dhe përdorimit të të dhënave;
- Bëhet siguria e të dhënave dhe rregullat e ndara për administrim; si dhe
- Bëhet lehtësimi i procedurave për bashkëpunim të mëtutjeshëm ndërinstytucional.

Fushëveprimi teknik përfshin:

- Qasje elektronike përmes ueb-aplikacioneve me SIKTK; si dhe
- Organizimin e trajnimeve për stafin e Ibër Lepenc për përdorimin e moduleve të ndryshme sipas nevojave.

Ky bashkëpunim synon të sjellë më shumë efikasitet, transparencë dhe koordinim institucional, duke përdorur kështu teknologjinë si urë lidhëse ndërmjet dy institucioneve kryesore në fushën e ujit dhe kadastrit në Republikën e Kosovës.



4.6.6. Memorandum bashkëpunimi për Renovimin e Zyres Kadastrale Komunale në Mitrovicë të Veriut

Në kuadër të projektit REGIP të Bankës Botërore ka qenë ie planifikuar investimi për renovimin e Zyreve Kadastrale Komunale në Veri. Për këtë qëllim dhe për të hapur rrugë filimit të punimeve atje është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi mes AKK-së dhe Kryetarit të ZKK Mitrovicë e Veriut për Renovimin e Zyres Kadastrale Komunale atje.

Kryetari Atiq theksoi se ky investim do të mundësojë krijimin e kushteve moderne të punës dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Ky renovim pritet të kontribuojë në ngritjen e cilësisë së infrastrukturës institucionale dhe në përmirësimin e shërbimeve publike në fushën e kadastrit.



4.6.7. Memorandum bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Agjencia Kadastrale të Kosovës (AKK) poashtu gjatë vitit 2025, ka nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit me Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), në kuadër të Projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Gjeoinformacionit në Kosovë (REGIP), financuar nga Banka Botërore. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të forcojë koordinimin institucional dhe të mundësojë zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të planifikuara për AKKVP-në në kuadër të projektit REGIP. Këto aktivitete përfshijnë:

- Angazhimin e ekspertëve për të drejtat pronësore dhe për komunikim,
- Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për AKKVP, dhe
- Zhvillimin e një platforme digjitale për administrimin e pronave në skemën e qirasë.

Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të menaxhimit të pronës dhe transparencës institucionale, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të kadastrës dhe të drejtave pronësore në Kosovë.



4.6.8. Memorandum bashkëpunimi me Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës

Në përmbyllje të trajnimit për ndërmjetësuesit në sistemin e ri SIKTK – Moduli i ndërmjetësuesve Agjencia Kadastrale e Kosovës përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Avni Ahmeti ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës përfaqësuar nga Kyetarja e Odës znj. Ganimete Xhelili. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të rrisë efikasitetin dhe sigurinë në proceset ndërmjetësuese dhe kadastrale, përmes përdorimit të sistemit elektronik SIKTK - Moduli të Ndërmjetësuesve, të menaxhuar nga AKK.

Ky memorandum përcakton procedurat e qasjes së ndërmjetësuesve në sistem, ngarkimin elektronik të akteve të tyre të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme, si dhe rregullat e sigurisë që garantojnë një proces profesional dhe transparent.

Bazuar në këtë bashkëpunim të ndërsjellë:

- AKK siguron çasje teknike dhe ndërlidhje direkte me sistemin;
- Ndërmjetësuesit do të kenë mundësi të ngarkojnë elektronikisht aktet e tyre të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme;
- Dokumentet do të përpunohen më shpejt nga ZKK-të për regjistrimin e të drejtave pronësore;
- Rritet siguria, transparenca dhe efikasiteti.



4.6.9. Memorandum bashkëpunimi me Odën e Përmbauesve Privat

Në përmbyllje të trajnimit për Përmbauesit privat në sistemin e ri SIKTK – Moduli i Përmbauesve privat, Agjencia Kadastrale e Kosovës përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Avni Ahmeti ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Përmbauesve privat të Kosovës përfaqësuar nga Kyetari i Odës së Përmbauesve privat, z. Mehdi Reshani.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të rrisë efikasitetin dhe sigurinë në proceset përmbaimore dhe kadastrale, përmes përdorimit të sistemit elektronik SIKTK - Moduli të Përmbauesve privat, të menaxhuar nga AKK.

Ky memorandum përcakton procedurat e qasjes së përmbauesve në sistem, ngarkimin elektronik të akteve të tyre të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme, si dhe rregullat e sigurisë që garantojnë një proces profesional dhe transparent.



4.6.10. Memorandum bashkëpunimi me Odën e Noterëve të Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Avni Ahmeti ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Noterëve të Kosovës përfaqësuar nga Kyetari i Odës z. Shpend Haskaj.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të rrisë efikasitetin dhe sigurinë në proceset noteriale dhe kadastrale, përmes përdorimit të sistemit elektronik SIKTK - Moduli të Noterëve, të menaxhuar nga AKK.

Ky memorandum përcakton procedurat e qasjes së noterëve në sistem, ngarkimin elektronik të akteve noteriale të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme, si dhe rregullat e sigurisë që garantojnë një proces profesional dhe transparent.

Bazuar në këtë bashkëpunim të ndërsjellë:

- AKK siguron qasje teknike dhe ndërlidhje direkte me sistemin;
- Noterët do të kenë mundësi të ngarkojnë elektronikisht aktet noteriale të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme;
- Dokumentet do të përpunohen më shpejt nga ZKK-të për regjistrimin e të drejtave pronësore;
- Rritet siguria, transparenca dhe efikasiteti.



4.6.11. Memorandum bashkëpunimi me BIRN Kosova

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me BIRN Kosova për të drejtat e pronës së grave dhe grupeve të marginalizuara.

Ky bashkëpunim ka për qëllim ndarjen e të dhënave dhe ekspertizës për të identifikuar barrierat ligjore, institucionale dhe kulturore në regjistrimin e pronës, si dhe për të propozuar zgjidhje praktike për mundësi të barabarta qasjeje.

Ky aktivitet financohet nga Bordi i Bankës Botërore për Shtetet dhe Ndërhyrjet në Paqe dhe zbatohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC).



5

PROJEKTET KAPITALE

5 PROJEKTET KAPITALE

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ndjekur një qasje të organizuar dhe të mirëplanifikuar, duke u bazuar në analiza të thelluara të nevojave të territorit dhe zhvillimeve globale. Përzgjedhja e projekteve ka qenë pjesë e një procesi strategjik që ka synuar përmirësimin e menaxhimit të të dhënave kadastrale dhe gjeohapësinore, si dhe avancimin e infrastrukturës teknologjike dhe shërbimeve publike. Shumica e projekteve janë filluar në vitin 2024 për tu finalizuar në 2025.

Përzgjedhja e projekteve është bërë në përputhje me disa faktorë kyç, që përfshijnë:

- Analizën e nevojave dhe kërkesave të sektorëve të ndryshëm
- Përputhshmëria me zhvillimet globale dhe standardet ndërkombëtare
- Prioriteti në avancimin e teknologjisë dhe infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve sa më të shpejta për qytetarët
- Kontributi në zhvillimin ekonomik dhe social

Projektet e përfunduara për vitin 2025 si dhe ato në proces janë si në vijim:

- Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive;
- Zhvillimi dhe Avancimi i Sistemeve të Informacionit Kadastral;
- Rindërtimi i Kadastrit;
- Kontrolli i kualitetit për Rindërtimin e Kadastrit;
- Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së;
- Konvertimi i të dhënave në SIKTK për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave;
- Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit;
- Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave;
- Ndërlidhja e qytetarit me adresën;
- Vendosja e numrave dhe emrave të rrugëve;
- Skanimi dhe indeksimi i dokumenteve arkivore kadastrale dhe
- Renovimi i hapësirave të Zyrës Kadastrale Komunale të Mitrovicës së Veriut

5.1. Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive

Rrjeti i nivelimit dhe Sistemi referent i lartësive janë dy komponente të rëndësishme në gjeodezi dhe janë thelbësore për matjen dhe përcaktimin e lartësive në një territor. Këto sisteme përdoren për të krijuar një strukturë të saktë dhe të standardizuar që mundëson matjen e lartësive të pikave në raport me një nivel të caktuar. AKK me përfundimin e këtij projekti ka arritur të kompletojë të gjithë rrjetin gjeodezik për territorin e Republikës së Kosovës.

Projekti ka filluar në muajin nëntor 2025, dhe është projekt dy vjeçar. Në vitin 2025 është realizuar faza e Rekognosimit, ndërsa fazat e Monumentimit dhe Matja e Diferencave në Lartësi do të realizohen në vitin 2026. Me këtë projekt janë të planifikuar rreth 300 pika me gjatësi totale 600 km.



Harta e linjave të Fazës I-rë (projekti i vitit 2024) dhe projektimi përfundimtar i linjave të Fazës II-të (projekti i vitit 2025-2026)

Ky projekt ka përmirësuar Infrastrukturën Referente Gjeodezike në Kosovë dhe themelimin e Sistemit të Referencës Gjeodezike të Kosovës sipas shenjave të BE-së. Sistemi i Referencës Shtetërore, si një njësi e vetme, përbëhet nga sistemet e mëposhtme të referencës:

- Sistemi i referencës hapësinore (tre-dimensionale),
- Sistemi i referencës horizontale (dy-dimensionale),
- Sistemi i referencës vertikale (një-dimensionale),
- Sistemi i referencës gravimetrike.

Sistemi do të jetë një pjesë e Sistemit të Referencës Shtetërore të vetme, i materializuar përmes rrjetit adekuat të Rrjetit të Nivelimit të Kosovës (RRNK), i zhvilluar dhe i lidhur me vendet e tjera fqinje sipas shenjave evropiane që do të jetë bazë për një gjeopozicionim cilësor në të gjithë territorin e Kosovës dhe do të shërbejë jo vetëm për kërkime të ndryshme praktike, shkencore e gjeofizike por edhe në jetën e përditëshme për piketimin e autostradave, objekteve të ndërtimtarisë aty ku kërkohet saktësia e këtij rrjeti etj.

Si bazë për projektimin e linjave të Fazës së II-të janë linjat e Fazës së I-rë dhe rrjeti Gravimetrik.



Rrjeti gravimetrik shtetëror
i rendit të parë



Harta e linjave të Fazës I-rë dhe
projektimi i linjave të Fazës II-të

Siç duket edhe nga figura e mësipërme linjat janë projektuar në mënyrë të tillë që të dendësojnë rrjetin duke krijuar poligone më të vegjël apo të mbyllin vija të hapuara dhe përgjatë rrugëve automobilistike që të lidhin gjithë hyrjet nga vendet fqinje por edhe pikat gravimetrike të rendit të I-rë dhe qytetet me njëri tjetrin.

Pikat apo monumentet përgjatë këtyre linjave do të vendosen rreth dy kilometra larg njëra tjetrës.

Fazat e projektit janë si më poshtë:

- Rekognosimi,
- Monumentimi,
- Matja e Diferencave në Lartësi


Rezultati i arritur nga faza e I-rë e Rekognosimit është njohja me terrenin si dhe përzgjedhja e pozicionit përfundimtar të pozicionit të pikave apo monumenteve të nivelimit.

Rezultati i pritur i fazës së II-të është vendosja apo ndërtimi i pikave (monumenteve) të nivelimit sipas kërkesës në TOR:

- 40 pika nyje
- Dhe 260 pika të zakonshme (të vendosura vertikalisht ose horizontalisht mesatarisht çdo 2 km)

Në secilën fazë (Rekognosimi dhe Monumentimi) do të maten apo u përcaktohen koordinatat e secilës pikë nëpërmjet KOPOS me marrës gjeodezike me frekuencë të dyfishtë me dy seri të pavarura me kohëzgjatje 30 sekonda në RTK apo 10 minuta me metodën kinematike.

Rezultatet e fazës së III-të janë përcaktimi i ndryshimeve në lartësi me metodën e nivelimit gjeometrik duke përdorur nivela dixhitale me saktësi 0.3mm për një kilometër vajtje-ardhje.



Nivelimi gjeometrik


Rekognosimi

Rekognosimi, si faza fillestare, është bërë vlerësimi dhe përzgjedhja e vendeve për shenjat e nivelimit të cilat kanë kaluar sipas këtyre hapave:

- hapi i parë ishte studimi dhe përzgjedhja paraprake e pozicionit të monumentit në bazë të kushteve të përmendura dhe materialeve ekzistuese hartografike,
- hapi i dytë ishte vizita për tu njohur me terrenin dhe vendodhjet e paracaktuara të pozicionit të monumenteve duke mbledhur informacionin përkatës gjeologjik, hidrologjik, gjeomorfologjik, ndërtimor si edhe gjeodezik. Gjatë vizitës u panë edhe pozicionet e mundëshme dhe të përshtatshme për vendosjen e monumenteve përfundimtare,
- hapi i tretë ishte përzgjedhja e pozicionit përfundimtar të monumenteve,
- Në fund pikave i është bërë një rinumërim në mënyrë që këto të fundit të kenë një uniformitet





Shtojca 4: Përshkrimi i pozicionit të vëzhguar

Rrjeti i nivelimit të Kosovës		Linja: 01		Shenja: 1001	
Ortofoto		Shkalla e hartës topografike 1:25000			
					
Fotografia		Skicë			
					
Koordinatat e përafërta		N 4692809.28, E 7519091.52, Z 586.7			
Monumentimi i planifikuar		☐	Themelore		
		☐	Nyje		
		☐	E zakonshme e vendosur vertikalisht		
		☒	E zakonshme e vendosur horizontalisht		
		☐	Shenja gjeodezike		
Vërejtje:					
Eksperti		Kompania			
Emri Lorenc		Lorenzo & CO. Sh.p.k.			
Mbiemri Zani					
Data 30.11.2025					



Rrjeti i nivelimit të Kosovës		Linja: 04		Shenja: 1062	
Ortofoto		Shkalla e hartës topografike 1:25000			
					
Fotografia		Skicë			
					
Koordinatat e përafërta		N 4719574.2, E 7544905.38, Z 545.17			
Monumentimi i planifikuar		☐		Themelore	
		☐		Nyje	
		☐		E zakonshme e vendosur vertikalisht	
		☒		E zakonshme e vendosur horizontalisht	
		☐		Shenja gjeodezike	
Vërejtje:					
Eksperti		Kompania			
Emri		Lorenc			
Mbiemri		Zani			
Data		30.11.2025			
		Lorenzo & CO. Sh.p.k.			

Përshkrimi i pikave te propozuara



Linjat nga projekti i vitit 2024 (faza 1) dhe projekti i vitit 2025-2026 (faza 2)

5.2. Zhvillimi dhe Avancimi i Sistemeve të Informacionit Kadastral

Zhvillimi dhe avancimi i sistemeve të informacionit kadastral është projekt i cili ishte planifikuar për të mbështetur biznes proceset e saj kryesore. Sistemet e përfshira në këtë projekt ishin: SIKTK-T, SIKTK-HK, ARIS, Sistemi i Gjeodetëve, Regjistri i përçojave, SIKTK-Online ose eKadastrri (ku përfshihen Moduli i noterëve, Përmbauesve privat dhe Ndërmjetësuesve) dhe SIKTK-Online API.

Realizimi dhe implementimi i tij ka kaluar në periudha të ndryshme, marrë parasysh përfshirjen e pothuajse të gjitha sistemeve të AKK-së, por edhe për shkak të specifikave të veçanta të secilit sistem e poashtu për shkak të numrit të madh të përdoruesve, por megjithatë është përfunduar me sukses.

Tani që sistemet tashmë janë në funksion ato komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të ndajnë të dhënat në kohë reale dhe të kenë një mënyrë më të shpejtë komunikimi, por edhe komunikojnë me institucione të jashtme ku përveç cilësisë së të dhënave në bazat e të dhënave e cila do të rritet, gjithashtu do të rritet edhe transparenca e do të shkurtohet ndjeshëm koha e përpunimit të të dhënave.

Të gjitha sistemet janë zhvilluar duke përdorur teknologjinë më të fundit dhe funksionojnë në versionin më të fundit të Sistemeve Operative të cilat AKK-ja ka licenca edhe për to.

Objektivi i projektit ka qenë që:

- Të zhvillohet sistem i ri për adresa - ARIS (i cili do të funksionojë në teknologjinë më të fundit të përdorur dhe të përmirësojmë performancën e tij)
- Zhvillimi i Hartës Kadastrale (e cila do të komunikojë me bazën tekstuale dhe Sistemin e gjeodetëve)
- Zhvillimi i Sistemit të gjeodetëve
- Zhvillimi i Regjistrit të përçojave
- Avancime/zhvillime në SIKTK-Online (ku përfshihen Moduli i noterëve, Përmbauesve privat dhe Ndërmjetësuesve) dhe
- SIKTK-Online API.

Ndryshimet kanë përfshirë:

- Përmirësime dhe avancime në sistemet ekzistuese
 - SIKTK-T
 - SIKTK-G (të funksionojë në teknologjinë më të fundit të përdorur dhe të përmirësojmë performancën e tij)
 - SIKTK-API në internet

- Integrimi i sistemeve për ndërveprim më të mirë
- Sigurimi i trajnimeve dhe dokumentacionit të nevojshëm
- Testimi i secilit modul dhe funksionaliteti i përgjithshëm i testimit
- Vendorsja e sistemeve
- Migrimi i të dhënave për SIKTK-HK dhe ARIS

Dorëzimi dhe transferimi i njohurive të stafi i AKK-së.

Përmirësimi i funksionalitetit të sistemeve ekzistuese: Fokusi ka qenë që të bëhen ndryshime në sistemet e informacionit për administrimin e tokës, për të rritur performancën dhe menaxhimin e cilësisë së të dhënave për të gjitha sistemet. Disa nga sistemet e informacionit kanë qenë të teknologjisë së vjetër të përdorur dhe duhet të përmirësohen me teknologjinë më të fundit në mënyrë që të kenë funksionalitetet e reja dhe performancën më të mirë. Një tjetër përmirësim i sistemeve është ndryshimi i rrjedhës së punës për ta bërë më të lehtë dhe më fleksibël për t'u përdorur.

Përmirësimi i ndërveprimit të sistemit, veçanërisht me sistemet e jashtme: Nga komunikimet e mëhershme me disa institucione me sistemet e jashtme kemi parë se cilësia e të dhënave është rritur dhe përpunimi i të dhënave është shumë i shpejtë. Kjo ka ndihmuar përdoruesit fundorë që të dhënat nga sistemet e jashtme të jenë plotësisht të vërtetuara dhe të përditësuara. Me zhvillimet e fundit është rritur numri i institucioneve publike dhe private për të komunikuar me to në kohë reale, pasi shkëmbimi i të dhënave do të jetë me cilësi të lartë dhe të gjithë akterët e tjerë do t'i marrin të dhënat në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë.

Ridizajnimi i modelit të të dhënave, në përputhje me standardin ISO 19152 LADM: Disa nga bazat e të dhënave kanë qenë në përputhje me standardin LADM, por me zhvillimet e reja janë bërë disa përmirësime për t'u përmbushur më së miri me standardin LADM.

5.1.1. SIKTK-T (Tekstuale)

Ky sistem është krijuar për të mbajtur informacionin tekstual të kadastrit, ndërsa SIKTK-T SOA si i tërë sistemi është projektuar që të jetë një sistem i centralizuar për të gjitha sistemet. Karakteristikë tjetër në sistemin kryesor SIKTK-T SOA është mundësia për të menaxhuar përdoruesit për SIKTK-T, SIKTK-HK, ARIS dhe çdo nënsistem tjetër në mënyrë që të menaxhohen të drejtat e përdoruesit për nënsisteme të ndryshme. Gjatë komunikimit me SIKTK-HK është mundur që numrat kadastralë të cilët janë krijuar në SIKTK-HK të kenë të njëjtat numra kadastral të krijuar në sistemin informativ tekstual SIKTK-T dhe të validohen sipërfaqet e njësive Kadastrale në mes të sistemeve.

- Disa nga funksionet që ka ky sistem pas avancimit:
- Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës – banimi dhe terasë
- I njejt zyrtarë nuk mund të jetë edhe përpunues edhe verifikues
- Ridizajnim i certifikatave të pronës (për person dhe për njësi kadastrale)
- Butoni “Ndrysho pronarët” për të gjitha llojet e bartjeve
- Butoni “Transfero të drejtat” përveç hipotekave do të barten edhe pronarët
- Ngarkimi i dosjeve edhe në refuzim të lëndës
- Aktvendimet:
 - Aktvendim Pezullues për plotësim të dokumentacionit
 - Aktvendim për përfundimin e procedurës administrative (refuzohet lënda)
 - Aktvendim për pezullim të përkohshëm të procedurës
- Validimi nëse njësia kadastrale është në përpunim në SIKTK-HK dhe anasjelltas
- Ekzekutimi i procesit në SIKTK-HK, njësitet e njëjta do të krijohen në SIKTK-T
- Njoftime në kohë reale për kërkesat e reja që vijnë nga bankat dhe institucionet tjera
- Lloje të reja të statistikave
- Bashkimi i njësive kadastrale me të drejta të ndryshme
- Bartja e servitutit tek lloji i lëndës “Ndarje”
- Mbyllja e lëndëve në mënyrë automatike kur kalojnë 2 muaj dhe nuk ka njësi kadastrale në lëndë ose nuk ka aktvendim
- Lloji i ri i së drejtës për mbajtjen e përhjetshme
- Para-regjistrimi i ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës
- Validimi nëse zyrtari është në pushim vjetor/mjekësor/lindjes të mos mund të qaset në sistem
- Lëndët që kalojnë afatet ligjore, do të hapen për përpunim vetëm ato, e do të bllokohen lëndët tjera
- Ndërlidhja me sistemin e intranetit që lëndët dhe dosja e skanuar të vijë komplet në SIKTK
- Ruajtja e radhës për të gjitha kërkesat dhe procesimi i tyre sipas sistemit FIFO, e para për nga koha do të procesohet me radhë

Një tjetër komunikim është edhe me noterët që të gjitha lëndët të vijnë në formën digjitale nga të gjithë noterët në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në këtë mënyrë palët nuk kanë nevojë që kërkesat t'i dorëzojnë në formë fizike në zyret Kadastrale komunale. Ndër veçoritë tjera janë edhe funksionet:

- Marrja e informacioneve kadastrale në kohë reale
- Dërgimi në formë digjitale të kërkesës nga noteri direkt në ZKK, duke dërguar të dhënat e kërkesës dhe dokumentet e bashkëngjitura të skenuara (aktin noterial, dokumentet e identifikimit, etj)
- Mundësia e komunikimit me noterët (chatting)
- Mundësia e përpunimit të lëndëve nga ZKK vetëm nga kërkesat e noterëve
- Largimi i shënimit të noterit
- Palët nuk paraqiten në ZKK fizikisht
- Pagesa e tarifave administrative

Zhvillimi i sistemeve pra ka arritur të realizojë ndërveprimin e sistemeve digjitale me regjistrat dhe sistemet e tjera me institucionet e jashtme, si:

- Noterët
- Përmbaruesit privat
- Ndërmjetësuesit

Ndërsa, planifikohet të realizohen shumë shpejt edhe komunikimi me:

- Këshillin gjygjësorë të Kosovës
- Këshillin prokurorial i Kosovës
- Drejtoritë e Urbanizmit për parcelat që jep leje ndërtimore, që të pasqyrohen në pjesën tekstuale dhe grafike.

Trajnimi i zyrtarëve të ZKK-ve në SIKTK Tekstuale dhe për Modulet e reja të zhvilluara për Noter, Përmbarues privat, Ndërmjetësues dhe Gjeodetë të licencuar



Pas përfundimit të zhvillimeve në kuadër të këtij projekti në grupe të ndara janë trajnuar zyrtarët e Zyreve Kadastrale Komunale për ndryshimet e realizuara në SIKTK Tekstuale.

Për këtë grup janë trajnuar 96 zyrtarë të ZKK-ve.

5.1.2. SIKTK-HK (Harta Kadastrale)

Sistemi i zhvilluar është i bazuar në ueb me një bazë të dhënash të centralizuar. Sistemi përmban të gjitha mjetet e nevojshme për mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore (harta kadastrale) bazuar në legjislacionin në fuqi (ligje, udhëzime administrative, udhëzues pune dhe manuale).

Përdoruesit do të jenë në gjendje të kryejnë të gjitha operacionet bazë të administrimit të sistemit, menaxhimit të përdoruesve dhe menaxhimit të rasteve. Gjithashtu, importimi i të dhënave nga disa formate të ndryshme si dhe përpunimi i të dhënave kadastrale në hartë.

Më poshtë janë të listuara disa nga funksionalitetet bazë të sistemit:

- Shikoni në hartë
- Administrimi i përdoruesit
- Administrimi i aplikacionit
- Administrimi i veçorive
- Funksionet bazë për menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore (kopjimi, zhvendosja, shtimi, fshirja, etj.)
- Menaxhimi i rasteve dhe procesimi i tyre.
- Kontrollimi dhe aprovimi i kërkesave nga gjeodetët


Meqenëse SIKTK-HK është një nënsistem për mirëmbajtjen e të dhënave kadastrale hapësinore, është punuar gjithashtu që të ketë performancë më të mirë në rastin e kyçjes së shumë përdoruesve që përdorin sistemin në të njëjtën kohë.

Disa nga funksionalitetet e avancuara të sistemit janë renditur më poshtë:

- Moduli i importit dhe eksportit të të gjitha veçorive të njësisë kadastrale, të formatit: ITF, Shapefile, DWG, GML dhe CSV
- Krijimi manual i të gjitha veçorive të njësisë kadastrale (metadata)
- Editimi manual i të gjitha veçorive të njësisë kadastrale (metadata)
- Zëvendësimi automatik i të gjitha veçorive të njësisë kadastrale brenda një zone kadastrale
- Kontrolli i cilësisë dhe korrektësia e të dhënave të edituara (ndryshimi i të dhënave)
- Teknologjia e avancuar, duke përdorur teknologjinë më të fundit të ditëve të sotme për menaxhimin e të dhënave hapësinore
- Ndërveprueshmëria me sistemin e gjeodetëve
- Ndërveprueshmëria me SIKTK-T me të gjitha të dhënat e tjera që nuk janë tani (që quhen vende, data e përditësimit, të drejtat, etj.)
- Ndërveprueshmëria me ARIS

- Ndërveprueshmëria me module të tjera si vizualizimi i linjave të ndërtimit, linjave rregulluese etj.
- Shfaqja e të gjitha ortofotove (2001, 2004, 2009, 2012, 2018, 2024)
- Përpunimi i lëndëve në bazë të radhës (FIFO)
- Modeli i zakonshëm i gjeometrisë (modeli i të dhënave topologjike)
- Performancë të madhe në procesimin e të dhënave
- Ngarkimi i dokumenteve të nevojshme për secilin proces
- Ngarkimi i matjeve origjinale
- Validimi me SIKTK-T
- Validimi i të dhënave kur futen në sistem
- Komunikimi digjital me sistemin e gjeodetëve
- Mundësia e ndryshimit automatik i kufirit të zonës kadastrale ose kufirit të komunës gjatë ndryshimit të kufirit të parcelave në kufi të ZK ose komunës

Në figurën e mëposhtme mund të shihni si duket sistemi i ri SIKTK-HK:



Trajnimi i zyrtarëve të ZKK-ve në SIKTK Tekstuale dhe për Modulet e reja të zhvilluara për Noter, Përmbarues privat, Ndërmjetësues dhe Gjeodetë të licencuar

Pas përfundimit të zhvillimeve në kuadër të këtij projekti në grupe të ndara janë trajnuar zyrtarët e Zyreve Kadastrale Komunale për ndryshimet e realizuara në SIKTK – Hartën Kadastrale.

Për këtë grup janë trajnuar 68 zyrtarë të ZKK-ve.



5.1.3. ARIS (tekstuale dhe grafike)

Regjistri i adresave ka këto karakteristika:

- Aplikacion i bazuar në ueb, që përmban funksione të redaktimit të GIS të bazuar në rregulla
- Aftësi të mjaftueshme në komunat që nuk kanë kapacitetet e nevojshme të komunikimit në rrjet
- Aftësi të njohura GIS për vizualizimin e të dhënave gjeohapësinore, kërkimin e të dhënave hapësinore, kërkimin e attributeve, kontrollin e cilësisë dhe raportimin hartografik të produktit.


Sistemi i Informacionit të Regjistrimit të Adresave (ARIS) përbëhet nga komponentë të shumëfishtë të porositur dhe jashtë raftit, të cilët përfshijnë Regjistrin e Adresave, SIKTK-G, GeoServer dhe GeowebCache. Ekziston gjithashtu një dyqan të dhënash për secilin komponent.

Pas zhvillimeve, testimeve dhe trajnimeve për stafin e AKK-së të dhe komunave, me datën 22.09.2025 është lëshuar në përdorim për përdoruesit, Sistemi i Ri i Adresave ARIS. Sistemi i ri i Adresave është një sistem shumë i avancuar, përpos që është përmirësuar performanca, janë zhvilluar edhe shumë module dhe funksionalitete të reja, të nevojshme për zyrtarët komunal por edhe për stafin e AKK-së.

Disa nga avancimet në sistemin e Ri të Adresave ARIS:

1. Është zhvilluar mbi bazën e platformave më të avancuara dhe përditësuar, që përmirësojnë performancën e Sistemit;
2. Ndërfaqja e sistemit të ri është më funksionale dhe më praktike, në të cilën gjinden të dhëna tekstuale dhe grafikone;
3. Mundëson ruajtjen e historikut dhe gjenerimin e ndryshimeve të të dhënave të adresave, sipas komunave, rrugëve, numrave të adresave, përdoruesit, periudhës kohore etj;
4. Mundëson ngarkimin e dokumenteve (vendimeve të Kuvendeve Komunale për emërtimin e rrugëve)
5. Përzgjedhjen e emrave të rrugëve të listës rezervë të emrave nga ARIS-i
6. Mundëson gjenerimin e raporteve të reja të adresave;
7. Kursen kohën në numërtimin e adresave,
8. Eviton gabimet në te adresave (nuk lejon dyfishimin e emrave të rrugëve brenda komunës dhe numrave të adresave brenda rrugës)
9. Mundëson digjitalizimin e kateve dhe banesave më shpejt dhe më lehtë
10. Mundëson kërkimin me query dhe selektimin e avancuar të shtresave, etj


Në figurën e mëposhtme mund të shihni se si duket sistemi i ri ARIS:



Trajnimi i zyrtarëve të adresave për Sistemin e ri të adresave - ARIS

Pas përfundimit të zhvillimeve në kuadër të këtij projekti në grupe të ndara janë trajnuar përdoruesit e secilit sistem.

Për këtë grup janë trajnuar 50 zyrtarë të adresave.



5.1.4. Sistemi i Gjeodetëve

Ky sistem është vendosur në serverët e AKK-së, i aksesueshëm nga jashtë rrjetit qeveritar. Ky sistem do të ndihmojë kompanitë gjeodete dhe gjeodetët e licencuar të bëjnë ndryshime në lëndët e tyre, dhe duke përdorur këtë sistem ata do të mund të shohin në kohë reale të dhënat grafike dhe tekstuale për njësitë kadastrale, do të përzgjedhin njësitë për përpunim, do t'i ndryshojnë ato dhe do ti ruajnë në një bazë të dhënash të ndarë nga ajo reale, pastaj ZKK-ja do t'i aprovoj ato.

Ky sistem konceptualisht është një mini SIKTK-HK, ku përdoruesit mund të kenë qasje në veçoritë bazuar në atë që është dhënë gjatë menaxhimit të përdoruesve në menaxhimin e përdoruesve nga AKK.

Gjeodetët e licencuar do të jenë në gjendje të shkarkojnë të dhënat (koordinatat e pikave, kufijtë e parcelave, ndërtesat, pjesët e ndërtesave, etj.) kjo duhet të bëhet me një parapagim, ku pas shkarkimit të të dhënave dhe përfundimit të matjeve në terren, ata do të mund të përgatisin lëndën dhe e regjistrojnë në SIKTK, ku së bashku me lëndën e skanuar, gjeodeti ia dërgon ZKK-së për kontroll dhe aprovim.




Kjo mundësohet duke lidhur protokollin e ZKK-së me SIKTK ku sistemi ka mundësi të gjenerojë numrin e protokollit në momentin e krijimit të procesit.


Sistemi i gjeodetëve ka mundësinë pas përpunimit të pjesës grafike gjenerimin e raportit të ndryshimit, me ç'rast paraqitet njësia e re e krijuar duke përfshirë të gjitha pikat e krijuara të përshkruara me të dhënat dhe atributet e tyre, poashtu skica e ndryshimeve duke paraqitur gjendjen e vjetër dhe gjendjen e re të përpunuar.

Sistemi i gjeodetëve është dizajnuar për të ofruar qasje në kohë reale në të dhënat grafike dhe tekstuale kadastrale, për të përmirësuar proceset e rievimit dhe për të siguruar rrugë efektive të komunikimit me Zyrën Kadastrale Komunale ose AKK-në. Fokusi i AKK-së ka qenë në përmirësimin e integritetit të të dhënave në terren dhe thjeshtimin e procesit të përditësimeve dhe verifikimeve kadastrale.

Meqenëse ky nënsistem do të përdoret jashtë AKK-së, i është kushtuar vëmendje në sigurinë e të dhënave se si do të miratohen, vërtetimit me dy faktorë dhe niveleve të tjera të sigurisë për të siguruar që gjithçka në këtë nënsistem të jetë mjaft e sigurt.


Në figurën mëposhtme shfaqet arkitektura e komunikimit të sistemit për gjeodetë:





Disa statistika nga përdorimi i këtij sistemi janë paraqitur në tabelën dhe grafikun mëposhtë:

Emri i procesit	Nr
Bashkimi i parcelave	118
Caktimi i kufijve të parcelës	33
Editimi/ndarja e ndërtesave	11
Editimi/ndarja e parcelave	340
Editimi/ndarja e pjesëve të ndërtesave	7
Identifikimi i parcelave	20
Identifikimi i pjesëve të ndërtesës	2
Rirregullimi i kufirit të njësisë kadastrale	11
Totali	542



Trajnimi i Gjeodetëve të licencuar në Sistemin e Gjeodetëve

Pas përfundimit të zhvillimeve në kuadër të këtij projekti në grupe të ndara janë trajnuar përdoruesit e secilit sistem.

Për këtë grup janë trajnuar 256 Gjeodetë të licencuar.





5.1.5. Regjistri i përçojave (tekstuale dhe grafike)

Regjistri i përçojave është një regjistër bazë i infrastrukturës publike i cili përfshinë rrjetin mbitorësor dhe nëntokësor së bashku me të gjitha objektet dhe pajisjet e nevojshme për funksionin e tyre dhe të drejtave pronësore lidhur me to.

Bazuar në Udhëzimin administrativ MMPHI NR. 07/2024 për përcaktimin e përmbajtjes së të dhënave dhe mënyrën e krijimit të njësive kadastrale, përçoja përmban të dhëna mbi:


- llojin e përçojës;
- karakteristikat themelore teknike;
- pozitën, skicën e vendit dhe listën e parcelave të caktuara ku kalon përçoja;
- emrin dhe adresën e pronarit

Baza e të dhënave të kadastrës së përçojave është një grup i të dhënave gjeohapësinore dhe të dhëna të tjera për përçoja, të drejtat pronësore që u takojnë atyre dhe bartësit e të drejtave pronësore.

Përçojat si njësi kadastrale ndahen si në vijim:

- linjat telefonike të sistemeve të telekomunikacionit dhe linjat publike për sinjalizim,
- kontrollim, komunikim të të dhënave apo qëllime të ngjashme;
- linjat e tensionit të lartë dhe të ulët të energjisë elektrike;
- gypat e ujësjellësit, ujitjes, ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike;
- linjat nëpërmjet të cilave kalon ngrohja, nafta, gazi apo ndonjë material apo prodhim tjetër prej pikës prodhuese, depos apo pikës së grumbullimit.

Aktualisht, AKK-ja nuk posedon të dhëna për përçojat, andaj as pjesën e të dhënave gjeohapësinore as baza tematike e të dhënave nuk është krijuar për të ruajtur këto të dhëna. Këto të dhëna, do të ruhen në bazën e të dhënave të Sistemit të përçojave të krijuar me këtë projekt.



Disa funksione të tjera që përfshin ky sistem:

- Mundësinë e ngarkimit të të dhënave për përçojat
- Editimin e përçojave
- Dhënien e të dhënave të përçojave për SIKTK-T dhe shfaqja e të dhënave në certifikata pronësie
- Dhënien e të dhënave të përçojave për SIKTK-HK, shfaqja e të dhënave në kopje plani dhe shfaqja e shtresave të veçanta në SIKTK-HK
- Shfaqjen e përçojave në Gjeoportali

5.1.6. SIKTK-Online

Para zhvillimit të projektit për avancimin e sistemeve kadastrale, AKK ka pasur sistem SIKTK-Online i cili ka qenë publik dhe i qasshëm përmes internetit. Me projektin e ri qëllimi ka qenë avancimi i tij, në mënyrë që të përballojë kapacitetet dhe funksionet e nevojshme për qasjen e jashtme për të gjithë përdoruesit, bazuar në kredencialet që ofrohen dhe menaxhohen përmes sistemit UCWSS.

Sistemi SIKTK-Online është avancuar me një ndërfaqe të përmirësuar për përdoruesit dhe shërbime të zgjeruara elektronike. Fokusi ka qenë në përmirësimin e qasjes të të dhënave dhe përvojës së përdoruesit, duke siguruar shërbime me cilësi të lartë për noterët, gjeodetët e licencuar, përmbaruesit privat, gjykatat dhe palët e tjera të interesuara. Sistemi është zhvilluar me masa të avancuara sigurie dhe do të jetë intuitiv dhe efikas për përdorim publik.

SIKTK-Online ka aftësinë për të menaxhuar shërbimet bazuar në rolin e përdoruesit dhe t'i bëjë ato të qasshme për cilindo shërbim që i është caktuar rolit të përdoruesit.

Institucionet e jashtme që përdorin sistemin SIKTK-Online do të kenë mundësinë që të kenë:



- Qasje në informacione të përditësuar për njësitet kadastrale
- Regjistrojnë lëndët për bartje të pronësisë
- Regjistrojnë shënime ose vërejtje
- Ngarkojnë dokumentet e nevojshme për lëndë
- Dorëzojnë lëndët e përpunuara në Zyrën Kadastrale Komunale (ZKK) për miratim në formë digjitale
- Komunikojnë me ZKK-në përmes një funksioni chat për të diskutuar lëndët dhe për të zgjidhur paqartësitë



Në sistemin SIKTK-Online janë zhvilluar edhe të gjitha komunikimet për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekave. Të gjitha institucionet që nuk kanë një sistem të vetin, mund të përdorin këtë sistem.

Pra ky sistem përmban Modulet e Noterëve, Përmbaruesve privat dhe Ndërmjetësuesve.

Në figurat mëposhtë mund të shihni si duket ky sistem:



Statistika nga përdorimi i sistemeve të reja:

Numri i lëndëve të regjistruara në eKadastrin nga (Noterët, Përmbauesit privat dhe Ndërmjetësuesit)	
PRISHTINË	1050
PRIZREN	823
FUSHË KOSOVË	716
FERIZAJ	646
GJILAN	489
SUHAREKË	358
GJAKOVË	354
PODUJEVË	321
VITI	280
VUSHTRRI	277
PEJË	264
LIPJAN	213
MALISHEVË	201
ISTOG	179
RAHOVEC	170
MITROVICË	153
KAMENICË	151
KAÇANIK	141
KLINË	139
GRAÇANICË	139
GLLOGOC	115
OBILIQ	113
SKËNDERAJ	111
SHTIME	108
NOVOBËRDË	107
MAMUSHË	76
DEÇAN	69
SHTËRPCE	65
DRAGASH	26
LEPOSAVIQ	24
RANILLUG	24
MITROVICË VERIORE	23
HANI I ELEZIT	21
JUNIK	18
PARTESHË	17
ZVEÇAN	15
KLLOKOT	11
ZUBIN POTOK	5

Trajnimi i Noterëve, Përmbauesve privat dhe Ndërmjetësuesve për
Modulët e reja të zhvilluara për Noter, Përmbaues privat dhe
Ndërmjetësues

Pas përfundimit të zhvillimeve në kuadër të këtij projekti në grupe të ndara janë
trajnuar Noterët, Përmbauesit privat dhe Ndërmjetësuesit.
Për këtë grup janë trajnuar:





5.1.7. SIKTK-API

AKK zotëron aplikacionin UCWSS i cili menaxhon API-të që AKK u ofron institucioneve të tjera jashtë AKK-së. Disa nga API-të konsumohen edhe jashtë këtij aplikacioni. Qëllimi me projektin e ri ka qenë që të unifikohen API-të në mënyrë që të gjitha API-të jashtë AKK-së të mund të publikohen vetëm përmes UCWSS. API-të që publikohen në sisteme të ndryshme janë mbledhur si një pikë e vetme për mirëmbajtje më të lehtë.


Konceptet kryesore janë:

- Qasja e jashtme në UCWSS bëhet përmes GG (Government Gateway)
- Përdoruesit e jashtëm (konsumatorët) të lidhur me GG mund të marrin informacione kadastrale duke përdorur shërbimin e jashtëm të internetit të mbështetur nga UCWSS.
- Përdoruesit e jashtëm duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave UCWSS
- Kur UCWSS merr një kërkesë për shërbim të jashtëm, UCWSS do të kërkojë dhe do të marrë informacionin aktual të kadastrës duke përdorur shërbimet ekzistuese të internetit të SIKTK.
- UCWSS do të kontrollojë kredencialet e përdoruesit dhe të drejtat e aksesit.
- Para se të përgjigjet për ueb shërbimin e jashtëm, UCWSS harton të dhënat e dhëna në ueb shërbimin e SIKTK-së sipas të drejtës së aksesit të konsumatorit.
- UCWSS mbështet funksionalitetin e përdoruesve për operatorët e AKK-së për të regjistruar dhe ruajtur informacionin e përdoruesit, të drejtat e aksesit dhe përkufizimet e hartës së të dhënave.

5.1.8. SIKTK-G

SIKTK-G pas përmirësimit: Ky sistem është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve WMS dhe WFS Ortofotot e viteve të ndryshme siç janë kapur, kufijtë e komunave, kufijtë e zonave kadastrale, dhe meqenëse ky sistem ka funksionuar në versionin më të vjetër të GeoServer dhe versionin Operativ Server, janë bërë zhvillimet e nevojshme që të përmirësohet në versionin më të fundit të GeoServer dhe Serverët më të fundit të Microsoft Operating, gjithashtu për të rritur performancën e serverit pasi ka qenë shumë i kufizuar në performancën e serverit.

Mëposhtë mund të shihni arkitekturën e SIKTK-G dhe funksionet tjera:




Në të gjitha sistemet, AKK i ka kushtuar vëmendje nevojës për siguri të fortë, integritet të të dhënave dhe qasje të përdoruesit. Angazhimi ynë për cilësinë dhe respektimi i praktikave më të mira në zhvillimin e TI-së janë të dukshme në zhvillimet e realizuara. Secili sistem është jo vetëm i shëndoshë teknologjikisht, por edhe në përputhje me objektivat strategjike dhe nevojat operacionale të AKK-së. Qasja ka qenë që të ofrojmë sisteme që janë të shkallëzueshme, të sigurta dhe efikase, duke plotësuar kërkesat specifike të secilit domen brenda AKK-së. Në disa nga modelet e të dhënave të sistemeve si SIKTK-T dhe SIKTK-HK, modeli i të dhënave bazohet në LADM, disa nga standardet mbi të cilat do të bazohemi janë:

- ISO 19152-2012 Informacioni gjeografik — Modeli i Domenit të Administrimit të Tokës (LADM)
- ISO/DIS 19152-1 Informacioni gjeografik — Modeli i Domenit të Administrimit të Tokës (LADM) — Pjesa 1: Modeli konceptual i përgjithshëm
- ISO/DIS 19152-2 Informacioni gjeografik — Modeli i domenit të administrimit të tokës (LADM) — Pjesa 2: Regjistrimi i tokës (nëse disponohet gjatë zhvillimit të modelit)

Të gjitha versionet e Geoserver janë përmirësuar në versionin më të fundit të GeoServer për të qenë të qëndrueshëm dhe për të pasur performancën më të mirë. Gjithashtu, të gjitha Sistemet Operacionale të Microsoft janë përmirësuar për të pasur sisteme operative të qëndrueshme dhe më pak të rrezikshme. Pasi që konsumi dhe numri i përdoruesve po rritet dita ditës, performanca e serverëve është rritur dhe është siguruar nivel i lartë i performancës e harduerit në ata serverë.

Në figurën e mëposhtme është elaboruar mënyra e komunikimit me përdoruesit e jashtëm dhe mënyrën se si ata do të komunikojnë të gjithë API-në përmes SIKTK Online API duke përdorur nënsistemin UCWSS.



5.3. Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së

Ky projekt ka pasur për qëllim zhvillimin, modernizimin dhe unifikimin e platformave gjeohapësinore të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, përmes ndërtimit të Gjeoportalit të ri dhe Gjeoportalit NSII (Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor). Projekti ka synuar rritjen e transparencës, lehtësimin e qasjes publike në të dhënat gjeohapësinore dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale të AKK-së për menaxhimin, shpërndarjen dhe integrimin e të dhënave kombëtare hapësinore në përputhje me standardet ndërkombëtare INSPIRE dhe NSII.

Qëllimet strategjike të projektit “Zhvillimi i Gjeoportalit NSII dhe Gjeoportalit të ri të AKK-së” janë konceptuar për të mbështetur transformimin digjital të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe për të forcuar rolin e saj si autoritet kombëtar për të dhënat gjeohapësinore. Projekti është fokusuar në krijimin e një infrastrukture bashkëkohore teknologjike, rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët dhe institucionet.

Qëllimet kryesore strategjike përfshijnë:

- **Modernizimi i infrastrukturës teknologjike** Rritja e kapacitetit të sistemit për të përballuar ngarkesa të larta, përmirësimi i performancës dhe siguri i një platforme të qëndrueshme për zhvillime të ardhshme.
- **Unifikimi i sistemit të adresave dhe kadastrit** Integrimi i burimeve të të dhënave në një platformë të vetme kombëtare për të eliminuar fragmentimin dhe për të siguruar konsistencë të informacionit.
- **Implementimi i arkitekturës SOA (Service-Oriented Architecture)** Mundësimi i modularitetit, shkallëzimit dhe integritetit të lehtë ndërmjet sistemeve të ndryshme përmes shërbimeve API dhe mikro-shërbimeve.
- **Digjitalizimi i shërbimeve për qytetarët dhe institucionet** Krijimi i një portali modern dhe të aksesueshëm 24/7 që ofron shërbime online pa pasur nevojë për prezencë fizike, duke rritur transparencën dhe efikasitetin administrativ.
- **Të dhënat gjeohapësinore NSII** Është mundësuar që në kohë reale të gjithë institucionet të mund të përditësojnë të dhënat gjeohapësinore duke validuar ato bazuar në direktivën INSPIRE dhe duke bërë të qasshme për të gjithë palët e interesit. Duke përdorur shërbime të ndryshme si WMS dhe WFS të mund të përdoren të dhënat të cilat janë në gjeoportalin NSII.
- **E-Commerce** Është mundësuar marrja e shërbimeve në kohë reale duke mundësuar që shërbimet pa pagesë të mund të shkarkohen menjëherë siç janë të dhënat e NSII dhe produktet të cilat janë me pagesë, me ndihmën e platformës eKosova të mund të paguhet komplet procesi online dhe në kohë reale të mund të shkarkohen ato.
- **Siguria e të dhënave** Është rritur siguria e të dhënave që të mos rrjedhin të dhënat pa miratim

Pas publikimit të versionit demo, i cili regjistroi rreth 200,000 klikime dhe mori dhjetëra komente nga përdoruesit përfshirë institucionet dhe profesionistët e fushës, shumica prej të cilave u integruan në versionin final, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka lansuar Gjeoportalin e Ri Shtetëror. (geoportal.rks-gov.net)

Gjeoportali ka një platformë moderne dhe të lehtë për përdorim, duke mundësuar qasje më të shpejtë dhe më të lehtë në të dhënat gjeohapësinore për të gjithë qytetarët dhe profesionistët e fushës.

Platformë e njejtë është edhe për gjeoportalin NSII, i cili është zhvilluar për herë të parë në vend. Gjeoportali për NSII mundëson shkëmbimin, publikimin dhe qasje në të dhëna gjeohapësinore ndërmjet institucioneve shtetërore dhe përdoruesve profesionalë.


Institucionet mund të shtojnë dhe azhurnojnë të dhënat e tyre, duke krijuar një bazë të përbashkët kombëtare, njëherit përdoruesit mund të shfrytëzojnë falas shërbimet WMS dhe WFS për qasje në të dhëna të hapura në aplikacione si GIS dhe platforma të tjera. Këto të dhëna janë të standardizuara sipas direktivës INSPIRE, duke garantuar përputhshmëri dhe cilësi.

Përfitimet kryesore të gjeoportalit të Ri


- Modeli 3D i territorit dhe ndërtesave - Mundëson shfaqjen e modelit digjital të terrenit (DTM) dhe vizualizimin tredimensional të objekteve me lartësi reale, duke ofruar pamje më realiste dhe të sakta të terrenit dhe ndërtesave.




- Kërkimi i avancuar me të dhëna tekstuale - Përdoruesit mund të kërkojnë sipas parcelës, adresës, ndërtesës, pjesëve të ndërtesës apo koordinatave, me rezultate të paraqitura në mënyrë vizuale dhe tabelare.



- Ndërfaqe moderne dhe qasje përmes platformës eKosova - Platforma ofron dizajn të ri, navigim të lehtësuar, pamje në ekran të plotë dhe kyçje të sigurt përmes llogarisë eKosova. Pas autentifikimit, përdoruesit mund të kenë qasje në të dhënat e **pronarëve të njësive kadastrale dhe në informacione të tjera përkatëse.**




- Vegla të reja për analizë dhe vizualizim - Përfshihen funksione për matjen e distancave dhe sipërfaqeve, vizatim grafik, printim me legjendë, si dhe gjenerim të lidhjeve "permalink" dhe kodeve QR për ndarjen e lokacioneve.



- Transparencë dhe krahasim i ortofotove - Funksioni i transparencës mundëson krahasimin e shtresave ortofoto nga vite të ndryshme, duke ndihmuar në vlerësimin e zhvillimeve hapësinore me kalimin e kohës.
- Optimizim për pajisje mobile dhe shpejtësi më të lartë - Platforma është plotësisht e përshtatur për pajisje mobile dhe siguron ngarkim më të shpejtë të shtresave dhe të dhënave.
- Hapja direkte e lokacioneve nga gjeoportali - Një veçori e re që e bën më të lehtë identifikimin dhe vizualizimin e lokacioneve në terren.
- Funksioni "Shko te vendndodhja" - Mundëson lokalizimin e pozicionit aktual të përdoruesit në hartë, duke lehtësuar navigimin ndërmjet shtresave të të dhënave gjeohapësinore.

Nga lansimi e deri me tash kemi këto statistika:

Gjeoportali	
Shtator 2025	67 mijë klikime
Tetor 2025	110 mijë klikime
Nëntor 2025	423 mijë klikime
Dhjetor 2025	466 mijë klikime
Janar 2026	300 mijë klikime



Gjatë zbatimit të projektit janë realizuar këto rezultate kryesore:

- U zhvilluan dy Gjeoportale moderne me arkitekturë të hapur (SOA), të bazuara në mikro shërbime dhe teknologji të avancuara si .NET 8, Angular, SQL Server 2019+ dhe VMWare.
- U integruan të gjitha burimet ekzistuese të të dhënave gjeohapësinore nga sistemet ARIS, KCLIS dhe NSDI, duke mundësuar qasje të centralizuar dhe të sigurt për qytetarët dhe institucionet.
- U implementuan shërbime gjeohapësinore (WMS, WFS, WMTS) për vizualizim, analizë dhe shkarkim të të dhënave në kohë reale.
- U ofrua ndërfaqe shumëgjuhëshe (shqip, anglisht, serbisht) me dizajn responsiv për aksesim nga PC dhe pajisje mobile.
- U përmbushën kërkesat për siguri, certifikatë SSL, auditim, kontroll të aksesit dhe identifikim me Single Sign-On.

5.4. Rindërtimi i Kadastrit

Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur në terren, të cilat nuk janë të paraqitura dhe mirëmbajtura me elaborat kadastral në kadastër, paraqesin mos-harmonizim të gjendjes faktike në terren me atë të regjistruar në kadastër. Ky mos-harmonizim përveç arsyes së mosmirëmbajtjes së rregullt të kadastrit, mos paraqitjes së kërkesave për ndryshim nga qytetarët vjen edhe si pasojë e vjedhjes së dokumentacionit nga Serbia gjatë luftës në Kosovë.

Rindërtimi i Kadastrit nënkupton krijimin e njësive kadastrale dhe rindërtimin e të drejtave pronësore për njësitë kadastrale dhe regjistrimin e tyre në RDPP. Projekti realizohet sipas Ligjit NR.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, UA nr.11/2024 për Procedurën e Rindërtimit të Kadastrit, UA nr.03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi pronën e Paluajtshme, UA nr. 08/2024 për Komisionet për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, si dhe akteve tjera në fuqi.

Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me Zyrat Kadastrale Komunale ka bërë përzgjedhjen e zonave kadastrale të cilat do të rindërtohen. Qëllimi primar i projektit është harmonizimi i gjendjes faktike të terrenit me atë në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë dhe ngritja e vetëdijes kolektive për rëndësinë që ka regjistrimi i pronës në emër të pronarit faktik.

Ky qëllim tentohet të arrihet përmes objektivave si: matja e gjendjes faktike në terren dhe zyrtarizimi i saj, bartjes së pronësisë përmes dhuratëdhënies apo shitblerjes, procesin e ndarjes, bashkimit apo identifikimit të parcelave në terren dhe për herë të parë bëhet edhe trajtimi i trashëgimisë si dhe informaliteti gjë e cila është mundësuar me ligjin e ri për Kadastër të Pronës së Paluajtshme. Po ashtu me këtë projekt trajtohen edhe ndërtimet pa leje të kategorisë së I-rë, ku përgatiten dosjet dhe dorëzohen nëpër zyrat e legalizimit të komunave për trajtim.

Për të arritur qëllimin dhe realizuar objektivat e parapara, projekti është ndarë në disa faza të realizimit të tij. Projekti i Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale në 91 Zona Kadastrale ka filluar në vitin 2025, gjatë të cilit janë realizuar këto faza:

- Informimi publik,
- Fushata e matjes,
- Shpallja e listave për trashëgimi dhe informalitet,
- Përgatitja dhe dorëzimi i lëndëve për:
 - Trashëgimi
 - Informalitet
 - Dhurim
 - Ndarje, bashkim,
 - Korrigjim i të dhënave për pronarët
- Mbajta e seancave për trajtimin e trashëgimisë.

Informimi publik

Me qëllim të informimit sa më të saktë, të drejtë dhe që projekti i RK të arrijë tek të gjithë banorët e zonave kadastrale ku po zhvillohet, janë mbajtur fushata të informimit publik në gjitha zonat kadastrale që janë ne proces të RIK-ut. Gjatë informimit publik është shpjeguar qëllimi i RK, procedurat e posaçme që aplikohen gjatë RK, përfitimet, të drejtat dhe obligimet e palëve etj.

Para mbajtjes së informimit publik qytetarët janë informuar përmes:

- Spoteve informues në TV dhe radio lokale për projektin e RK,
- Janë shpërndarë fletëpalosje të cilat kanë përmbajtur informata mbi rëndësinë e RK-ut dhe shpjegojnë procesin,
- Janë vendosur poster në pjesët më të dukshme dhe më të frekuentuara të zonës kadastrale ku zhvillohet RK si dhe në objektin e Komunës me informacione me rëndësi për qytetarët,
- Takime derë më derë me banorët.



Më poshtë keni përmbledhjen e statistikave të informimit publik dhe disa foto nga këto takime:

Lot	Pjesëmarrës
1	1017
2	1287
3	1530
4	6534
Gjithsej	10368









Linqet e videove informuese për Projektin e Rindërtimit të Kadastrit:



<https://www.facebook.com/reel/1203129411184302>
<https://www.facebook.com/reel/685872077254541>
<https://www.facebook.com/reel/707221255309422>
<https://www.facebook.com/reel/703429092037181>
<https://www.facebook.com/reel/545694988589685>
<https://www.facebook.com/reel/1899931587423608>

Fushata e matjes

Fushata e matjes OE pas kryerjes së Infomimit Publik dhe analizës së të dhënave të dorëzua nga AKK, OE ka bërë inventarizimin e zonës me qëllim identifikimin e mospërputhjeve të cilat kanë qenë në regjistra.

Më pas ka filluar me realizimin matjeve në bazë të planeve dinamike të aprovuara nga Komisioni. Matjet janë realizuar në bazë blloqeve të planifikuara nga OE dhe në bazë të kërkesave të paraqitura nga palët. Matja e parcelave bëhet sipas standardeve të përcaktuara në “Udhëzuesi i Punës 2024 për matjen, krijimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale”, po ashtu për të gjitha ndërtesat e indentifikuara nga OE do të maten dhe për to do të përgatiten elaboratet teknike për legalizim.

Para fillimit të matjeve në secilën zonë kadastrale janë vendosur pikat e kontrollit, ku në total janë vendosur gjithsej 228 pika.

Ekipet e terrenit para fillimit të fushatës së matjeve kanë përgatit këto të dhëna:


- Skicat e terrenit të cilat përmbajnë:
 - Kufijtë e parcelave nga gjendja e fundit e eksportuar nga SIKTK-HK,
 - Numrat e parcelave,
 - Parcelat të cilat ekzistojnë në SIKTK-T dhe mungojnë në SIKTK-HK,
 - Ortofotot e vitit 2024.
- Regjistrin e parcelave nga gjendja e fundit në SIKTK-T.

Gjatë fushatës së matjeve ekspertët e OE kanë bërë matjen vetëm të kufijve ekzistues në terren si:

- Guri natyral,
- Muri,
- Rrethojë,
- Kunjetj.

Gjate matjeve të kufijve prezent kanë qenë pronaret/shfrytëzuesit si dhe fqinjët, të cilët kanë prezantuar kufijtë para eksperteve të OE.

Secila ZK është ndarë në blloqe, ku secili bllok ka pas datat e planifikuara për matje.



Ndarja e ZK në blloqe

Matjet në terren janë realizuar me GPS si dhe Stacion Total, duke respektuar specifikat e matjeve të cilat janë të detajuara në Udhëzuesin e Punës si dhe në Udhëzuesin për Rindërtim.

Gabimi i lejuar (Δ) për matjet kadastrale është aprovuar sipas formulës për devijimin standard (σ): $\Delta = + 2 \sigma$ Devijimi standard për matjet me stacionon total është: $\sigma \leq 20\text{mm}$.

Matja e ndërtesave është realizuar me matje me Stacion Total si dhe në disa ZK janë matur me DRON, matje këto të cilat kanë rezultuar që ofrojnë saktësinë e përcaktuar në Udhëzuesin për Rindërtim konkretisht kapitullin 7.2.





Shpallja e listave për trashëgimi dhe informalitet

Pas hapjes së zyrave të OE-ve në zonat përkatëse në të cilat është duke u zhvilluar RK, ka filluar mbledhja e dokumenteve nga palët. Mbledhja e dokumentacionit është bere varësisht nga lloji i procesit që kanë, i gjithë dokumentacioni i mbledhur është sistemuar dhe janë hapur lëndë për secilin palë.

Për rastet e trashëgimisë palët kanë dorëzuar dëshmitë e vdekjes për pronarin, si dhe certifikatat e lindjes dhe letërnjoftimet për trashigmmarrësit. Ku me pas OE i ka verifikuar secilën dosje dhe do dorëzuar tek nenkomisioniet për publikim në webfaqen e AKK-së

<https://akk.rks-gov.net/sq/akk/rindertimi-i-kadastrit>

si dhe në Gazetën Zyrtare

<https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInstDetail.aspx?Index=2&InstID=616>

Për trashëgimi deri ne fund të vitit 2025 janë publikuar gjithsej 51, në tabelën me poshtë janë detajet.

Lot	Nr i Listave të publikuara	Rastet e paraqitura në listë	Nr i trashëgim-lënësve	Nr i trashëgim-marrësve
1	11	559	560	3506
2	15	683	685	5241
3	13	543	543	3465
4	12	607	625	2591
Totali	51	2392	2413	14803

Po ashtu për rastet e informalitetit deri në dhjetor 2025 janë publikuar 9 lista të informaliteteve, në të cilat janë paraqitur 7,229 raste.

Lot	Nr i Listave të publikuara	Rastet e paraqitura në listë	Nr i parcelave	Nr i shtitësve	Nr i Blerësve
1	5	1132	1982	1594	1301
2	10	4088	5182	5296	4712
3	5	613	877	1131	832
4	9	1396	1947	1941	1878
Totali	29	7229	9988	9962	8723

Përgatitja dhe dorëzimi i lëndëve

Pas përpunimit të të dhënave të marra nga fushata e matjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, OE-ja ka mbajtur takime individuale me palët dhe ka marr deklaratat e tyre për përgaditjen e lëndëve për komision.

Gjatë këtij viti, në zyrat e OE-së janë dorëzuar materiale të ndryshme për shqyrtim të trashëgimive, informalitetit, ndarjes, bashkimit, përcaktimit etj.

Në tabelën me poshtë janë paraqitur lëndët e dorëzuara deri në dhjetor 2025.

Lot	Komuna	Zonat e përfshira në RK	Numri i lëndëve (bashkim /ndarje /përcaktim)	Digjitalizimi i parcelave nga planet	Korrigjimi i numrave të parcelave në HK	Numri i objekteve të matura
Lot 1	Deçan	Carrabreg, Deçan,Isniq	1293	480	72	445
	Pejë	Baran,Gogë, Brestrovik,Glogjan, Radavc, Terstenik	1148	726	57	365
	Rahovec	Bellacerkë, Ratkoc	158	418		25
	Klinë	Dresnik, Dushi vogël, Klinë	671	733	135	241
	Gjakovë	Gjakovë Jashtë Qytet, Gjakovë Qytet, Jahoc,Zidi Sadik Agës	776	1350	92	613
	Istog	Carrallukë, Dobrushë, Gjurakovc , Kashicë	567	1096	130	237
Lot 2	Dragash	Dragash, Leshtan, Bresane, Pllajnik	1400	0	0	1446
	Shtime	Reçak, Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm	1792	1	0	948
	Ferizaj	Rahovicë, Balaj, Bablak	1298	0	0	583
	Shtërpçë	Gotovushë, Drekok, Jazhincë	1373	0	0	760
	Prizren	Zhur, Lubinjë e Poshtme, Landovicë, Pllanjan, Lez	2727	0	0	510
	Malishevë	Carrallukë, Terpezë, Pagarushë, Turjakë	6218	0	0	1681
	Suharekë	Sopije, Mushtisht, Samadrexhë, Gelancë	2819	0	0	1347
Lot 3	Vushtrri	Vushtrri Pjesë, Stanoc i Epërm, Oshlan, Dubovc, Qytezë dhe Beçiq	1731	671	507	3590
	Mitrovicë	Mitrovicë Pjesë, Mazhiq, Stantërg, Kçiç i Madh, Shipol	609	160	6	140
	Fushë Kosovë	Grabovc i Poshtëm, Bardh i Madh, Harilaq	901		99	494
	Skënderaj	Polac, Novosellë, Llaushë	470	423	425	0
	Glogoc	Tërstenik, Kishnarekë, Vërbovc	338	306	425	0
Lot 4	Prishtinë	Kodra Trimave, Arbëri, Taslixhe, Vranidoll, Mramor, Grashticë	2424	1078	0	810
	Podujevë	Dumnice e Poshtme, Llapashticë e Poshtme, Llapashticë e Epërme, Shajkoc	4079	0	0	80
	Obiliq	Obiliq Pjesë, Breznicë, Kryshec	1777	187	4	0
	Lipjan	Janjevë, Ribar i Madh, Kraishtë	1029	323	11	850
	Graçanicë	Graçanicë, Livagjë, Skullan	119	969	1	86
	Novobërdë	Kufcë e Epërme, Makresh i Epërm, Stanishor	158	0	220	1367
Totali			35875	8921	2184	16618

Mbajta e seancave për trajtimin e trashëgimisë

Pas marrjes së deklaratave të të palëve nga OE, lëndët janë dorëzuar tek nënkomisioni për shqyrtim. Pas analizimit të këtijë dokumentacioni nënkomisioni ka mbajtur seanca të veçanta në zyret e OE-së për shqyrtimin e lëndëve për trashëgimi dhe informalitet.





5.5. Kontrolli i kualitetit për Rindërtimin e Kadastrit



Detyra për Kontrollin e Kualitetit në Rindërtimin e Kadastrit (KK për RK) është pjesë thelbësore e projektit të Rindërtimit të Kadastrit dhe për rrjedhojë e Programit REGIP, i cili financohet nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) dhe zbatohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK). Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së të dhënave kadastrale dhe regjistrave të pasurisë së paluajtshme në Kosovë, përmes një procesi të plotë të rindërtimit të kadastrit në 115 zona kadastrale, të ndara në 5 LOT-e.

Operatori i Kontrollit të Kualitetit (OKK), ka përgjegjësi të siguroj që të gjitha veprimet dhe produktet e realizuara nga Operatorët Ekonomikë (OE) të jenë në përputhje me standardet teknike të përcaktuara nga AKK, si dhe me kërkesat ligjore dhe metodologjike të projektit. Ne jemi të angazhuar të kryejmë kontroll të jashtëm të pavarur dhe profesional në të gjitha fazat e përcaktuara të procesit.

Faza	Përshkrimi	Aktivitetet Kryesore
Faza 1: Përgatitja	Fillimi i projektit dhe planifikimi	- Dorëzimi dhe shqyrtimi i të dhënave ekzistuese nga AKK; - Përgatitja e Planit të Punës dhe Inventarit të Ndryshimeve Kadastrale (INK); - Trajnimi i OE dhe ndarja e zonave në blloqe.
Faza 2: Fushata e Informimit Publik dhe Përgatitja për Terren	Njoftimi i komunitetit dhe organizimi lokal	- Hartimi dhe shpërndarja e materialeve informuese; - Organizimi i takimeve me banorët; - Hapja e zyrave të OE në zonat kadastrale.
Faza 3: Fushata në Terren	Mbledhja e informacionit nga qytetarët dhe zhvillimi i matjeve në terren	- Mbledhja e të dhënave ligjore, tekstuale dhe grafike nga qytetarët; - Kryerja e matjeve për parcelat dhe ndërtesat.
Faza 4: Përpunimi i të Dhënave nga Terreni	Përgatitja teknike e të dhënave	- Digjitalizimi dhe strukturimi i të dhënave të mbledhura; - Përgatitja për futje në sistemin e rindërtimit të kadastrit.
Faza 5: Futja e të Dhënave në Sistemet RK dhe KCLIS-CM	Regjistrimi në sistemet zyrtare	- Regjistrimi i të dhënave tekstuale dhe grafike në sistemet përkatëse, sipas protokolleve dhe udhëzimeve të AKK.
Faza 6: Shikimi Publik	Transparencë dhe përfshirja e publikut	- Organizimi i periudhës 60-ditore të shikimit publik; - Trajtimi i ankesave dhe komenteve nga banorët.
Faza 7: Formalizimi i të Dhënave në Sistemet Zyrtare	Finalizimi dhe miratimi	- Finalizimi dhe zyrtarizimi i të dhënave në KCLIS dhe RK; - Përgatitja e dokumentacionit për miratim përfundimtar.

Disa nga aktivitetet të realizuara Vizita të rregullta në zyra për monitorimin e punës

Janë kryer vizita të rregullta në zyra kadastrale për monitorimin e procedurave administrative, si dhe vizita në terren së bashku me ekipet zbatuese për mbikëqyrjen e punimeve gjeodezike dhe kadastrale.



Kontrolli i fushatës së matjeve në terren

Ekipet e KK kanë zhvilluar një sërë aktivitete në terren me qëllim verifikimin dhe monitorimin e fushatave të matjeve të kryera nga Operatorët Ekonomikë të angazhuar në kuadër të projektit. Ky proces kishte për synim sigurimin e pajtueshmërisë së procedurave të matjes me Udhëzuesin për rindërtimin e kadastrit si dhe Udhëzuesin për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale AKK, si dhe vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe organizative të ekipeve që kryejnë punimet në terren.



Për realizimin e verifikimeve ne kemi hartuar një formular standard të vizitës në terren, i cili është përdorur në mënyrë uniforme për të gjitha ekipet e inspektuara. Formulari është konceptuar për të mundësuar mbledhjen e informacionit të strukturuar në lidhje me aspektet kryesore të zbatimit të fushatave të matjeve,

Formular për Vizitë të OE në Terren

Emri i komunës: Prishtinë Emri i zonës kadastrale: Arbër

Data e vizitës në terren: 24.09.2025 Emri i përfaqësuesit të OE-së: Elmedina Prengaj

Pozita/funksi: Agjent Kontakti i përfaqësuesit: 046-360-885

Identifikimi i mostres: 4353-13, 4353-14

Verifikimi i procesit të matjes:

1. A matet pika e njohur para fillimit të matjeve?
☒ Po ☐ Jo
2. A matet pika e njohur pas përfundimit të matjeve?
☒ Po ☐ Jo
3. A përdoret interval më i madh se 10 sekonda në matje?
☒ Po ☐ Jo
4. A janë respektuar udhëzimet për matjen me Total Station?
(Përshkrim i shkurtër, ex: traversë, pika fikse, të kombinuara etj.)
5. A është përdorur droni për matjen e kufijve kadastral?
☐ Po ☒ Jo
o Nëse po, a është bërë paraprakisht shenjimi i kufijve në terren?
☐ Po ☐ Jo
6. A mbahen skicat e terrenit gjatë procesit të matjes?
☒ Po ☐ Jo
7. A janë përdorur kodet e pikave sipas kornizës për matje?
☒ Po ☐ Jo
8. A ka dokumentim të punës (fotografi, skica, ditar pune)?
☒ Po ☐ Jo
o Nëse po, përshkruani:
9. Komente nga monitoruesi gjatë vizitës:
Në parcelat e mësipërme, mungon gjatësia grafike (nuk është e rregullt gjatësia grafike), nuk përputhet me planin. Është bërë inçastimi i gjatësisë faktike. Parcela 4353-13 trajton edhe krahëgjatësinë.

Secila vizitë është shoqëruar me intervista individuale dhe grupe me anëtarët e ekipeve, me qëllim vlerësimin e nivelit të njohurive teknike dhe të kuptimit të metodologjisë së punës. Krahas intervistave, KK ka kryer vëzhgime direkte të procesit të matjeve në terren, duke verifikuar nëse procedurat praktike janë në përputhje me kërkesat e Kornizës së Matjeve të AKK-së.

Bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura përmes formularëve të vizitës dhe intervistave me ekipet, KK konstaton se:

- Ekipet e OE-ve janë përgjithësisht të përgatitura profesionalisht dhe të mirë informuara lidhur me metodologjinë e matjeve;
- Përdorimi i pajisjeve GNSS dhe instrumenteve të tjera matëse po realizohet në mënyrë të saktë dhe në përputhje me udhëzimet teknike të AKK;
- Shënimet dhe dokumentacioni i mbajtur në terren është i rregullt dhe ekipet e matjeve demonstrojnë kuptim të qartë mbi procedurat e matjeve.
- Bashkëpunimi ndërmjet ekipeve të OE dhe përfaqësuesve të KK gjatë verifikimeve është vlerësuar si shumë i mirë, me nivel të lartë transparence dhe gatishmëri për bashkëpunim.

Megjithëse nuk janë evidentuar devijime të theksuara nga metodologjia e AKK-së, KK rekomandon që OE-të të vazhdojnë të kushtojnë rëndësi standardizimit të praktikave të dokumentimit dhe sinkronizimit të të dhënave pas çdo dite pune, në mënyrë që të minimizohen mospërputhjet e mundshme gjatë procesit të verifikimit të mëvonshëm.

Matja e pikave kontrolluese për verifikimin e saktësisë

Ekipet e Kontrollit të Cilësisë kanë bërë verifikimin e pikave kontrolluese të dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë. Nga gjithsej 288 pika të stabilizuara për katër (4) lote, janë kontrolluar 228 pika, që përfaqësojnë rreth 78% të totalit.

Verifikimi është kryer në përputhje me Udhëzuesin për Matje (2024) dhe Udhëzuesin për Rindërtimin e Kadastrit (2025), të cilët përcaktojnë kriteret e saktësisë sipas tipit të pikës. Pikat plotësuese të stabilizuara (kodi 14) duhet të përmbushin saktësi horizontale me devijim standard $\sigma \leq 0.030$ m, përkatësisht devijim të lejuar $|\Delta| \leq 0.060$ m, ndërsa pikat referente të rendit II (kodi 11) kërkojnë saktësi më të lartë me $\sigma \leq 0.020$ m, respektivisht $|\Delta| \leq 0.040$ m.

Matjet janë realizuar duke zbatuar procedurat standarde GNSS, me kohëzgjatje minimale matjeje prej një minute për pikë, duke siguruar stabilitet dhe besueshmëri të rezultateve. Për secilën pikë të kontrolluar në kuadër të projektit të rindërtimit të kadastrit, është përgatitur një raport individual teknik që përmbledh të dhënat e dorëzuara nga Operatorët Ekonomik, matjet e realizuara në terren nga KK, krahasimin e koordinatave me devijimet përkatëse, si dhe përputhshmërinë me standardet teknike të përcaktuara në Termat e Referencës dhe udhëzuesit përkatës. Raporti shoqërohet me fotografi dhe hartë orientuese për secilën pikë, duke siguruar dokumentim të plotë dhe vizual të cilësisë së punës së kryer, dhe shërben si bazë për vlerësimin teknik dhe institucional të përputhshmërisë me kërkesat e projektit.

Agjencia e Katshtimit e Katshtimit
Kosovës e Katshtimit e Katshtimit
Kosovës e Katshtimit e Katshtimit

abkons
AGENCIJA ZA KATASTAR

RAPORTI I KONTROLLIT TË KUALITETIT PËR PIKËN KONTROLLUESE

LOT: 1

Komuna: Gjakovë

Zona Kadastrale: Jahoc

Të dhënat e dorëzuara nga OE:

Nr. i Pikës: Jahoc (part)

y	7451798.38m
x	4695929.97m
b_elips	426.28m
b_orto	
Kodi	
hrms	
vrms	

Pozita e pikës kontrolluese

Kontrolla e Kualitetit

Të dhënat për pikën e matur

y	7451798.38m
x	4695929.97m
b_elips	426.267m
b_orto	
Kodi	14
Data	30.08.2025
hrms	0.005m
vrms	0.007m
Komente	
Statusi	Kontrolluar

Standardi i matjes

σ_{2D}	$\leq 0.03m$
Δ_{2D}	$\leq 0.06m$

Ndëryshimi [KK-OE]

Δy	-0.002m
Δx	0.001m
Δ_{2D}	0.002m (Irenda tolerancës)
Δb_{el}	-0.013m

Për verifikimin dhe kontrollimin e pikat plotësuese të stabilizuar ekipet e KK kanë përdorur sisteme digjitale për mbledhjen e të dhënve përmes tabletëve/smart phoneve. Ku secili ekip në terren pas qdo ndryshimit plotësimit të dhënave i ka sinkronizuar me server dhe ekipet tjera.




Matja e objekteve dhe parcelave për qëllime të kontrollit të cilësisë

Ekipet e Kontrollit të Kualitetit kanë zbatuar metodologjinë e matjes në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, udhëzimet administrative dhe udhëzuesit teknikë përkatës. Matjet kontrolluese janë realizuar duke përdorur pajisje gjeodezike, përkatësisht stacion total Leica TS16 P 1" R1000, pajisje GNSS Leica GS16 (RTK), X5, etj...

Në fazën fillestare të kontrollit është realizuar matja e një pike plotësuese të stabilizuar për secilën zonë kadastrale, e cila ka shërbyer si bazë për verifikimin e saktësisë së matjeve. Këto pika janë matur duke përdorur teknologjinë GNSS RTK. Krahاسimi i koordinatave të matur nga ekipet e Kontrollit të Kualitetit me ato të dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë ka treguar se devijimet planimetrike janë brenda kufijve të lejuar.

Stacionimi është realizuar duke aplikuar metodën e stacionimit të lirë (free station), ku janë përdorur tri pika të matura paraprakisht me GNSS. Matjet në këto pika janë kryer në dy pozita të instrumentit, për të rritur saktësinë e orientimit dhe pozicionimit të stacionit. Pas përlogaritjes së koordinatave dhe orientimit, është realizuar matje e përsëritur e njërës prej pikave të stacionimit për verifikimin e saktësisë. Në përfundim të matjeve të detajeve, është kryer sërish matja kontrolluese e së njëjtës pikë referente, me qëllim të vërtetimit të stabilitetit dhe konsistencës së matjeve gjatë gjithë procesit.



Kontrollimi i pikave të objekteve dhe krahاسimi me të dhënat e dorëzuara

Në fazën e kontrollit të kualitetit mbi objektet e matura, Operatorët Ekonomikë kanë dorëzuar skedarë grafikë në format DWG për zona të ndryshme kadastrale. Dokumentacioni shoqërues, si ai i bashkëngjitur me materialet ashtu edhe ai i transmetuar përmes email-it, në disa raste rezulton i paplotë dhe pa përshkrim të qartë të metodologjisë së përdorur për realizimin e matjeve. Në materialet e dorëzuara mungon dokumentimi i teknologjisë së aplikuar, metodës së matjes dhe pajisjeve të përdorura, gjë që kufizon mundësinë e verifikimit të plotë të procesit të prodhimit të të dhënave.




Figura 1 Shembull i te dhënave te dorëzuara

Me gjithë këto mangësi, ekipet e Kontrollit të Kualitetit kanë realizuar analizën e cilësisë bazuar në materialin e dorëzuar dhe në matjet kontrolluese të kryera në terren. Vlerësimi është fokusuar në saktësinë planimetrike dhe lartësive të objekteve, si dhe në përputhshmërinë e dokumentacionit grafik me gjendjen reale të evidentuar përmes ortofotove të fundit të vitit 2024.

Përzgjedhja e pikave të objekteve për matje kontrolluese është realizuar në mënyrë rastësore, me qëllim sigurimin e një mostre përfaqësuese dhe të paanshme të të dhënave të dorëzuara. Për secilën zonë kadastrale është synuar përfshirja e numrit maksimal të pikave të mundshme për verifikim, duke arritur deri në mbi 100 pika për zonë, në varësi të kompleksitetit dhe shtrirjes së objekteve. Kjo qasje ka mundur vlerësim më gjithëpërfshirës të saktësisë së matjeve dhe identifikim më të besueshëm të devijimeve të mundshme.

Gjatë matjeve është përdorur forma digjitale e mbledhje së shënimeve për disa objekte si fotografi për identifikim nëse etazhet janë në përputhje me ato që kanë dorëzuar OE.




Figura 2 Pikat e matura për kontroll në një zonë të caktuar

Gjatë kontrollit janë identifikuar raste të ndryshme tipike, përfshirë objekte ku të gjitha pikat kufitare janë brenda tolerancës, raste të përziera ku vetëm disa pika janë jashtë tolerancës, si dhe raste ku të gjitha pikat kufitare rezultojnë jashtë kufijve të lejuar. Po ashtu, janë evidentuar mospërputhje ndërmjet skicave DWG dhe gjendjes reale në terren, mungesë e paraqitjes së plotë të etazheve të objekteve, si dhe pasaktësi në paraqitjen e kufijve të kateve, sutereneve apo nënkulmeve.



Disa nga rastet e krahasimit

Kontrollimi i lëndëve dhe dokumentacionit të dorëzuar nga Operatorët Ekonomik (OE)

KK ka bërë edhe monitorimin lëndëve të cilat OE i kanë vendosur në Drive të ndarë në Server. Çdo vendosje e re është sinkronizuar dhe është vendosur në sistemin e gjurmimit të lëndëve. Në sistemin e gjurmimi të lëndëve janë evidentuar gjithë llojet e lëndëve, qoftë të atyre juridike, si trashëgimi, infomalitete, dhurim, etj qoftë edhe atyre teknike si ndarje, bashkim, rri rregullim, si dhe ato ne Korrigjimeve KCID,



Statistikat e lëndëve të dorëzuara dhe kontrolluara

Lotet	Lëndët total	Kontrolluara	Pa kontrolluara	Përqindja
Lot1 - GeoCad Group shpk	1050	720	330	68.571
Lot2 - News shpk	1732	569	1163	32.852
Lot4 - Geoproject	946	402	544	42.495
Lot3 - Geoguass	1135	686	449	60.441

Pas vendosjes në sistem përzgjedhja e lëndëve për kontroll ka qenë rastësore, ku lëndët janë cakatur në bazë prioritare sipas përqindjes që ne i kemi caktuar në secilën zonë sa do të jetë. Derisa me TeR kërkohet 10%. Aktualisht në secilën zonë në rindërtim lëndët e kontrolluara janë mbi 20%, derisa mesatarja për zonë dhe lot është mbi 50%.

Loti	Komuna	Zona	Zona_I	description	Nr. Lendesh	reference
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 05-10-12/2025	05-10-12/2025	005_002_Transaksion duke ju referu trashëgimis dhe ndarjeve L...
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 10/2025	10/2025	016_2025_Transhigimi me ndarje dhe deklarato te nenshkuara.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 04/2025	04/2025	004_2025_Transaksion me ndarje dhe deklarato te nenshkuara.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 106/2025	106/2025	106_2025_Transaksion i kompletuar me deklarato dhe ndarje te nen...
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 138/2025	138/2025	138_2025_Transaksione me ndarje dhe deklarato te nenshkuara.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 46/2025	46/2025	046_2025_Transaksion me deklarato te kompletuara.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 60/2025	60/2025	060_2025_Transaksion jo formal.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 26/2025	26/2025	026_Transaksion_Declaratat.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 08/2025	08/2025	008_2025_Transhigimi me ndarje e deklarato te kompletuara.pdf
Lot2 - News shpk	30-MAUSHEVE	2-Carralluke		539993 Lot2 - News shpk - 12/2025	12/2025	012_Transaksion_Declaratat.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-46/2025	21-46/2025	21-46-2025-Radoslav Ristic.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-37/2025	21-37/2025	21-37-2025-Vlastimir Domic.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-31/2025	21-31/2025	21-31-2025-Milevka Domic.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-74-2025	21-74-2025	21-74-2025-Ramadan Lipovica.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-42/2025	21-42/2025	21-42-2025-Jovan Simic.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-21/2025	21-21/2025	21-21-2025-Micim Ramadan.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 21-03/2025	21-03/2025	21-03-2025-Fatim Berjan.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Kufco E Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-07/2025	22-07/2025	22-07-2025-Fatim Berjan.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Makresh I Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-14-2025	22-14-2025	22-14-2025-Fatim Berjan.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Makresh I Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-08-2025	22-08-2025	22-08-2025-Fatim Berjan.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Makresh I Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-35-2025	22-35-2025	22-35-2025-Fatim Berjan.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Makresh I Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-13/2025	22-13/2025	22-13-2025-Burhan Rashit.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Makresh I Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-32/2025	22-32/2025	22-32-2025-Korrigim i pjeses grafike.pdf
Lot4 - Geoproject	14-NOVOBERDE	4-Makresh I Epërme		539996 Lot4 - Geoproject - 22-32/2025	22-32/2025	22-32-2025-Korrigim i pjeses grafike.pdf

Lëndët rastësore të përzgjedhura për kontroll

Code	Lenda/pershkrim	Komuna	Zona ne Rindertim	Nr. Lendesh	Data	Tipi	Referenca (emri fajtit/lendesh)
Lot1 - 174/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 17...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	174/2025	2025-08-07	Marrveshje Ndormjete	174_Abedin Zeqiri - Bartjo me...
Lot1 - 26/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 2...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	25/2025	2025-08-08	Transaksion jo forma	25-2025_Ismet Januz Borisha...
Lot1 - 24/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 2...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	24/2025	2025-08-07	Dhurata, Transaksion jo...	24-2025_Ramiz Haki Fotoshi...
Lot1 - 23/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 2...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	23/2025	2025-08-07	Dhurata, Transaksion jo...	23-2025_Ramiz Fotoshi_dhuri...
Lot1 - 22/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 22...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	22/2025	2025-08-07	Dhurata, Transaksion jo...	22-2025_Zanun Isam Popaj_d...
Lot1 - 21/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 21...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	21/2025	2025-08-06	Dhurata, Transaksion jo...	21-2025_Zanun Isam Popaj_d...
Lot1 - 20/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 2...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	20/2025	2025-08-06	Dhurata, Transaksion jo...	20-2025_Zanun Isam Popaj_d...
Lot1 - 19/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 19...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	19/2025	2025-08-06	Dhurata, Transaksion jo...	19-2025_Zanun Isam Popaj_d...
Lot1 - 18/2025	Lot1 - GeoCad Group shpk - 18...	10-RAHOVEC	1-Bellacorkë	18/2025	2025-08-06	Transaksion jo forma	18-2025_Sodik Fotoshi_Shibla...

Code

Lot1 - 18/2025

Lenda/pershkrim

Lot1 - GeoCad Group shpk - 18/2025

Komuna

10-RAHOVEC

Zona ne Rindertim

1-Bellacorkë

Nr. Lendesh

2025-08-06

Data

2025-08-06

Tipi

Transaksion jo forma

Referenca (emri fajtit/lendesh)

18-2025_Sodik Fotoshi_Shiblarja jo formale.pdf

Fajli i Lendesh (link)

18-2025_Sodik Fotoshi_Shiblarja jo formale.pdf (2 MB)

KONTROLLI KUJALITETI

Koment

Mungon qartifikata e pronesis.

Numeri personal i blerjes ndryshon prej listavejtohetit (isa).

Ka mospërputhje të deklaratoeve lidhur me vitin e shitjes së pronës (dëshmitarët deklarojnë që prona është shitë në vitin 2006, shitësi deklaroi që e ka shitë në vitin 2010, ndërsa blerësi deklaroi që e ka blerë në vitin 2019).




Secila lëndë është kontrolluar dhe shoqëruar me komente përkatëse, duke treguar kombinimet e veprimeve të kryera dhe natyrën e tyre ligjore. Secilës lëndë iu është dhënë edhe statusi: Kontrolluar (kur është në rregull, por ka edhe rekomandimet), Rikthyer (kur ka mungesë, ose dokumentacioni nuk është në rregull), Larguar (kur OE e ka largu lëndën nga serveri).

Ky proces ka lejuar identifikimin e çdo mungese dhe ka siguruar që çdo dosje e dorëzuar të jetë e kompletuar dhe në përputhje me standardet e KK-së. Të dhënat nga sistemi me komentet janë eksportuar në Excel dhe dërguar tek Menaxheri i Projektit dhe OE, për përmirësim.

[illegible]

Komentet e KK për lëndat e dorëzuara nga OE LOTI



Për secilën lëndë të kontrolluar po ashtu janë identifikuar cilat njësi kadastrale janë pjesë dhe si të tilla janë pasqyruar në sistem automatikisht në pjesën grafike. Si më poshtë.



Monitorimi i publikimit të listave të trashëgimisë dhe listat informaliteteve

Një nga aktivitetet e Kontrollit të Kualiteti ka qenë verifikimi i publikimit të listave të trashëgimisë dhe informalitetit në zonat kadastrale. Ky kontroll është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr.11/2024, i cili përcakton se listat duhet të jenë të publikuara në zyrat kadastrale, në webfaqen e AKK-së dhe në portalin e Gazetës Zyrtare të Kosovës.

Përveç rasteve të verifikimit fizik gjatë vizitave në terren, këto lista publikohen në vazhdimësi, andaj është bërë edhe verifikimi i këtij procesi duke realizuar kombinim të metodave të ndryshme. Fillimisht, janë kontaktuar me telefon zyrtarët përgjegjës të zyrave për të konfirmuar nëse listat ishin publikuar dhe, kur kjo ishte e vërtetuar, iu kërkuar që të dërgonin foto si dëshmi. Ky proces njëkohësisht shërbeu edhe për të kontrolluar praninë e tyre në zyrë gjatë orarit të punës. Gjithë këto lista dhe verifikimi i tyre janë evidentuar në sistemin për gjurmim të aktiviteve.



Nga monitorimi i këtyre listave janë evidentuar 51 listat të publikuar në total për 4 lote, në të cilat janë paraqitur 2,392 raste. Këto lista kanë përfshirë 2,413 trashëgimlënës dhe gjithsej 14,803 trashëgimtar apo trashëgimmarrës.

Listat e trashëgimisë	Nr i Listave të publikuara	Rastet e paraqitura në listë	Nr i trashëgim-lënësve	Nr i trashëgim-marrësve
Lot1 - GeoCad Group shpk	11	559	560	3506
Lot2 - News shpk	15	683	685	5241
Lot3 - Geogauss	13	543	543	3465
Lot4 - Geoproject	12	607	625	2591
Totali	51	2392	2413	14803

Paralelisht, është monitoruar edhe publikimi i listave të shitblerjes. Gjatë kësaj periudhe janë publikuar 29 lista të informaliteteve, në të cilat janë paraqitur 7,229 raste. Këto raste kanë përfshirë 9,988 parcela, 9,962 shitës dhe 8,723 blerës. Numri i lartë i rasteve dhe subjekteve të përfshira dëshmon për kompleksitetin e procesit dhe nevojën për monitorim të vazhdueshëm për të siguruar saktësi dhe transparencë në regjistrimin e transaksioneve pronësore.




Figura 7 Krahasimi i vektorit të parcelave grafike dhe planit 1:1000 nga të dhënat e pranuar nga AKK




Figura 8 Krahasimi i vektorit të parcelave grafike dhe planit 1:2500 nga të dhënat e pranuar nga AKK



Figura 13 përdorimi i planit të gjeoreferencuar nga OE, për kontrollim të sipërfaqeve.

5.6. Konvertimi i të dhënave në SIKTK për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave

Objektivi kryesor i këtij projekti ishte ngritja e kualitetit të të dhënave kadastrale duke unifikuar të dhënat në regjistrat kadastral për njësitë pjesë të ndërtesave, ofrimi i informacioneve me besueshmëri më të lartë për qytetarët përmes gjeoportalit shtetëror. Kjo është bërë duke i azhurnuar në hartën kadastrale pjesët e ndërtesave të krijuara nga projektet e kadastrit të ndërtesave si dhe pjesët e ndërtesave të regjistruara në SIKTK-T nga zyret kadastrale por që nuk i kanë azhurnuar në hartën kadastrale. Si dhe është bërë harmonizimi i ID për pjesët e ndërtesave me qëllim që të krijohet mundësia e lidhjes së njësisë në të dy regjstrat.

Aktivitet tjetër shumë i rëndësishëm i këtij projekti ka qënë azhurnimi i lëndëve të prapambetura në komunë e Shtëpcës. Mungesa e stafit të punësuar në komunën e Shtëpcës ka pamundësuar azhurnimin e të gjitha lëndëve në regjistrat kadastral. Azhurnimi i këtyre të dhënave është bërë vetëm në regjistrat e ndërrimeve në zkk, duke pamundësuar kështu nxjerrjen e të dhënave nga SIKTK-T dhe SIKTK-HK.


Prandaj përmes këtij projekti OE ka arritur te skenoj, të indeksoj dhe ti azhurnojë këto lëndë në regjistrat përkatës duke e hapur kështu mundësinë që qytetarët të paisem me certifikata të pronës përmes e-kosovës por edhe institucionet e tjera ti dërgojnë kërkesat e tyre online.


Projekti ka filluar në tetor të vitit 2024 dhe ka përfunduar në nëntor të vitit 2025. Aktivitetet kryesore të parapara në projekt kanë qenë:

- Krijimi, konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave;
- Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave të për pjesët e ndërtesave të regjistruara në SIKTK-T, por jo në SIKTK-HK;
- Harmonizimi i ID-ve të njësive “Pjesë të Ndërtesave” të regjistruara në të dy sistemet (SIKTK-T dhe SIKTK-HK);
- Regjistrimi i transaksioneve të mbetura (ndryshimeve) të ZKK-së Shtëpcë në SIKTK-T.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur statistikat e njësive, përkatësisht lëndëve të realizuara sipas 4 aktiviteteve të parapara me kontratë:

Përshkrimi	Krijimi, konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të ndërtesave	Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave të prapambetura për njësitë kadastrale të pjesëve të ndërtesës të cilat janë regjistruar në SIKTK-T por jo në SIKTK HK	Harmonizimi i të dhënave kadastrale të pjesëve të ndërtesës të regjistruara në SIKTK-T dhe SIKTK-HK	Regjistrimi i transaksioneve të prapambetura për ZKK Shtëpcë
Njësitë - Lëndët e përfunduara në bazë të aktiviteteve të parapara me kontratë	11,434	54,521	869	3,517





Arkivi i lëndëve

Detajet e Lëndës

Zona Kadastrale	Jazhincë	Numri Referues	6732-2015	Lloji i lëndës	Ndarja
Gjendja e lëndës	E pranuar	Numrat kadastrale	P-72717043-00294-1,	Komentet/Vërejtjet	D
Nëjerr certifikatat					

Tabela e gjendjes se vjetër

Numri kadastrale	Lloji i njësise kadastrale	Sipërfaqja	Të drejtat
P-72717043-00294-1	PARCELË	600 m2	Paraqit

Tabela e gjendjes së re

Numri kadastrale	Lloji i njësise kadastrale	Sipërfaqja	Gjendja	Të drejtat
P-72717043-00294-3	PARCELË	360 m2	UL-72717043-00131	Paraqit
P-72717043-00294-4	PARCELË	240 m2	UL-72717043-00131	Paraqit

Detajet e Lëndës

Zona Kadastrale	Jazhincë	Numri Referues	14311-2023	Lloji i lëndës	Bartja e posedimit - Trashegimi
Gjendja e lëndës	E pranuar	Numrat kadastrale	P-72717043-00031-0,P-72717043-00033-0,P-72717043-00280-0,P-72717043-00519-0,P-72717043-00795-0,P-72717043-00896-0,P-72717043-01248-0,P-72717043-01249-0,P-72717043-01471-0,P-72717043-01834-0,P-72717043-02394-0,P-72717043-02515-0,P-72717043-02516-0,	Komentet/Vërejtjet	
Nëjerr certifikatat					

Tabela e gjendjes se vjetër

Numri kadastrale	Lloji i njësise kadastrale	Sipërfaqja	Të drejtat
P-72717043-00031-0	PARCELË	430 m2	Paraqit
P-72717043-00033-0	PARCELË	300 m2	Paraqit
P-72717043-00280-0	PARCELË	1234 m2	Paraqit
P-72717043-00519-0	PARCELË	200 m2	Paraqit
P-72717043-00795-0	PARCELË	901 m2	Paraqit
P-72717043-00896-0	PARCELË	308 m2	Paraqit
P-72717043-01248-0	PARCELË	660 m2	Paraqit
P-72717043-01249-0	PARCELË	1110 m2	Paraqit
P-72717043-01471-0	PARCELË	1067 m2	Paraqit
P-72717043-01834-0	PARCELË	5217 m2	Paraqit
P-72717043-02394-0	PARCELË	1809 m2	Paraqit
P-72717043-02515-0	PARCELË	3195 m2	Paraqit
P-72717043-02516-0	PARCELË	1298 m2	Paraqit

Tabela e gjendjes së re

Numri kadastrale	Lloji i njësise kadastrale	Sipërfaqja	Gjendja	Të drejtat
P-72717043-00031-0	PARCELË	430 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-00033-0	PARCELË	300 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-00280-0	PARCELË	1234 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-00519-0	PARCELË	200 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-00795-0	PARCELË	901 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-00896-0	PARCELË	308 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-01248-0	PARCELË	660 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-01249-0	PARCELË	1110 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-01471-0	PARCELË	1067 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-01834-0	PARCELË	5217 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-02394-0	PARCELË	1809 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-02515-0	PARCELË	3195 m2	UL-72717043-00015	Paraqit
P-72717043-02516-0	PARCELË	1298 m2	UL-72717043-00015	Paraqit

Detajet e Lëndës

Zona Kadastrale	Jazhincë	Numri Referues	418-2013	Lloji i lëndës	Bartja e posedimit - Blerje
Gjendja e lëndës	E pranuar	Numrat kadastrale	P-72717043-00445-2,	Komentet/Vërejtjet	
Nëjerr certifikatat					

Tabela e gjendjes se vjetër

Numri kadastrale	Lloji i njësise kadastrale	Sipërfaqja	Të drejtat
P-72717043-00445-2	PARCELË	240 m2	Paraqit

Tabela e gjendjes së re

Numri kadastrale	Lloji i njësise kadastrale	Sipërfaqja	Gjendja	Të drejtat
P-72717043-00445-2	PARCELË	240 m2	UL-72717043-00103	Paraqit



5.7. Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit

Në Republikën e Kosovës janë zhvilluar shumë procese të shpronësimit si nga niveli qendror ashtu edhe ai lokal, por një numër i konsiderueshëm i tyre kanë qenë ende të paregjistruara në SIKTK. Me anë të këtij projekti, AKK ka synuar që të regjistrojë të gjitha pronat e shpronësuara në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokave të Kosovës (SIKTK), sipas vendimeve përfundimtare të bazuar në studimin e plotë teknik të pronës së paluajtshme të shpronësuar.

Implementimi i projektit ka filluar në tetor të vitit 2024 dhe ka përfunduar në dhjetor të vitit 2025.



Fushëveprimi i projektit

Departamenti i shpronësimeve nga MMPHI ka deklaruar se posedon të dhëna të përfshira në vendime përfundimtare të shpronësimeve.

Derisa ka një numër të konsiderueshëm të vendimeve të shpronësimeve të ndërmarrjeve publike si KOST, KEK, KRU Prishtina, NP Termokos si dhe shpronësime tjera të realizuara nga komunat për prona shoqërore si dhe disa shpronësime të institucioneve tjera shoqërore, për te cilat shpronësime nuk mund të thuhet që janë të përfshira në numrin e pronave të lartcekura.

Si aktivitet fillestar i projektit “Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit”, ka qenë studimi i hollësishëm për të gjitha të dhënat e shpronësuara duke i krahasuar të dhënat e shpronësuara me të dhënat në SIKTK si dhe me vendimet përfundimtare të shpronësimit.

Të dhënat (elaboratet) të cilat i plotësojnë kriteret për tu regjistruar në SIKTK, përgatiten nga OE dhe në koordinim me AKK fillon regjistrimi i tyre në SIKTK. Derisa, të dhënat (elaboratet) të cilat kanë mangësi dhe nuk i plotësojnë kriteret për regjistrim në SIKTK (bazën grafike dhe tekstuale), nga OE do të bëhet plotësimi dhe korrigjimin e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi dhe përgatitjen e tyre për regjistrim në SIKTK.



Aktivitetet kryesore të parapara në projekt kanë qenë:

- Korrigjimi dhe plotësimi i të dhënave të mangëta në elaboratet të shpronësimit
- Krijimi i elaboratit komplet të shpronësimit bazuar në vendimin përfundimtar
- Matje në terren për rastet kur konstatohet se është e domosdoshme
- Regjistrimi i njësive/pronave të shpronësuara në SIKTK-HK (baza grafike)
- Regjistrimi i njësive/pronave të shpronësuara në SIKTK-T (baza tekstuale).

Nga 34 Vendimet përfundimtare të shpronësimit janë përfshirë njësi kadastrale nga 13 Komuna dhe 90 Zona Kadastrale janë të regjistruara në SIKTK-T dhe SIKTK-HK gjithësejt 10,317 njësi Kadastrale, të cilat janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme sipas komunave.

Nr.	Komuna	Numri i Njësive
1	FERIZAJ	1238
2	GJAKOVË	656
3	GJILAN	195
4	GRAÇANICË	2048
5	HANI I ELEZIT	439
6	KAÇANIK	599
7	KLINË	1805
8	LIPJAN	1280
9	MALISHEVË	71
10	NOVOBËRDË	1334
11	PEJË	607
12	PRISHTINË	23
13	ZUBIN POTOK	22
Gjithësejt		10317

5.8. Ndërlidhja e qytetarit me adresë zyrtare

Duke pasur parasysh nevojën e institucioneve për të përmirësuar kualitetin e shënimeve që ndërlidhen me adresën dhe lidhjen e qytetarit me adresë të saktë, ka lindur nevoja e vendosjes së bashkëpunimit në mes të ARC, AKK dhe ASHI.

Ofrimi i të dhënave të caktuara nga sistemet burimore elektronike për ndërlidhjen e qytetarit me adrese të sakta është me rëndësi pasi që i mundësohet kërkimi dhe identifikimi i saktë i të dhënave përkatëse përmes parametrave të caktuar.

Me qëllim të koordinimit sa më të mirë dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, për të realizuar projektin e kompletimit të Sistemit të Adresave, janë nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me institucione të ndryshme si: Komunitet, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Agjencinë për Shoqëri të Informacionit. Metodologjia e përzgjedhur përfshin angazhimin dhe kontraktimin i një numri të caktuar të stafit për 12 muajve nga AKK dhe vendosja e tyre nëpër komuna (në zyrat lokale të gjendjes civile), ku qytetarët obligohen që të përcaktojnë adresën tek stafi i angazhuar nga AKK, më pastaj stafi të regjistroj adresën në modulën e zhvilluar nga AKK për gjenerimin e Formularit për identifikimin e adresës. Më pastaj të dhënat e adresës të bazuara në këtë formular si dëshmi e pranuar, përditësohen në Sistemin e Gjendjes Civile për qytetarin përkatës. Ky proces duhet të zgjasë së paku 12 muaj, duke u mbështetur edhe nga një fushatë e madhe e informimit publik.

Procesi i deklarimit të adresës mund të realizohet edhe përmes platformës e-Kosova, ku qytetarët pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në zyrat e gjendjes civile mund të deklarojnë adresën zyrtare online. Së pari bëhet integrimi i pjesës tekstuale të ARIS-it në platformën e-Kosova, e më pastaj edhe integrimi i pjesës grafike të ARIS-it përmes uebshërbimeve.

Pas përcaktimit të adresës në platformën eKosova nga ana e qytetarit, në ZGJC-në përkatëse automatikisht si dëshmi e ndryshimit të adresës në formë elektronike shfaqet Formulari i AKK-së për identifikimin e adresës si dhe në fund nga ZGJC përkatëse konfirmohet ndryshimi i adresës.

Procedurat e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare janë:

- 1. Procedura përmes paraqitjes së qytetarit në zyrat Komunitet të Gjendjes Civile;
 - Paraqitja e qytetarit në zyrën e Gjendjes Civile Komunitet, tek stafi mbështetës për ndërlidhje;
 - Deklarimi i qytetarit për adresën para stafit mbështetës për ndërlidhje;

- Regjistrimi i numrit personal dhe adresës nga stafi mbështetës për ndërlidhje, në modulën për identifikim të adresës në Sistemin e Adresave;
 - Printimi i Formularit për Identifikim të Adresës;
 - Paraqitja e Formularit për Identifikim të Adresës tek zyrtari i gjendjes Civile;
 - Përditësimi i Adresës së qytetarit në Sistemin e Gjendjes Civile nga zyrtari i zyrës së gjendjes civile;
- **2. Procedura online përmes platformës E-Kosova.**
- Deklarimi i adresës zyrtare nga qytetari në platformën E-Kosova;
 - Shkarkimi i online i Formularit për Identifikim të Adresës nga zyrtari i gjendjes civile;
 - Aprovimi i Formularit për Identifikim të Adresës nga zyrtari i gjendjes Civile;
 - Përditësimi i adresës së qytetarit në Sistemin e Gjendjes Civile;
- **3. Aktivitetet e realizuara rreth ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare:**
- Janë kontraktuar 55 persona si staf mbështetës për procesin e ndërlidhjes;
 - Stafi mbështetës është vendosur nëpër zyra të gjendjes civile komunale;
 - Stafi mbështetës është trajnuar rreth procedurave të ndërlidhjes, përmes modulit për Formularin për Identifikim të Adresës në Sistemin e Adresave;
 - Është realizuar takimi me kryetarë të komunave nga AKK, ARC, ASHI, qëllimi informimi rreth procesit dhe përgjegjësi;
 - Procesit ka filluar me 01 Tetor dhe zgjat 12 muaj;
 - Është realizuar ndërlidhja teknike në mes Sistemit të Gjendjes Civile me Sistemin e Adresave;
 - Është Integruar moduli i formularit për identifikim të adresës në E-Kosova;

Forma e Formularit për identifikim të adresës



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/ Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture/ Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KOSOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA/KOSOVO CADASTRAL AGENCY

FORMULARI PËR IDENTIFIKIM TË ADRESËS/OBRAZAC ZA IDENTIFIKACIJU ADRESE/ADDRESS IDENTIFICATION FORM

Nr. Serik/Serijki broj/Serial number:	170092025
Data dhe koha e lëshimit/Datum i vreme izdavanja/Date and time of issue:	02/10/2025 10:02:02 AM
Komuna/Opština/Municipality:	FUSHË KOSOVË
Zyra e Planifikimit Urban/Kancelarija urbanog planiranja/Urban Planning Office:	FUSHË KOSOVË
Printuar nga/Odštampano od/Printed by:	Dataprogrnet

ADRESA ZYRTARE E PERSONIT/ZVANIČNA ADRESA LICA/PERSONS OFFICIAL ADDRESS

Emri dhe Mbiemri Ime i prezime Name and surname	Nr. personal Lični broj Personal number	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Nr. i hyrjes Br. ulaza Entrance No.	Nr. i katit Br. sprata Floor No.	Nr. i banesës Br. stana Apartment No.	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Vendbanimi Naselje Place	Komuna Opština Municipality

Personi zyrtar/Službeno lice/Officer

Deklarata e personit për vërtetim të adresës

	Nr. references/Referentni broj/Reference number: 170092025
--	--

DEKLARATË E PERSONIT PËR VËRTETIM TË ADRESËS
IZJAVA LICA O POTRVDI ADRESE
PERSONS DECLARATION ON ADDRESS CERTIFICATE

Unë, Amir Mehdi Sogojeva, me numër personal 1030276015 deklaroj se adresa ime aktuale e banimit gjendet në:
 Ja, Amir Mehdi Sogojeva, sa ličnim brojem 1030276015 izjavljujem da je moja trenutna adresa stanovanja:
 I, Amir Mehdi Sogojeva, with personal number 1030276015 declare that my current residential address is at:

Emri i rrugës/Naziv ulice/Street name	DARDANIA
Nr. i hyrjes/Br. ulaza/Entrance No.	155/1
Nr. i katit/Br. sprata/Floor No.	6
Nr. i banesës/Br. stana/Apartment No.	42
Vendbanimi/Naselje/Place	Fushë Kosovë
Komuna/Opština/Municipality	FUSHË KOSOVË

Si banor i kësaj adrese për të cilin deklaroja dhe aplikova për formularin për identifikim të adresës, i pranoj të gjitha përgjegjësitë për saktësinë e të dhënave të paraqitura me lartë./Kao stanovnik ove adrese za koju sam se prijavio i podneo zahtev za obrazac za identifikaciju adrese, prihvatam svu odgovornost za tačnost gore navedenih podataka./As the resident of this address for which I declared and applied for the address identification form, I accept all responsibilities for the accuracy of the data presented above.

Jam i vetëdijshëm se organi kompetent nuk do të bëjë inspektim të adresës për qëllimet e shqyrtimit të këtij aplikimi, dhe se me lëshimin e formulari për identifikim të adresës organi kompetent nuk merr përgjegjësi për saktësinë e informacionit të dhënë nga ana ime./Upoznat sam da nadležni organ neće vršiti uvid u adresu radi razmatranja ove prijave, te da izdavanjem obrasca za identifikaciju adrese nadležni organ ne preuzima odgovornost za tačnost podataka koje sam dao./I am aware that the competent body will not inspect the address for the purposes of reviewing this application, and that by issuing the address identification form the competent body does not assume responsibility for the accuracy of the information provided by me.

Jam i vetëdijshëm se kjo adresë do të shënohet në formulari për identifikim të adresës dhe do të regjistrohet në sistemin zyrtar të adresave./Svestan sam da ova adresa biti navedena u obrascu za identifikaciju adrese i biće registrovana u zvaničnom sistemu adresa./I am aware that this address will be recorded in the address identification form and will be registered in the official address system.

Vendi dhe data/Mesot i datum/Place and date: _____

Nënshkrimi i deklaruarit/Potpis aplikanta/Applicants signature _____

Nënshkrimi i zyrtarit kompetent që e pranon këtë deklaratë/Potpis službenog lica koji je primio izjavu/Signature of the competent official accepting the declaration _____

Harta e Adresës



Baza ligjore e procesit të ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

Agjencia Kadastrale e Kosovës së bashku me Agjencinë për Regjistrim Civil i kanë kushtuar rëndësi edhe bazës ligjore mbi të cilën bazohet procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare.

Baza ligjore ku bazohet procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë është:

- Ligji për Sistemin e Adresave Nr. 04/L-071;
 - Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 16/2019, Për Procedurat e Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Komunal të Adresave dhe Regjistrat Shtetëror të Adresave, Neni 6, Paragrafi 5.
- Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 03/2015 Për Procedurat e Lajmërimit dhe Ç'lajmërimit të Vendbanimit apo Vendqëndrimit, Neni 3, Paragrafi 5.4, nën paragrafi 5.4.1;

Informimi publik për procesin e ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

Duke parë rëndësinë e procesit të ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare, Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil ka realizuar edhe informim publik rreth procesit publik. Informimi publik është realizuar në teren duke shpërndarë fletushka rreth procesit të ndërlidhjes dhe duke bashkëbiseduar me qytetar rreth procedurave të deklarimit të adresës zyrtare dhe përfitimet nga procesi i ndërlidhjes.

Foto gjatë informimit publik



Përfitimet nga procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare

Përfitimet nga përdorimi i adresës zyrtare dhe unike janë të mëdha duke filluar nga shërbimet komunale, identifikimi i lokacionit nga organet e emergjencave dhe sigurisë, planifikime rreth migrimit, në shëndetësi arsim etj..



Më poshtë janë paraqitur vetëm disa nga përfitimet më të rëndësishme nga procesi i ndërlidhjes së qytetarit me adresë zyrtare dhe unike:

- Mundëson pajisjen e qytetarëve me adresë zyrtare dhe unike;
- Është rekomandim i BE-së në kuadër të reformës zgjedhore në kuadër të ERA2;
- Mundëson përdorimin e adresës zyrtare dhe unike nga të gjithë regjistrat shtetëror;
- Mundëson pastrimin e listave të votuesve dhe zvogëlimin e distancës për të votuar;
- Mundëson të dhënat e sakta rreth migrimit të brendshëm;
- Lehtëson Regjistrimin e Popullsisë;
- Mundëson zoonimin e QKMF/QMF/AMF;
- Mundëson përdorimin e adresave zyrtare nga tatimit në prone;
- Mundëson zoonimin e institucioneve shkollore publike të nivelit të ulët;
- Mundëson përdorimin e adresës zyrtare dhe unike në të gjitha faturat e shërbimeve publike (KEDS, Ujësjiellës, shërbimeve të pastrimit etj.);
- Mundëson gjetjen e lokacionet më të shpejt nga Policia;
- Mundëson gjetjen e lokacionit për emergjencë nga AME;
- Lehtëson navigimin në teren
- Mundëson shpërndarjen më të lehtë dhe më të shpejtë të dërgesave nga Posta;

Statistikat të deklarimit dhe regjistrimit të adresave zyrtare deri me datën 31.12.2025

Deklarimi i adresës zyrtare			
Komuna	Nr. eKosova	Nr. Aris	Totali
PRISHTINË	74061	13885	87946
PRIZREN	33109	32522	65631
FERIZAJ	18416	16945	35361
GJAKOVË	9645	18247	27892
FUSHË KOSOVË	15221	9634	24855
PEJË	13141	11264	24405
GJILAN	14910	5436	20346
MITROVICË	11822	7807	19629
VUSHTRRI	10701	8231	18932
SUHAREKË	6812	9326	16138
DRAGASH	5342	7438	12780
PODUJEVË	10464	1708	12172
RAHOVEC	6648	5133	11781
GRAÇANICË	5562	6181	11743
GLLOGOC	9246	2173	11419
DEÇAN	3509	7120	10629
LIPJAN	8007	2277	10284
ISTOG	4366	5545	9911
VITI	5478	3734	9212
MALISHEVË	6869	1869	8738
SKËNDERAJ	5853	1287	7140
KLINË	4485	1720	6205
OBILIQ	4362	1530	5892
SHTIME	3808	2028	5836
KAÇANIK	3833	1584	5417
KAMENICË	2993	2276	5269
SHTËRPCE	776	3362	4138
PARTESHË	193	2948	3141
RANILLUG	156	2003	2159
HANI I ELEZIT	710	1059	1769
KLLOKOT	648	1040	1688
JUNIK	559	924	1483
MAMUSHË	608	858	1466
NOVOBËRDË	1239	4	1243
MITROVICË VERIORE	53	0	53
ZVEÇAN	10	0	10
TOTAL:	303615	199098	502713

Deklarimi i adresës zyrtare





60.40%
Nr. eKosova
303615

39.60%
Nr. Aris
199098

Regjistrimi i adresës zyrtare për anëtar të familjes			
Komuna	eKosova	ZGJC	Totali
PRIZREN	33896	80157	114053
PRISHTINË	80423	31003	111426
FERIZAJ	18658	42992	61650
GJAKOVË	10560	51078	61638
PEJË	14275	32402	46677
FUSHË KOSOVË	16013	21637	37650
SUHAREKË	7057	27864	34921
MITROVICË	12574	21160	33734
GJILAN	16030	12785	28815
VUSHTRRI	12066	15867	27933
DRAGASH	5274	22121	27395
DEÇAN	3705	21333	25038
RAHOVEC	7148	14889	22037
ISTOG	4654	14747	19401
VITI	5872	11540	17412
PODUJEVË	11582	5699	17281
GLLOGOC	10269	5461	15730
GRAÇANICË	4785	10725	15510
LIPJAN	8901	5913	14814
MALISHEVË	7194	5903	13097
SHTIME	4009	6057	10066
OBILIQ	4814	4654	9468
KAÇANIK	4240	4944	9184
SKENDERAJ	6669	2383	9052
KAMENICË	3384	5567	8951
SHTËRPECË	818	6944	7762
KLINË	4961	2597	7558
HANI I ELEZIT	715	3599	4314
PARTESH	30	4121	4151
RANILLUG	66	3925	3991
JUNIK	546	2862	3408
MAMUSHË	635	2537	3172
KLLOKOT	695	2325	3020
NOVOBËRDË	1166	3	1169
TOTAL:	323684	507794	831478

Regjistrimi i adresës zyrtare për anëtar të familjes



5.9. Kompletimi i adresave në Komunat Veriore (Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan) dhe Novobërdë

Emërtimi i rrugëve në komunat veriore konsiderohet arritje shumë e madhe dhe e rëndësishë së veçantë, pasi që me këtë konsiderohet si proces i kompletuar në tërë Kosovën. Emërtimi i tyre (mbi 1000 rrugë) është bërë në bashkëpunim me kryetarët, kryesuesit e kuvendeve komunale, komisionet për emërtim, ministritë dhe institucionet përkatëse, pas nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit në mes AKK-së dhe komunave veriore.


Fillimisht, zyrtarët e Njesisë së Adresave, në bashkëpunim me zyrtarët komunal për adresa, kanë bërë përcaktimin e formave të rrugëve (caktimi i fillimit, mbarimit dhe kodit) bazuar në ortofoto e fundit (2024) dhe përgatitur listat me kode të rrugëve për emërtim. Pas kësaj komunat kanë formuar Komisionet e Emërtimit, të cilat kanë emërtuar rreth 80-90% të rrugëve me emra të personaliteteve, toponimeve lokale dhe duke ruajtur parimin etnik dhe kulturor të vendit. Tashmë këta emra janë futur në Regjistrin Zyrtar të Adresave (ARIS) dhe në bazë të tyre do të bëhet edhe prodhimi e vendosja e tabelave të emrave në terren.

Numri i emrave të rrugëve, numrave të adresave dhe tabelave

Komuna	Numri i rrugëve	Numri i tabelave të emrave të rrugëve	Numri i numrave të adresave	Numri i shtyllave
Leposaviq	421	833	7603	583
Mitrovicë Veriore	89	215	1954	151
Novobërdë	250	520	4613	364
Zubin Potok	203	394	3937	276
Zveçan	142	331	3409	232
Total	1103	2293	21935	1605



Figura 1. Procesi i adresimit në Kosovë



Grafiku 1. Sinjalizimi i planifikuar sipas komunave në vitin 2026

5.10. Prodhimi dhe instalimi i tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave

Realizimi i Projektit për vendosjen e rreth 330,000 numrave të adresave në 21 komuna (Figura 2), si dhe rreth 1200 tabela të emrave të rrugëve në 3 komuna. Gjatë vitit të kaluar (2024) AKK ka filluar këtë projekt cili ka vazhduar dhe është përfunduar gjatë vitit 2025. Njësia e Adresave ka qenë e angazhuar në përgatitjen e materialeve e hartave për prodhim e vendosje, kontrollimin e kualitetit të punimeve në terren dhe mbikëqyrjen deri në përmbylljen e suksesshme të tij.




Figura 2. Vendosja e numrave të hyrjeve

Aktivitetet të tjera të Njesisë së Adresave

- Shqyrtimi teknik i vendimeve për emërtimin e rrugëve, (19 vendime)
- Përpilimi i specifikacioneve teknike për projektin e Zhvillimit të aplikacionit ARIS mobile;
- Kontrolli i kualitetit të dhënave të adresave dhe paraqitja e tyre në gjeoportal. Zyrtarët komunal vazhdimisht bëjnë përditësime të dhënave të adresave, digjitalizime të rrugë dhe hyrjeve të reja.
- Organizimi i takimeve, trajnimeve dhe ofrimi i përvijës profesionale për drejtorët e urbanizmit, zyrtarët komunal të adresave ose konsulentëve të angazhuar në Projektin e Ndërlidhjes kanë qenë të vazhdueshme në mënyrë që në ARIS të kemi të dhëna të standardizuara sipas metodologjisë, kualitative dhe në shërbim të qytetarëve.

Takime të ndryshme janë realizuar edhe me institucione të ndryshme qeveritare, agjenci ose institucione të ndryshme në mënyrë që të rritet bashkëpunimi dhe shfrytëzimi sa më i madh i të dhënave zyrtare të adresave.

Përgatitja e të dhënave të adresave sipas kërkesës së institucioneve dhe kompanive; Incizimi i videove promovuese për ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare:

<https://www.facebook.com/reel/1297170021976475>

<https://www.facebook.com/reel/588693320960122>

VIDEO 1



KLIKO BUTONIN PLAY

VIDEO 2



KLIKO BUTONIN PLAY

Mbështetje profesionale, teknike dhe administrative. Njësia e Adresave vazhdimisht është e angazhuar në punë administrative, në përgatitjen e raporteve, hartave, statistikave, dhënien e rekomandimeve, mbikëqyrjen e punës dhe përfshirjen në aktivitete të ndryshme për Adresa ose projektet tjera në AKK.

5.11. Skanimi dhe Indeksimi i Dokumenteve Arkivore Kadastrale

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti ka qenë skanimi dhe indeksimi i dokumenteve të arkivuara kadastrale dhe integrimi i tyre në Sistemin e Skanimit masiv në SIKTK. Skanimi i dokumenteve arkivore dhe një formë e ngjashme e realizimit të tij ka ndodhur edhe më herët në faza të ndryshme në vite të ndryshme ku janë përfshirë të gjitha ZKK-të, mirëpo me projektin e këtij viti synohet që të përmbyllet i gjithë procesi i dixhitalizimit të dokumenteve kadastrale arkivore.

Qëllimi i projektit është të lehtësojë punën e Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK) dhe AKK-së për rritjen e cilësisë së të dhënave dhe ofrimin e qasjes më të shpejtë dhe më të saktë në të dhëna për pronarë të caktuar, duke përsheptuar procesin, duke kursyer kohë dhe efikasitet në gjetjen e historikut të rasteve në arkivin digjital të komunës përkatëse. Ky projekt do të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e punës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Pronarët ose aplikantët për shërbimet kadastrale do të përfitojnë nga saktësia më e madhe e informacionit të ofruar nga ZKK-ja si dhe marrja e të dhënave në një kohë shumë të shpejtë. Projekti do të rrisë gjithashtu sigurinë e ruajtjes së dokumenteve arkivore të dixhitalizuara (të skanuara me cilësi të lartë dhe të indeksuar në mënyrë që të gjenden lehtësisht në sistem me emrin dhe ID të pronarëve)

Përfitimet pas realizimit të projektit përfshijnë:

- Lehtësim në procesin e punës së përditshme të zyrtarëve të ZKK-ve dhe AKK-së; me qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në dokumentet e arkivuara;
- Rritja e sigurisë dhe cilësisë së të dhënave kadastrale;
- Rritja e transparencës duke mundësuar qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në dokumentacionin e arkivuar.

Projekti është zhvilluar në 5 ZKK (Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Mitrovicë e Veriut dhe Istog) si dhe dokumentet arkivore kadastrale në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës dhe AKK-në.

Për implementim të këtij projekti kontrata është nënshkruar me 13 dhjetor 2024 ka përfunduar në 30 tetor 2025.

Edhe projekti Skanimi i Dokumenteve të Arkivuara Kadastrale është pjesë e Projektit të Bankës Botërore (BB) për të mbështetur Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) për të forcuar infrastrukturën kombëtare të të dhënave në fushën e informacionit kadastral – Projekti për Kadastrën e Paluajtshmërive të Kosovës dhe Infrastrukturën Gjeohapësinore (REGIP).

Komuna	Numri fletëve të skanuara
Gjilan	220,674
Podujeve	216,277
Istog	103,715
Prishtinë	469,381
Mitrovica Veriore	21,928
Kuvendi i Republikës së Kosovës	61,412
AKK	626,482
Gjithësejt	1,719,869

5.12. Renovimi i Hapësirave të Zyrës Kadastrale Komunale Mitrovica e Veriut

Në kuadër të Projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), huamarrje nga Banka Botërore, konkretisht Komponentit B për Modernizimin e Kadastrit, është paraparë, ndër të tjera, edhe përkrahja për renovimin e hapësirave të Zyrave Kadastrale në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij aktiviteti është renovimi i hapësirave të Zyrës Kadastrale Komunale me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, përmes aplikimit të një organizimi të ri funksional me zyrë pritëse/operuese dhe procedura të standardizuara, duke siguruar që transaksionet të realizohen në mënyrë më sistematike, efikase dhe transparente.

Për këtë qëllim, Agjencia Kadastrale e Kosovës, më 15 korrik 2025, ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Komunën e Mitrovicës së Veriut për bashkëfinancimin e projektit të renovimit të hapësirave të Zyrës Kadastrale Komunale në këtë Komunë. Kontrata për realizimin e këtij projekti është nënshkruar më 10 tetor 2025, ndërsa deri në fund të vitit 2025 janë përfunduar të gjitha punët renovuese ndërtimore, në përputhje të plotë me projekt-dizajnin arkitektonik të paraparë. Aktualisht ka mbetur vetëm pajisja e këtyre hapësirave me inventar dhe teknologji informative, e cila, sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit, do të financohet nga Komuna e Mitrovicës së Veriut gjatë muajve të parë të vitit 2026.



6

**ORGANIZIMI DHE PËRFAQËSIMI
NË KONFERENCA, PUNËTORI,
GRUPE PUNUESE DHE
VIZITA STUDIMORE**

6 ORGANIZIMI DHE PËRFAQËSIMI NË KONFERENCA, PUNËTORI, GRUPE PUNUESE DHE VIZITA STUDIMORE

6.1. Konferenca për lancimin e projektit për “Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale”

Për herë të parë në historinë e kadastrit Agjencia Kadastrale e Kosovës, këtë vit ka arritur që të digjitalizojë plotësisht çdo shërbim kadastral dhe çdo qytetar merr qasje të plotë, të shpejtë dhe të sigurt në të gjitha shërbimet kadastrale.

Pikërisht në këtë datë simbolike, një ditë që shënon krenarinë tonë kombëtare, njëherit AKK ka shënuar edhe krenarinë profesionale, pasi që ka arritur të vë në jetë synimin e kamotshëm, që është digjitalizimi i plotë i të gjitha shërbimeve kadastrale duke futur kështu vendin në një epokë të re të inovacionit, transparencës dhe modernizimit.

Ky transformim ka shënuar një standard të ri shtetëror në administrimin e tokës, sigurinë juridike të pronës dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Digjitalizimi i shërbimeve kadastrale nuk është thjesht një kalim i dokumenteve në platforma online, por njëherit hapje e një epoke të re të inovacionit për zhvillimin ekonomik, transparencën, efikasitetin dhe fuqizimin e qytetarëve. Kjo arritje madhore është rezultat i angazhimit institucional dhe profesional, si dhe mbështetjes së vazhdueshme të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, apriori Agjencia Kadastrale e Kosovës falënderon të gjithë akterët, si dhe partnerët për kontributin dhe besimin në këtë proces transformues.

Me rastin e fillimit të përdorimit të këtyre shërbimeve AKK organizoi Konferencë për lancim me pjesëmarrës Ministrin e MMPHI-së z. Hysen Durmishi, përfaqësues nga Oda e Noterëve, Përmbauesve, Ndërmjetësuesve, Drejtorë e zyrtarë të ZKK-se, Gjeodetë të licencuar, profesionistë e pjesëmarrës tjerë nga fusha me interes të përbashkët, e përfitues direkt e indirekt të digjitalizimit.

Në një fjalë rasti Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Hysen Durmishi përgëzoi AKK-në për punën e jashtëzakonshme dhe njëherit theksoi që me këtë hap përmbyllet digjitalizimi i të gjitha shërbimeve dhe është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore.

Edhe Drejtori i AKK-së z. Avni Ahmeti theksoi rëndësinë e digjitalizimit dhe arritjen historike që AKK-ja ka shënuar këtë vit, por edhe synimin për vazhdimin e përkushtimit dhe se Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk ndalet këtu.

Mes tjerash tha: Vizioni ynë është të ndërtojmë një sistem kadastral plotësisht të integruar, të automatizuar dhe të orientuar drejt inovacionit.

Do të vazhdojmë të investojmë në: teknologji të reja, ngritjen e kapaciteteve profesionale, përmirësimin e vazhdueshëm të platformave dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale duke përfshirë edhe vertikalizimin e kadastrit.

Një falënderim i veçantë pati edhe për ish-Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, për vizionin dhe mbështetjen e palëkundur të tij në çdo objektiv e çdo fazë të transformimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Puna e tij e palodhshme dhe mbështetja e tij flasin edhe sot, duke lënë gjurmë në arritjet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Njëashtu falënderojmë Ministrin aktual nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Hysen Durmishi.

Edhe pjesëmarrësit e tjerë vlerësuan lart punën e AKK-së këtë vit sepse me digjitalizimin e shërbimeve shkurtohet koha e shërbimit, rritet transparenca, garantohet siguri e të dhënave, eliminohet burokracia dhe krijohet një sistem i besueshëm, efikas dhe modern.





6.2. Konferenca për fillimin e projektit “Rindërtimi i Kadastrit në 115 ZK”

Me datë 11 prill 2025 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka organizuar Konferencë për informimin e publikut për fillimin e Projektit “Rindërtimi i kadastrit në 115 ZK”. Pjesë e kësaj konference ishte Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z.Liburn Aliu.

Në këtë Konferencë u shpalosën detaje nga plani dinamik i realizimit të projektit, u dha informata për datat e fillimit të secilës fazë të projektit duke filluar nga Informimi publik, mandej hapja e zyrave të Operatorit Ekonomik, fillimi i fushatës së matjeve dhe në fund përpunimi i të dhënave dhe futja e tyre në sistem.

Të pranishmit u informuan edhe se cilat zona kadastrale janë të përfshira në projekt.





6.3. Konferenca për media rreth projektit “Ndërlidhja e Qytetarit me Adresë Zyrtare”

Agjencia Kadastrale si bartëse e projektit “Ndërlidhja e Qytetarit me Adresë Zyrtare”, në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil, thirrën konferencë për media, në të cilën drejtorët ekzekutiv bënë thirrje qytetarëve për regjistrim të obligueshëm të Adresave nga Gushti i vitit 2025, ai mund të bëhet pranë zyrave të Gjendjes Civile, në të kundërtën qytetarët që nuk e bëjnë këtë regjistrim nuk mund të pajisen me dokumente personale dhe të pronësisë.

Regjistrimit i adresave të qytetarëve paraqet një ndër projektet më madhore pas Regjistrimit të Popullsisë që prek çdo qytetar dhe vazhdon të realizohet me interesim të madh nga ta.



6.4. Shënimi i Ditës Botërore të Gjeodetit

Agjencia Kadastrale e Kosovës këtë vit shënoi Ditën Botërore të Gjeodetit, ku në një ceremoni të veçantë u mbledhën të gjithë gjeodetët, për të nderuar bashkarisht punën dhe përkushtimin e të gjithë atyre të cilët kanë kontribuar me shumë zell e përkushtim në zhvillimin e vendit për gjithë këto vite. Shënimi i kësaj ngjarje shërbeu si një mundësi për të reflektuar mbi rrugëtimin e këtij profesioni fisnik, duke vlerësuar rolin e tij në ndërtimin e një sistemi modern dhe të avancuar kadastral në shërbim të zhvillimit të vendit.

Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, mbajti një fjalë rasti, ku theksoi përparimin e vazhdueshëm të profesionit të gjeodetit, si dhe modernizimin e investimin e vazhdueshëm nga Agjencia Kadastrale e Kosovës ndër vite, për të ngritur sa më lart në shoqëri rolin e gjeodetëve, njëherit duke nënvizuar rolin kyç të vet gjeodetëve në zhvillimin e kadastrit në përgjithësi.

Mes tjerash, ai nënvizoi rëndësinë e gjeodezisë si themel për ndërtimin e një sistemi të saktë dhe të qëndrueshëm kadastral, i cili kontribuon në sigurinë pronësore, planifikimin urban dhe zhvillimin ekonomik. Njëashtu, shprehu mirënjohjen për të gjithë profesionistët që kanë dhënë kontributin e tyre ndër vite, duke e çuar këtë fushë përpara dhe duke ndërtuar një trashëgimi të çmuar për brezat e ardhshëm.

Në këtë mbrëmje festive, gjithashtu, dy prej Gjeodetëve më të vjetër Abdurrahman Kuleta dhe Selim Cacaj, mbajtën disa fjalë përshëndetëse, duke ndarë kujtime dhe reflektime të shkurtra mbi rrugëtimin e gjatë të tyre profesional. Kjo ngjarje shërbeu si një dëshmi e përkushtimit dhe arritjeve të kësaj fushe të inxhinierisë, duke reflektuar mbi të kaluarën dhe duke hedhur vështrimin drejt një të ardhmeje edhe më të ndritur për kadastrin e gjeodezinë në Republikën e Kosovës.



6.5. Pjesëmarrja në Takimin Teknik të Prodhuesve së të Dhënave të EuroGeographics, në Bruksel

Një delegacion nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka marrë pjesë në Takimin Teknik të Prodhuesve së të Dhënave të EuroGeographics, i cili është mbajtur në Bruksel, Belgjikë, organizuar nga Instituti Kombëtar Gjeografik i Belgjikës.

Ky takim, i njohur si Takimi për Hartën Euro Regjionale (EuroRegionalMap), ka qenë i dedikuar për prodhuesit e të dhënave të bashkësive pan-evropiane: EuroBoundaryMap (EBM), EuroRegionalMap (ERM) dhe EuroGlobalMap (EGM).

Qëllimi i këtij takimi ka qenë të informojë pjesëmarrësit mbi procesin e prodhimit për vitin 2026 për EBM, ERM dhe EGM, duke theksuar rëndësinë e harmonizimit dhe përmirësimit së të dhënave gjeohapësinore në nivel evropian.



6.6. Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar dhe Konferencën INTERGEO 2025

Edhe këtë vit Agjencia Kadastrale e Kosovës ishte pjesë e konferencës prestigjioze të organizuar nga INTERGEO, njëherit panairin kryesor në fushën e gjeodezisë, gjeoinformacionit dhe menaxhimit tokësor, që këtë vit u mbajt në Frankfurt, Gjermani. INTERGEO përmbledh sektorët kryesorë të industrisë gjeohapësinore: gjeoinformacionin, matjet gjeodezike, sistemet GIS, sensorët satelitorë, teknologjitë e dronëve, smart city, mbrojtjen klimatike dhe zhvillimin urban të qëndrueshëm. Kjo platformë themelore shërben si arenë ndërkombëtare për dialog dhe promovim të zgjidhjeve ndaj sfidave globale si ndryshimet klimatike dhe urbanizimin e shpejtë.

Pjesëmarrja në INTERGEO përbën një kontribut të rëndësishëm në avancimin e vizionit të AKK-së për një Kosovë gjithnjë e më të zhvilluar, një vendbanim të përmirësuar për brezat aktuale dhe ato që do vijnë. Rrjedhimisht, ky angazhim nënvizon përkushtimin e AKK-së ndaj inovacionit, transparencës dhe integritetit në menaxhimin kadastral, duke u bërë pjesë e proceseve globale që transformojnë mënyrën se si kuptojmë dhe ndërveprojmë me hapësirën tonë jetësore.



6.7. Vizita studimore në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive në Maqedoninë e Veriut

Një delegacion nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), zhvilloi një takim pune në ambientet e Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive (AREC) në Shkup, ku u mirëprit nga stafi profesionist i kësaj agjencie.

Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave ndërinstitucionale në fushën e kadastrit, me fokus të veçantë në avancimin e shërbimeve kadastrale, veçanërisht për kadastrin e përçojave. Gjatë diskutimeve, u trajtuan aspekte të ndryshme si: korniza ligjore dhe rregulloret që duhet të përpilohen për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave të përçojave; metodat teknike për përpunimin dhe administrimin e këtyre të dhënave; si dhe praktikatat më të mira që mund të aplikohen.

Duke qenë se AKK është në fazën e zhvillimit të modulit të ri për kadastrin e përçojave, ky takim shërbeu si një mundësi e vlefshme për të përfituar nga përvojat e institucioneve homologe, me qëllim që të adaptohet qasja më efikase dhe funksionale.

AKK mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një sistem modern dhe transparent, që garanton qasje të lehtë dhe të besueshme në të dhëna për të gjithë qytetarët, institucionet dhe sektorin privat.



6.8. Pjesëmarrja në Asamblesë e Përgjithshme të EuroGeographics në Riga, Latvi

Agjencia Kadastrale e Kosovës këtë vit ishte pjesë e Asamblesë së Përgjithshme të Eurogeographics 2025.

Asambleja e përgjithshme e Eurogeographics për këtë vit mbledhi ekspertët e 46 vendeve të Evropës nga 60 organizata, në Riga të Latvisë. Në 25 vjetorin e themelimit të EuroGeographics tema këtë radhë kishte në fokus “Tejkalimin e sfidave për një të ardhme më të sigurt”.

Mes tjerash në sesionet e Asamblesë u diskutuan edhe tema specifike si: Transformimi digjital, Ndryshimet e nevojshme për GNSS, Teknologjia duke punuar me ne apo kundër nesh – AI dhe trendet e së ardhmes, Përgjigjja e organizatave kombëtare ndaj ndryshimeve globale, etj.

U diskutua edhe për politikatat dhe të ardhmen e organizatës ku pjesë e organizimit ishte edhe votimi për Presidentin e ri të EuroGeographics që rezultojë të jetë i gjertanishmi Tomaz Petek nga Sllovenia.



6.9. Pjesëmarrja në trajnim profesional në Cyrih, Zvicër

Përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), zhvilluan me sukses këtë vit një trajnim profesional të specializuar në Cyrih, Zvicër. Ky trajnim, i organizuar nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës, kishte për qëllim avancimin e njohurive dhe aftësive të stafit të AKK-së, në teknologjitë më të fundit të fotografimit ajror

Përmbajtja e trajnimit përfshinte:

- Planifikimin dhe matjen e pikave kontrolluese në terren (GCP);
- Orientimin, përpunimin dhe korrigjimin e imazheve ajrore;
- Prodhimin, përpunimin dhe kontrollin e cilësisë së ortoimazheve, si dhe krijimin e mozaikut përfundimtar;
- Gjenerimin e Modelit Digjital të Sipërfaqes (DSM) dhe krijimin e Modelit Digjital të Terrenit (DTM);
- Modelet tredimensionale (3D) të qyteteve – me fokus në aspektet teorike dhe praktike.

Ky trajnim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të kapaciteteve profesionale të AKK-së. Njohuritë dhe aftësitë e fituara do të kontribuojnë, njëherit forcojnë më tej rolin e AKK-së si institucion lider në fushën e kadastrit.

Iniciativat e tilla dëshmojnë përkushtimin e AKK-së për inovacion dhe profesionalizëm në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit të Republikës së Kosovës.



7

KOORDINIMI
I PROJEKTEVE

7 KOORDINIMI I PROJEKTEVE

7.1. Projekti për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturë Gjeo-Hapësinore (REGIP)

Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave me datë 15 nëntor 2018, ka negociuar marrëveshjen Financiare me Bankën Botërore për projektin e Regjistrimit të Pronës dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore (REGIP), ID P164555 në shumën prej 14.6 milion Euro. Projekti është bërë efektiv me datë 02 shtator 2020 dhe përfundon me 30 nëntor 2026.

Ky projekt zbatohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat Komunale Kadastrale (ZKK). Palët e tjera të interesit janë Ministria e Financave (MF), dhe institucionet tjera që janë pjesë e Komitetit ndërmënyor për administrimin e tokave dhe infrastrukturës kombëtare për informacion hapësinor (IKIH). Institucionet e tjera publike dhe private që prodhojnë dhe menaxhojnë të dhëna gjeohapësinore, përfshihen sipas nevojës.

Implementimi i projektit REGIP do të vazhdojë të ndihmojë Republikën e Kosovës në zhvillimin e mëtutjeshëm të tregut të tokës, i cili kryesisht do të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Gjithashtu do të kontribuojë në përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve kadastrale dhe përmirësimin e legjislacionit, duke lehtësuar mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave pronësore dhe krijimin e një mekanizmi të lehtë, dhe të sigurt për transaksionet e pronës së paluajtshme në vend. Objektivi zhvillimor i projektit është të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe cilësisë të administrimit të tokës, të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Qëllimi i projektit është të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, vazhdimi i punëve të rindërtimit të informacioneve kadastrale, krijimin e kadastrit të përçojave, zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit të ndërtesave, shërbimet për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë – SIKTK, Kompletimin e Sistemit të Adresave dhe renovimin e zyrave kadastrale në Komunitet e mbetura.

Gjithashtu qëllimi i mëtutjeshëm i projektit është të zbatohet strategjinë për Teknologjinë Informative të AKK-së dhe atë të Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) në Kosovë.

AKK gjatë vitit 2025 ka pritur dy herë delegacionin nga ekipi i Bankës Botërore, të cilët kanë qëndruar në vizitë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) në periudhën 16 – 20 qershor 2025, dhe në periudhën 17 – 21 nëntor 2025.

Përveç diskutimeve nga afër për progresin e aktiviteteve të projektit REGIP, delegacioni ka marrë pjesë edhe në takimet e koordinimit të donatorëve dhe komitetit ndërmënyor për Administrim të Tokës dhe Infrastrukturë Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) të organizuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë këtyre vizitave.

Progresi i aktiviteteve sipas komponentëve është siç vijon:

Komponenti B. Modernizimi i Kadastrit: Objektivi i këtij komponenti është vazhdimi i modernizimit të kadastrit në Kosovë, e cila filloi në kuadër të projektit paraprak për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (RECAP). Ky komponent do të financojë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) rindërtimin e informacioneve kadastrale deri në 115 Zona Kadastrale; (b) përmirësimin e cilësisë së të dhënave kadastrale; (c) zhvillimin e kadastrit të përçojave; (d) zhvillimin e regjistrimit të ndërtesave në Komunitet e mbetura; dhe (e) renovimin dhe ri-inzhinjerimin e Zyrave Kadastrale Komunale në Komunitet Veriore

Implementimi i Planit të Veprimit për Informim publik

Qëllimi i projektit është të implementohet plani i veprimit të ndërgjegjësimit dhe komunikimit, për të rritur kapacitetin e AKK-së dhe ZKK-ve për të komunikuar me publikun, klientët e tyre dhe me palët e tjera të interesuara. Për të koordinuar aktivitetet e informimit publik është nënshkruar Memorandum i Bashkëpunimit me ATRC-në në kuadër të projektit PIAKOS. Përmes këtij bashkëpunimi, ATRC do të mbështesë AKK-në me informim publik për shumicën e projekteve. Kjo mbështetje do të jetë me prodhimin dhe shpërndarjen e videove të ndryshme që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve që do të realizohen nga AKK-ja.

Për implementim të planit të veprimit të ndërgjegjësimit dhe komunikimit është kontraktuar një Kompani profesionale dhe kontrata do të përfundojë në nëntor 2026.

Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 115 Zona kadastrale

Ky është projekti kryesor kapital në kuadër të REGIP, dhe për të pasur benefite maksimale për qytetarët në Zonat Kadastrale të parapara në këtë projekt, si dhe për të pasur gjithë përfshirje të akterëve të involvuar në fushën e kadastrit dhe administrimit të tokës në Republikën e Kosovës. Me aprovimin e Ligjit të ri për Kadastër të pronës së paluajtshme Nr.08 L-237, në pjesën e parë të vitit 2024 janë hartuar dhe miratuar 11 Udhëzime Administrative për implementim të këtij ligji, si dhe më pas janë hartuar edhe udhëzuesit teknik të punës për matjet, krijimin, ndryshimet dhe regjistrimin e njësive kadastrale – parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave, si dhe Udhëzuesi për Rindërtimin e Kadastrit. Kompletimi i kësaj kornize ligjore ka hapur rrugën për të filluar me implementimin e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale në 115 Zona Kadastrale.

Për të mbështetur këtë proces, janë punësuar pesë (5) staf profesional vendor (juristë dhe gjeodetë), si dhe janë përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme për të mbështetur implementimin e këtij projekti.

Nënshkrimi i kontratave për implementim të këtij projekti së bashku me kontrollin e kualitetit është bërë në mars 2025 për 91 Zona Kadastrale të shpërndara në katër LOT-e, dhe është duke u zhvilluar procedura e prokurimit për 24 Zona Kadastrale në LOT-in pesë.

Korrektimi i të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë – SIKTK;

Qëllimi i projektit është të arrihet kualitet më i lartë i të dhënave kadastrale si dhe rritje e besueshmërisë në të dhëna. Kjo do të krijojë mundësi shumë më të mëdha për hapjen e të dhënave për palë të ndryshme të interesit edhe jashtë institucioneve të kadastrit, gjeodezisë dhe hartografisë, etj.

Projekti është në fazën finale të prokurimit. Nënshkrimi i kontratës për implementim të këtij projekti pritet të bëhet në fillim të vitit 2026.

Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave grafike në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave

Ky projekt ka për qëllim azhurnimin e të dhënave grafike për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave të cilat kanë qenë të krijuara në formate dhe standarde teknike të cilat nuk janë në përputhshmëri të plotë me avancimet e teknologjisë së SIKTK-HK. Gjithashtu të dhënat për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave do të konvertohen në përputhshmëri të plotë me udhëzimet si dhe kornizat e punës aktuale për regjistrim dhe mirëmbajtje të dhënave grafike për njësi kadastrale.

Kontrata për implementim të këtij projekti është nënshkruar me 19 shtator 2024 dhe projekti ka përfunduar me 15 dhjetor 2025.

Renovimi i zyrës kadastrale komunale në Komunën e Mitrovicës së Veriut

Qëllimi i projektit është mbështetja e ZKK-së në Komunën e Mitrovicës së Veriut me renovimin e Zyrës Kadastrale Komunale (ZKK) dhe pajisjen e tyre me inventar dhe teknologji të informacionit për nevojat e stafit të ZKK-ve.

Ri-inzhinjerimi në përgjithësi do të thotë krijimi i një dizajni të ri të zyrave pritëse / pasme dhe procedurave të standardizuara, gjë që i bën transaksionet më efikase dhe transparente. Klientët paraqesin dokumentacionin e tyre në zyrën pritëse, dokumentet skanohen për të parandaluar humbjen e tyre, dhe shërbimet përpunohen në zyrën e pasme pa kontakt me klientin. Kjo qasje ka përmirësuar rrjedhën e punës të shërbimeve ndaj klientit, kushtet e punës dhe ruajtjen e regjistrave.

Kontrata për implementimin e këtij projekti në bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës së Veriut është nënshkruar me 10 tetor 2025 dhe pjesa e punimeve të cilat financohen nga projekti REGIP janë finalizuar me 20 dhjetor 2025. Projekti pritet të përfundojë në janar 2026.

Komponenti C. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore:

Objektivi i këtij komponenti është të bëjë investime në sistemet e IT-së dhe investime për të dhënat gjeohapësinore për tregun e tokës dhe pronës në Republikën e Kosovës dhe do të mbështesë zbatimin e strategjive të AKK- së për IT dhe Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) përmirësimin e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë në drejtim të Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SIKTK-AOSH); (b) Arkivin digjital të AKK-së; (c) investimet në IKIH (ang. NSDI); dhe (d) Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjetit shtetëror gjeodezik të GPS-it, KOPOS.

Avancimi i Sistemeve Kadastrale

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar një sistem të avancuar për regjistrimin e pronës së paluajtshme në vend “Sistemi Informativ Kadastral i Tokës së Kosovës” (SIKTK). Ky sistem është avancuar me module të reja për shërbime sa më cilësore, të sakta, transparente dhe të shpejta për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sistemi është krijuar për të ndërvepruar me sistemet e institucioneve dhe grupeve të tjera të interesit për çasje në të dhënat kadastrale.

Ky projekt ka filluar të implementohet me 21 maj 2024 dhe ka përfunduar me 25 nëntor 2025.

Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH)

Qëllimi i këtij aktiviteti është përmirësimi ose zhvillimi i një Gjeoportali të ri të IKIH-së për Kosovën si dhe avancimi i gjeoportalit ekzistues shtetëror. AKK do të menaxhon këtë Gjeoportal, i cili është web portal që funksionon si një adresë e qasjes në informacione gjeografike në internet. Gjeoportali i IKIH-së do t'i ofrojë AKK-së një mënyrë për të ofruar një pamje konsistente me kontrollin e qasjes dhe procedurat për aplikacione dhe baza të të dhënave të shumta. Përmes Gjeoportalit do të shpërndahen të gjitha informacionet gjeohapësinore të IKIH-së të institucioneve përgjegjëse në Kosovë sipas dispozitave të Projektligjit për IKIH-në në përputhje me Direktivën INSPIRE.

Për implementim të këtij projekti kontrata është nënshkruar më 18 dhjetor 2024 dhe ka përfunduar me 31 tetor 2025.

Prodhimi dhe instalimi i tabelave me emra të adresave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve të objekteve

Projekti i Sistemit të Adresave ka filluar në vitin 2010. Fillimisht i mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe më vonë nga Autoriteti Norvegjez për Hartografi (Statens Kartverk) pritet të kompletohet me mbështetje të projektit REGIP.

Me përfundimin e Sistemit të Adresave, do të përmbushet një nga standardet Evropiane për integrimin në BE, i cili është transpozimi i direktivës INSPIRE 2007/2 e cila parashikon sigurimin / publikimin e të dhënave gjeo-hapësinore, sigurimin e shërbimeve më të shpejta dhe funksionale për qytetarë në shumë zona; mundëson lidhjen e bazës së të dhënave me adresat ndërmjet institucioneve të ndryshme përfituese, etj.

Projekti është ndarë në dy lote, respektivisht prodhimin dhe instalimin e 1,530 tabelave me adresa të rrugëve në Komunitet e mbetura Junik, Shtërpçë, Ranillug dhe Novobërdë, si dhe prodhimin dhe instalimin e 336,000 numrave të hyrjeve të objekteve në 22 Komuna të mbetura.

Kontrata ka filluar me implementim me 08 mars 2024 dhe ka përfunduar me 30 prill 2025.

Lidhja e sistemit të adresave me regjistrin civil

Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë AKK-në në plotësimin, azhurnimin e të dhënave në regjistrin kadastral dhe mbështetjen e komunave përmes ndërlidhjes ndërmjet Sistemit të Informacionit të Regjistrimit të Adresave (ARIS), Sistemit të Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe Informacionit të Kadastrit të Tokës në Kosovë (SIKTK).

Ky projekt është duke implementuar në bashkëpunim midis AKK-së, ARC-së dhe ASHI-së. Duke filluar nga 01.10.2024, janë kontraktuar 55 punonjës për mbështetjen e zyrave komunale të gjendjes civile. Projekti pritet të përfundoj me 28 shkurt 2026.

Skanimi i dokumenteve arkivore kadastrale

Objektivi i përgjithshëm i projektit është skanimi dhe indeksimi i dokumenteve të arkivuara kadastrale dhe integrimi i këtyre dokumenteve në SIKTK. Rezultati i projektit është digjitalizimi i përgjithshëm i dokumenteve arkivore kadastrale.

Projekti është zhvilluar në 5 ZKK (Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Mitrovicë e Veriut dhe Istog) si dhe dokumentet arkivore kadastrale në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës dhe AKK-në.

Për implementim të këtij projekti kontrata është nënshkruar me 13 dhjetor 2024 ka përfunduar në 30 tetor 2025.

Zhvillimi i aplikacionit për adresa/navigim për mobil (ARIS mobil)

Ky aplikacion për adresa/navigim do të përdoret si navigacion për të gjithë përdoruesit por edhe si lehtësi për mbledhjen e të dhënave të adresave në formë digjitale nga ana e Komunave.

Kontrata për këtë aktivitet është nënshkruar me 28 tetor 2025 dhe pritet të përfundoj në prill 2026.

7.2. Bashkëpunimi me OSBE-në

AKK gjatë vitit 2025, nga OSBE është mbështetur me 4 praktikant të cilët për veç përfitimit të përvojës praktike nga fusha e kadastrit, ata kanë ndihmuar AKK-në edhe në çështje tjera. Kontributi i tyre ndërlidhet edhe me Projektin e Rindertimit të Kadastrit në analizimin e lëndëve, në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar, etj.



8

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

8

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Administrimi Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit (TI)

8.1. Aktivitete rreth sigurisë

Gjatë vitit raportues, në kuadër të forcimit të sigurisë së teknologjisë së informacionit dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve kritike të AKK-së, janë realizuar aktivitete të gjera që përfshijnë përditësimin dhe standardizimin e sistemeve operative të serverëve (kalim në Windows Server 2022), aplikimin e rregullt të patch-eve të sigurisë përmes ËSUS-it, si dhe përmirësimin e politikave të sigurisë në Active Directory (fjalëkalime, GPO, gMSA, auditim dhe hardening).

Është avancuar ndjeshëm siguria e rrjetit përmes segmentimit (VLAN, ACL, DMZ), konfigurimit të routing-ut dhe bashkëpunimit me ASHI, si dhe përditësimin të vazhdueshëm të infrastrukturës së Cisco Firewall (FMC/FTD), VPN-së dhe licencimit përkatës. Janë zbatuar masa të forta për mbrojtjen e komunikimeve përmes certifikatave SSL, eliminimit të protokolleve të vjetruara (TLS 1.0/1.1), si dhe hardening të serverëve të ekspozuar në internet. Në aspektin e mbrojtjes së të dhënave dhe vazhdimësisë së shërbimeve, janë përmirësuar dhe zgjeruar politikat e backup-it, replikimit dhe rikuperimit (Veeam, vSphere Replication, SRM), duke përfshirë edhe testime reale të rikthimit të dhënave.

Paralelisht, është forcuar monitorimi dhe auditimi përmes platformave profesionale (OpManager, ADAudit, Event Log Analyzer, Sophos), ndërsa janë kryer skanime të avancuara të sigurisë në Active Directory, infrastrukturë dhe aplikacione. Në kuadër të sigurisë së aplikacioneve, janë instaluar dhe përdorur vegla profesionale për analizë statike dhe dinamike të kodit (SonarQube, OWASP ZAP, Nessus, Semgrep), janë trajtuar të gjitha gjeturat dhe janë siguruar që sistemet si ARIS, Geoportal, Gjeodetët, Përçoja, Harta Kadastrale dhe eKadastrri të publikohen vetëm pas përputhjes së plotë me standardet e sigurisë. Gjithashtu, është menaxhuar në mënyrë të kontrolluar qasja e përdoruesve, OE-ve dhe institucioneve të jashtme përmes VPN-së, grupeve të AD-së dhe politikave të firewall-it, duke garantuar akses të sigurt, të gjurmueshëm dhe të kufizuar vetëm në resurset e nevojshme.

8.2. Mirëmbajtja e dhomës së serverëve

Mirëmbajtja e dhomës së serverëve ka vazhduar edhe në vitin 2025. Kontrata e fundit dy vjeçare e emërtuar “Mirëmbajtje e sistemit TI (Klimë dhe UPS, në dhomën e serverëve) të AKK-së” është duke vazhduar nga Gushti i vitit 2024. Servisimet e rregullta periodike (çdo 3 muaj) janë duke vazhduar deri në fund të kontratës në Korrik të vitit 2026.

8.3. Monitorimi i infrastrukturës TI


Gjatë vitit 2025, Stafi i TI-së ka realizuar një monitorim të vazhdueshëm dhe të strukturuar të infrastrukturës së Teknologjisë Informative, me fokus në garantimin e funksionimit të pandërprerë, stabilitetit operacional dhe sigurisë së sistemeve dhe shërbimeve kritike. Ky monitorim ka përfshirë të gjitha komponentët kryesorë të infrastrukturës TI, duke përfshirë serverët, shërbimet, kapacitetet e ruajtjes së të dhënave, rrjetin dhe mekanizmat e mbrojtjes, si në qendrën primare të të dhënave ashtu edhe në qendrën sekondare (DRC). Qëllimi ka qenë siguria dhe vazhdimësia e shërbimeve, edhe në situata të ngarkesave të larta ose raste të papritura.

Stafi i Teknologjisë së Informacionit ka përdorur platforma të avancuara monitorimi si Aria Operations, ADAudit Plus, UptimeRobot dhe OpManager Plus, si dhe sisteme të integruara të monitorimit për pajisjet fizike dhe virtuale. Këto platforma funksionojnë në regjim 24/7 dhe njoftojnë automatikisht stafin për çdo problem të mundshëm, ndryshim në shfrytëzimin e resurseve, tentime të dyshuara për cenim të sigurisë së të dhënave, ose defekte të pajisjeve harduerike.

Në kuadër të monitorimit të përditshëm janë evidentuar në kohë çështje që lidhen me kapacitetet e ruajtjes, ngarkesën e sistemeve dhe funksionimin e shërbimeve, të cilat janë adresuar përmes masave parandaluese dhe korrigjuese. Këto masa kanë kontribuar në parandalimin e ndërprerjeve të punës, ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të sistemeve. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar menaxhimit të kopjeve rezervë dhe procedurave të rikuperimit të të dhënave, për të garantuar rikthimin e shpejtë në rast të humbjes ose fshirjeve aksidentale.

Në tabelë i gjeni të paraqitura ndryshimet në vlerat e shfrytëzuara, për periudhën 12 mujore të këtij viti, për resurset kompjuterike CPU, RAM dhe Storage në Qendrën e të dhënave të AKK-së:

Resursi kompjuterik	Janar	Dhjetor
CPU	210 Ghz	277 Ghz
RAM	1.88 TB	3.3 TB
Storage	133 TB	160 TB



Infrastruktura fizike e teknologjisë së informacionit dhe shërbimet digjitale që ofrohen nga AKK janë komplekse dhe në zgjerim të vazhdueshëm, çka e bën monitorimin e tyre të pamundur pa përdorimin e platformave të specializuara dhe të avancuara të monitorimit.

Bazuar në raportet e nxjerra nga këto sisteme, rezulton se gjatë vitit 2025 infrastruktura e TI-së ka pasur një nivel qasshmërie (uptime) prej 99.7%, ndërsa aplikacionet e AKK-së kanë qenë të qasshme 99.93% nga rrjeti i brendshëm dhe 99.8% nga rrjeti i jashtëm (interneti).

8.4. Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC

Për të garantuar disponueshmëri të vazhdueshme të shërbimeve dhe gatishmëri për rimëkëmbje pas fatkeqësive, gjatë vitit raportues është realizuar testimi i shërbimeve në Qendrën e Dytë të të Dhënave (DRC). Kjo qendër shfrytëzon platformën ekzistuese virtualizuese VMware vSphere, me menaxhim qendror përmes vCenter, e cila ofron një mjedis të centralizuar dhe të standardizuar për shërbimet virtuale.

Testimet në DRC janë kryer në baza të rregullta, çdo 6 muaj, duke përfshirë aktivizimin e makinave virtuale dhe verifikimin e funksionimit të tyre, kontrollin e replikimit të të dhënave dhe integritetin e sistemit. Pas çdo testi, shërbimet rikthehen në gjendjen e tyre normale “ready state”, duke siguruar që infrastruktura të jetë e gatshme për aktivizim të menjëhershëm në rast të një incidenti real.

Ky proces i rregullt i testimit siguron që kapacitetet e rimëkëmbjes janë të përcaktuara, proceset e backup-it dhe replikimit janë funksionale dhe çdo shqetësim teknik identifikohet dhe trajtohet paraprakisht. Në këtë mënyrë, DRC mbetet një mjet i besueshëm për rimëkëmbjen e shërbimeve kritike dhe ruajtjen e vazhdimësisë operacionale të sistemit.

Si përfundim, testimet periodike të DRC-së konfirmojnë se shërbimet virtuale janë të gatshme dhe infrastruktura funksionon sipas standardeve të pritshme, duke garantuar stabilitet dhe siguri të lartë për të gjitha sistemet kritike të organizatës.

8.5. Administrimi i Sistemeve të Informacionit, data bazave dhe qasjeve

Po vazhdon të jetë një prej objektivave të përvitshme dhe mjaft të rëndësishme të DTI-së edhe administrimi i Sistemeve të Informacioneve (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, KOPOS, Sistemi i faturimit, Gjeoportali etj.) në kuptimin e përgatitjeve të ambienteve për testime, trajnime dhe ambienteve reale, sipas kërkesave dhe nevojave.

Pjesë e rëndësishme e administrimit të SI është edhe administrimi i databazave, qasjeve, zhvillimi i skripteve TSQL për nxjerrjen e raporteve, statistikave për qëllime të hulumtimit ose të kontrollës së kualitetit të të dhënave kadastrale në nivel të databazave.

Për aspekte të zhvillimeve të reja dhe mirëmbajtjes së SI (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, SIKTK-Online, Gjeoportali), AKK ka angazhuar Operatorin ekonomik, me ekipin e së cilës DTI bashkëpunon në avancimet dhe zhvillimet e reja të Sistemeve të Informacionit.

8.5.1. SIKTK-SOA

Sistemi SIKTK-SOA është sistemi bazë për menaxhimin e të dhënave kadastrale.


Ai shërben për administrimin e të dhënave që lidhen me të drejtat pronësore, për funksionim sa më efikas, është i integruar me sistemet mbështetëse KCLIS-T, Case Management, Workflow dhe KCLIS-DM.

Gjatë vitit 2025, administrimi i sistemit kadastral SIKTK-SOA ka vazhduar në mënyrë të rregullt dhe të pandërprerë. Sistemi ka qenë i qasshëm dhe funksional në nivelin 99.99% të kohës gjatë gjithë vitit, duke garantuar stabilitet dhe besueshmëri të lartë. Në kuadër të administrimit teknik, është realizuar backup-i i rregullt i të dhënave në përputhje me strategjinë e përcaktuar nga DTI, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i performancës së serverëve.

Gjatë këtij viti janë krijuar 159 shfrytëzues të rinj në sistem.

Po ashtu, kompania mirëmbajtëse ka realizuar mirëmbajtjen e rregullt dhe ka zhvilluar kërkesa të reja funksionale të inicuar nga AKK. Në total, janë pranuar 12 raporte mujore të mirëmbajtjes për sistemin SIKTK-SOA.

Në vazhdim është paraqitur një tabelë për vitet 2023-2025 e transaksioneve kadastrale nga ZKK-të, përmes Sistemit të Informacionit Kadastral të Tokave në Kosovë (SIKTK):



8.5.2. SIKTK-HK

SIKTK-HK është sistem i bazuar në UEB me bazë të centralizuar të të dhënave. Sistemi përmban të gjitha veglat e duhura për mirëmbajtjen e Hartës Kadastrale bazuar në legjislacionin në fuqi (ligjet, udhëzimet administrative, kornizat e punës dhe doracakët).

Edhe gjatë këtij viti është vazhduar me administrimin e sistemit SIKTK-HK, sistem i cili ka qenë i qasshëm dhe funksional në 99.9% të kohës. Gjatë gjithë vitit i është ofruar përkrahje dhe mbështetje e vazhdueshme zyrtarëve të ZKK-ve që punojnë në aplikacionin SIKTK-HK. Gjithashtu janë monitoruar serverët kcm-app01, kcm-db01, kcm-gis01, kcm-gis02, kcm-gis03 dhe kcm-gis04, përcjellja e tyre në vazhdimësi nga bërja backup në follderët e caktuar deri tek kompresimi i tyre në follderin e caktuar bazuar në strategjinë e backupave që ka DTI. Gjithashtu është monitorua CPU dhe Memoria e këtyre serverëve.

Këtë vit janë krijuar 84 shfrytëzues të ri si përdorues bazik që punojnë në sistemin SIKTK-HK dhe 7 në rolin e adminit.

Administrimi i ueb faqes dhe i e-mail llogarisë së AKK

Qëllimi i ueb-faqes

- Kanal zyrtar i komunikimit mes AKK-së dhe palëve të interesit.
- Pikë qendrore për qasje në ueb-aplikacionet: KCLIS Tekstual, KCLIS Grafik, Geoportal, ARIS, statistikë ditore dhe module të tjera në zhvillim.
- Krijimi dhe administrimi i faqeve
- Rindërtimi i Kadastrit – faqe statike e integruar në menynë AKK dhe në server; funksionale.
- Arkivi i Rindërtimit – faqe statike e integruar dhe funksionale.
- Njoftim për fillimin e procedurës së zyrtarizimit të shitblerjeve joformale – publikuar listat sipas loteve.
- Version në gjuhën serbe: Obaveštenje o početku postupka formalizacije neformalne kupovine u postupku rekonstrukcije katastra – shfaqet në ballinën e faqes në gjuhën serbe dhe lejon qasje në përmbajtje.

Raporte, statistika dhe analiza në nivel databazash (DB)

Një prej aktiviteteve me konsumim më të lartë të resurseve në DTI në sektorin e Databazës, janë edhe zhvillimet e TSQL skripta-ve në nivel të databaza-ve (MS SQL Server) për përgatitjen e raporteve dhe statistikave me të dhëna kadastrale sipas nevojave dhe kërkesave. Përveç raporteve dhe statistikave, në nivel të databazave bëhen edhe hulumtime dhe analiza të të dhënave, lëndëve dhe proceseve kadastrale.

Aktiviteti i përvitshëm është edhe kontrolli i kualitetit të të dhënave si dhe prezantimit i këtyre të gjeturave në funksion të ngritjes së cilësisë së të dhënave dhe shërbimeve kadastrale. Në vazhdim janë listuar këto aktivitete:

- Përgatitja e statistikave nga databaza e SIKTK-T, mbi të dhënat kadastrale për regjistrimin e pronës me të drejtën Pronësi\Posedim i përbashkët. Këto të dhëna janë përgatitë vazhdimisht për disa institucione të cilat bëjnë përcjelljen e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve pas miratimit të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme. Të gjitha këto të dhëna janë përgatitë për vite të ndryshme, si dhe përgjatë muajve të caktuar të viti 2025. Kërkesat ishin nga institucione të ndryshme si Agjencia për Barazi Gjinore pran zyrës së Kryeministrit, Komunitet, AKK, Ministria e Drejtësisë përkatësisht Zyra e Koordinatorit Kombëtar, OSCE, Gazetat lokale, portalet etj.
- Përgatitja e raporteve mujore të cilat përdoren nga Zyra e Marketingut pran AKK-së për përgatitjen e faturave mujore për Bankat, Institucionet MicroFinanciare, Gjeodetët licencuar dhe institucionet tjera të cilat konsumojnë online shërbime kadastrale.
- Statistika dhe të dhëna kadastrale, gjendjet aktuale dhe arkivore nga sisteme të ndryshme janë përgaditur edhe për KFOR, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, MMPHI, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, Trepça SH.A., OSCE, Ndërmarrja Hidro-Ekonomike "Ibër Lepenci", Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" Sh. A, Ministria e Financave, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitet e Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., Gjykatat, Gazetat lokale dhe portalet, Studentët e UP-së, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës Sh.A, Termokos sh.a, KRK, DK dhe NJIP në AKK etj.
- Përkrahja e vazhdueshme për nxjerrjen e të dhënave për njësi kadastrale dhe pronarë për projektin e Energjisë së Ripërtrishme për Ministrinë e Ekonomisë, Departamenti i Energjisë- Divizioni për Burime të Ripërtrishme të Energjisë, Eficiencë dhe Bashkëprodhim.
- Gjatë vitit 2025, kemi pranuar kërkesa zyrtare nga Zyra Kombëtare e Auditimit për ofrimin e të dhënave kadastrale tekstuale për 660 titullarë të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës të evidentuar në sistemin e SIKTK-T. Këto kërkesa kanë përfshirë informacione mbi gjendjen e titullarëve dhe njësive kadastrale për periudhat referuese të viteve 2000, 2014 dhe 2025. Të dhënat janë punuar dhe dorëzuar me qëllim të mbështetjes së procesit të auditimit të pronave të këtij institucioni.

- Gjatë vitit 2025, kemi pranuar kërkesa zyrtare nga Zyra Kombëtare e Auditimit për ofrimin e të dhënave kadastrale tekstuale për të gjithë titullarët e MMPHI-së, duke përfshirë edhe titullarët në fushat e Rrugëve, Ujit dhe Infrastrukturës. Këto kërkesa kanë përfshirë informacione mbi gjendjen aktuale të titullarëve dhe njësisive kadastrale. Të dhënat janë përpunuar dhe dorëzuar me qëllim të mbështetjes së procesit të auditimit të pronave të këtij institucioni.
- Gjatë këtij viti, si DTI kemi pranuar disa kërkesa nga institucione të ndryshme për identifikimin e titullarëve të tyre në databazën e SIKTK-T. Qëllimi i këtyre kërkesave ka qenë që institucionet përkatëse të kryejnë verifikimin dhe më pas të propozojnë unifikimin e titullarëve në një emër dhe një ID të vetme. Institucionet që kanë parashtruar kërkesat janë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Korporata Energjetike e Kosovës; Kompanitë Rajonale të Ujësjetjes; Zyra për Administrimin e Pronës Publike pranë Zyrës së Kryeministrit; Komunitet; Institucionet Fetare; Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës.
- Agjencia Kosovare e Pyjeve ka kërkuar të dhënat për 31 zona kadastrale të Komunës së Podujevës dhe një zonë kadastrale të Komunës së Prishtinës, me qëllim nxjerrjen e të gjitha të dhënave të pronarëve juridikë (përveç shkollave ose subjekteve afariste) dhe të dhënave të njësisive kadastrale në këto zona, përfshirë edhe kulturat e tyre. Kërkesa është motivuar nga realizimi i një projekti për matjen e pyjeve në këto zona nga ana e Agjencisë. Të dhënat janë përgatitur dhe janë përcjellë përmes emailit.
- Përgatitja e statistikave, raporteve , që paraqesin gjendjen momentale dhe arkivore të pronarëve, njësisive kadastrale si dhe të lëndëve që janë punuar nëpër zona dhe komuna të ndryshme në gjithë Kosovën. Këto të dhëna janë kërkuar nga AKK dhe institucione tjera të Republikës së Kosovës.
- Përkrahje e vazhdueshme në aspektin e nxjerrjes së statistikave dhe raporteve të ndryshme për periudha të ndryshme për Njësine për Implementimin e Projektit REGIP pranë AKK-së.
- Përgatitja e të dhënave për parcela dhe pronarë për titullarët fizik, juridik të kërkuara nga Drejtoria e Kadastrit dhe Institucionet tjera.
- Hulumtime dhe analiza të natyrave të ndryshme në nivel databazash dhe aplikacionesh

- Gjatë këtij viti, si DTI kemi kryer nxjerrjen e vazhdueshme të të dhënave nga databaza e SIKTK-T për lëndët në proces që janë regjistruar nga ZKK para vitit 2025 dhe ende nuk janë përfunduar. Të dhënat janë përgatitur për secilën komunë dhe janë përcjellë përmes email-it tek drejtorët e Drejtorive Kadastrale pranë Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK). Po ashtu, vazhdimisht është bërë përcjellja e përpunimit, mbylljes së këtyre lëndëve nga ana e zyrtarëve përkatës të ZKK-ve.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përkrahur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Eurostat në procesin e themelimit të Indeksit të Çmimeve të Pronave Banesore (IÇPB) për periudhën 2018 – TM2 2025. Më datën 01.12.2025, Indeksi i Çmimeve të Pronave Banesore (IÇPB) është prezantuar për herë të parë nga ASK, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e statistikave zyrtare për tregun e pasurive të paluajtshme në Kosovë.

Realizimi i këtij projekti është bërë në mbështetje të plotë institucionale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), me të cilën ASK ka bashkëpunuar ngushtë gjatë gjithë procesit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, ASK ka kërkuar dhe ka pranuar nga AKK, të dhënat e transaksioneve nga viti 2018 deri në 2025, çka ka mundësuar ndërtimin dhe përditësimin e rregullt të këtij indeksi.

Në të ardhmen, AKK do të përgatisë dhe do t'i ofrojë ASK, në baza tremujore, të dhënat përkatëse, me qëllim të përditësimit të rregullt dhe të vazhdueshëm të Indeksit të Çmimeve të Pronave Banesore. Nga AKK janë siguruar të dhëna të detajuara për të gjitha transaksionet e shitblerjeve, duke përfshirë fushat kryesore si: komuna, zona kadastrale, lloji i njësisë, numri i njësisë, sipërfaqja, identifikuesi (ID) i lëndës së transaksionit, shuma e transaksionit, data e nënshkrimit të kontratës te noteri, data e regjistrimit të lëndës në regjistrin kadastral, shfrytëzimi aktual i njësisë, numri i katit, vendi i quajtur, emri i rrugës, tipi i pronës, si dhe klasifikimi urban apo rural. Këto të dhëna kanë shërbyer si bazë themelore për përllogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Pronave Banesore, duke siguruar saktësi metodologjike dhe përfaqësim të besueshëm të tregut të pasurive banesore.

- Nga Ministria e Financave, në kuadër të projektit 'Pilotimi i Reformës së Skemës së Asistencës Sociale (SAS)', çdo muaj dërgohet një listë që përmban numrat personalë të rreth 30,000 personave. Për këta persona kërkohet verifikimi nëse, gjatë tre (3) muajve të fundit, kanë realizuar ndonjë transaksion të shitjes së pronës, përkatësisht nëse kanë ndonjë lëndë të regjistruar në regjistrin kadastral. Ky proces shërben për vlerësimin e gjendjes pronësore të përfituesve potencialë dhe mbështet zbatimin korrekt dhe transparent të reformës së Skemës së Asistencës Sociale.

- Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave, bazuar në Programin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë Elektrike, të miratuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/270, datë 07.10.2025, si dhe me Vendimin e Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 60-4/25, datë 10.10.2025, ka kërkuar nxjerrjen e të dhënave mbi shitjen e pronave për periudhën Qershor 2024 – Korrik 2025. Kërkesa ka përfshirë dy lista me nga 252,730 persona secila. Të dhënat janë përgatitur dhe rezultati është përcjellë përmes email-it.

Të gjitha statistikat janë kërkuar dhe kanë kaluar përmes njërës nga këto zyre : Zyrës Ekzekutive/zv. Drejtorit të AKK-së, Zyrës Marketingut të AKK-së, Drejtoratit të Kadastrit pranë AKK-së ose Njesisë për Implementimin e Projektit REGIP të Bankës Botërore.

Përkrahja e përdoruesve të Sistemeve dhe Teknologjisë së Informacionit (SI/TI)
Përkrahja e përdoruesve të AKK-së dhe ZKK-ve

Punët dhe aktivitetet e DTI-së në përkrahje të shfrytëzuesve të sistemeve			
Komuna/institucioni		Përshkrim i aktivitetit	Nr. Shfrytëzuesve të përkrahur
AKK/ZKK	Çdo ditë	Përkrahje e shfrytëzuesve nga distanca ose në zyrë, përkrahje në shfrytëzimin e sistemeve të informacionit, menaxhimi me shfrytëzuesit e Domenit, menaxhimi i kompjuterëve si objekte në Domen, formatimi-konfigurimi i kompjuterëve dhe instalimi i aplikacioneve, instalimi dhe menaxhimi i pajisjeve periferike.	623

Përkrahja e përdoruesve të jashtëm

Përkrahjet dhe aktivitetet e DTI-se në raport me institucionet tjera			
Institucioni		Përshkrim i aktivitetit	Nr. Shfrytëzuesve të përkrahur
Noterë, Përmbaues, Ndërmjetësues , AKP, ATK, DTP, Banka, Institucione Microfinanciare, Përmbaues, Gjeodetë, PK, eKosova, Keds, Trepça, Ibër Lepenc, APK, KRK, NJIF, AKI	Çdo ditë	Përkrahje përmes telefonit dhe e-mailit, Krijim i shfrytëzuesit, Resetim i passwordit, përkrahje në shfrytëzimin e shërbimeve	Për 457 përdorues përmes GUI, si dhe mbështetja e institucioneve që konsumojnë përmes API-ve.

Menaxhimi i aplikacionit për testim online të gjeodetëve privat

Gjatë vitit 2025 janë organizuar katër testime online për licencimin e gjeodetëve. Përgatitja e ambientit për testime si dhe menaxhimi i aplikacionit dhe llogarive për këto testime nga ana e DTI janë realizuar sipas këtij rendi:

- Testimi i parë** është mbajtur më **31 janar 2025**. Në aplikacionin SpeedExam janë krijuar dhe konfiguruar **41 kandidatë**, nga të cilët testin e kanë zhvilluar **33 kandidatë**.
- Testimi i dytë** është mbajtur më **07 maj 2025**. Në aplikacionin SpeedExam janë krijuar dhe konfiguruar **25 kandidatë**, ndërsa testin e kanë zhvilluar **8 kandidatë**.
- Testimi i tretë** është mbajtur më **01 gusht 2025**. Në aplikacionin SpeedExam janë krijuar dhe konfiguruar **21 kandidatë**, prej të cilëve testin e kanë zhvilluar **6 kandidatë**.
- Testimi i katërt** është mbajtur më **28 tetor 2025**. Në testimin online për licencimin e gjeodetëve janë krijuar dhe konfiguruar **25 kandidatë**, ndërsa testin e kanë zhvilluar **13 kandidatë**. Te zhvendoset te licencimi

Përkrahja projekteve me kapacitete të TI
Përkrahje ne projektin “Zhvillimi dhe avancimi i sistemeve te informacionit kadastral”

DTI ka ofruar përkrahje të plotë teknike dhe infrastrukturore për avancimin, zhvillimin dhe operacionalizimin e sistemeve kryesore: Sistemi i Adresave (ARIS), Harta Kadastrale (HK), eKadastrri, Përçojat, Gjeodetët, si dhe komponentë të tjerë mbështetës të këtyre platformave.

Në kuadër të këtij angazhimi, janë krijuar dhe menaxhuar ambientet testuese dhe të prodhimit (production) për të gjitha sistemet e lartpërmendura, duke mundësuar testim të kontrolluar, validim teknik dhe kalim të sigurtë në prodhim. Në total, janë instaluar, konfiguruar dhe dokumentuar mbi 50 serverë virtualë, të cilët përbëjnë bazën infrastrukturore për funksionimin e këtyre sistemeve.

Infrastruktura është ndërtuar mbi Windows Server 2022 dhe është konfiguruar sipas standardeve moderne të TI-së, duke përfshirë konfigurime të rrjetës, regjistrim në domain, siguri, monitorim dhe dokumentim të plotë teknik. Për sistemet kritike janë implementuar arkitektura me disponueshmëri të lartë, përmes cluster-eve të databazave, Always On Availability Groups, load balancing dhe replikimit në DRC, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe rikuperimit të shpejtë në rast dështimesh.

DTI ka mbështetur integrimin e aplikacioneve me databazat përmes përdorimit të Group Managed Service Accounts (gMSA), duke rritur sigurinë dhe duke eliminuar përdorimin e fjalëkalimeve statike në konfigurime.

Në aspektin e sigurisë kibernetike, janë realizuar skanime të plota të kodit burimor dhe të infrastrukturës për të gjitha sistemet, duke përdorur platforma profesionale të sigurisë. Të gjitha të gjeturat janë trajtuar në bashkëpunim me Operatorët Ekonomikë deri në eliminimin e plotë të tyre. Paralelisht, serverët janë nënshtruar proceseve të avancuara të “security hardening”, përfshirë aplikimin e Windows Server 2022 Security Baseline, çaktivizimin e protokolleve të vjetruara (TLS) dhe mbylljen e porteve të panevojshme, duke përgatitur sistemet për publikim dhe përdorim në mjedisin production.

DTI ka qenë përgjegjëse edhe për përgatitjen e infrastrukturës për publikimin e sistemeve në internet, përfshirë vendosjen e certifikatave SSL, konfigurimet përkatëse në firewall dhe koordinimin me institucionet relevante, duke siguruar qasje të kontrolluar dhe komunikim të enkriptuar për shërbimet digjitale.

Në aspektin operacional, janë krijuar dhe menaxhuar rreth 500 përdorues në Active Directory për sistemet ARIS, SIKTK-HK, eKadastrin, Përçojat dhe Gjeodetët. Për secilin përdorues të rij, siç janë noterët, ndërmjetësuesit, përmbaruesit, gjeodetët, institucionet publike etj: janë hapur llogari, janë shpërndarë kredencialet përkatëse dhe janë plotësuar të dhënat identifikuese dhe kontaktuese (email, numër telefoni, numër letërnjoftimi), në përputhje me kërkesat e sistemeve. Gjatë gjithë vitit, DTI ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë përkrahje të vazhdueshme për përdoruesit, veçanërisht për qasje në sisteme, autentikim dhe zgjidhje të problemeve operative.

Po ashtu, për të gjitha sistemet e reja është konfiguruar monitorimi i vazhdueshëm i resurseve kryesore (CPU, RAM, hapësirë në disk dhe parametra të tjerë relevantë), si dhe janë përfshirë në politikat e replikimit në DRC, duke rritur ndjeshëm nivelin e stabilitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve.

Si përfundim, gjatë vitit raportues, DTI ka luajtur rol kyç në avancimin e sistemeve të TI-së nga aspekti infrastrukturor, duke ndërtuar një bazë teknike të qëndrueshme, të sigurtë dhe të shkallëzueshme për sistemet ARIS, Harta Kadastrale, eKadastrin, Përçojat, Gjeodetët dhe platformat përcjellëse, si dhe duke garantuar përkrahje të vazhdueshme për funksionimin e tyre në prodhim.

Përkrahja e vazhdueshme është ofruar gjithashtu nga sektori i DB-së, i cili ka pasur një rol të rëndësishëm dhe aktiv gjatë gjithë ciklit të zhvillimit të sistemeve. Në kuadër të këtij angazhimi, sektori i DB-së si pjesë e grupit punues ka realizuar teste të vazhdueshme dhe të detajuara të aplikacioneve që ndodheshin në faza të ndryshme të zhvillimit, si dhe ka analizuar dhe trajtuar në mënyrë sistematike raportet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga Operatori Ekonomik (OE).

Këto aktivitete kanë kontribuar drejtpërdrejt në identifikimin e hershëm të mangësive dhe çështjeve teknike, në adresimin e tyre me kohë, si dhe në dhënien e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e funksionalitetit, stabilitetit dhe sigurisë së aplikacioneve. Si rezultat i kësaj përkrahjeje të vazhdueshme dhe bashkëpunimit ndërsektorial, është siguruar rritja e cilësisë së përgjithshme të aplikacioneve dhe përgatitja e tyre për finalizim dhe implementim të suksesshëm.

Përkrahje në projektin “Rindërtimi i Kadastrit”

Gjatë këtij viti, DTI ka ofruar përkrahje të vazhdueshme dhe të koordinuar në zbatimin e procesit të RIK-ut, me fokus të veçantë në nxjerrjen, përpunimin dhe ofrimin e të dhënave të nevojshme për realizimin e këtij procesi. Përkrahja ka përfshirë sigurimin e të dhënave për Operatorët Ekonomikë (OE) dhe menaxherët e loteve, në mënyrë që të sigurohet një mjet i besueshëm dhe i saktë i informacionit për nevojat operative dhe administrative të procesit të RIK-ut. Në këtë kuadër, janë përgatitur dhe dorëzuar të dhëna të strukturuar, të cilat kanë kontribuar në mbarëvajtjen e aktiviteteve të parashikuara dhe në përmbushjen e kërkesave të parashtruara nga përgjegjësit. Në kuadër të procesit të RIK-ut, Komisioni përkatës pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës ka kërkuar, përmes email-it, të dhënat kadastrale tekstuale për 90 zona kadastrale, të ndara në katër lote, në 24 komuna. Të dhënat janë nxjerrë nga databaza e SIKTK-T, janë përpunuar dhe janë vendosur në një shteg të përcaktuar elektronik ose përmes emailit ku më pas janë marrë dhe përdorur nga menaxherët e secilit lot për nevojat e verifikimit dhe përfundimit të procesit.

Përkrahje në projektin “Zhvillimi i Gjeoportalit Shtetëror”

DTI ka ofruar përkrahje të plotë për ndërtimin dhe funksionalizimin e Geoportalit Shtetëror (NSDI Geoportal), me qëllim krijimin e një platforme të qëndrueshme dhe të sigurtë për menaxhimin dhe publikimin e të dhënave gjeohapësinore në nivel shtetëror.

Në këtë kuadër, është përgatitur infrastruktura e nevojshme teknologjike për Geoportalin Shtetëror, ku janë krijuar dhe konfiguruar 15 serverë të dedikuar për funksionimin e sistemit. Këta serverë janë përgatitur sipas standardeve institucionale, janë integruar në rrjetin ekzistues dhe janë dokumentuar për qëllime të mirëmbajtjes dhe menaxhimit afatgjatë.

Për të siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe pa ndërprerje, infrastruktura është ndërtuar me mekanizma për disponueshmëri të lartë dhe redundancë, duke mundësuar vazhdimësi të shërbimeve edhe në rast të problemeve teknike. Po ashtu, është siguruar ndarja e komponentëve të brendshëm nga ata të ekspozuar në internet, në përputhje me praktikën e mira të sigurisë.

DTI ka ofruar mbështetje edhe për përpunimin dhe publikimin e hartave 3D, përmes përgatitjes së serverëve të dedikuar, të cilët janë integruar në infrastrukturën ekzistuese dhe shërbejnë për përmirësimin e cilësisë dhe funksionalitetit të shërbimeve të Geoportalit.

Në aspektin e sigurisë, janë zbatuar masa të avancuara për mbrojtjen e sistemit, përfshirë përforsimin e serverëve të ekspozuar në internet dhe aplikimin e praktikave më të mira të sigurisë. Sistemi është nënshtruar edhe proceseve të kontrollit të sigurisë, pa u evidentuar rreziqe serioze që do të ndikonin në funksionimin e tij.

Si pjesë e përgjegjësisë të saj, DTI ka bashkëpunuar ngushtë me Operatorët Ekonomikë dhe palët e tjera relevante, duke ofruar përkrahje të vazhdueshme gjatë fazave të testimit dhe vendosjes së sistemit në prodhim.

Përkrahje në projektin “Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit Ndërtesave”

Qëllimi i këtij projekti është korrigjimi dhe azhurnimi i pjesëve të ndërtesave në pjesën grafike, duke u bazuar në pjesën tekstuale, me qëllim që të dhënat për pjesët e ndërtesave të jenë të njëjta dhe të harmonizuara në të dy sistemet (grafik dhe tekstual).

Gjatë vitit 2025 janë përkrahur shfrytëzuesit nga OE GeoCad. Përgjatë gjithë vitit, OE GeoCad kanë realizuar korrigjimin dhe krijimin e pjesëve të ndërtesave në SIKTK-HK dhe SIKTK-T. Në vazhdimësi, nga ana jonë, sipas kërkesave janë nxjerrë të dhënat e kërkuara në nivel databazash.

Si rezultat i kësaj analize janë identifikuar:

- pjesët e ndërtesave të përbashkëta në të dy sistemet (grafike dhe tekstuale),
- pjesët e ndërtesave që ekzistojnë vetëm në Cadastral Map,
- pjesët e ndërtesave që kanë shfrytëzim aktual të ndryshëm nga ai i regjistruar në pjesën tekstuale.

Këto të dhëna janë nxjerrë me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë ndërmjet pjesës grafike dhe asaj tekstuale për pjesët e ndërtesave.

Gjithashtu, është nxjerrë numri i pjesëve të ndërtesave të korrigjuara nga secili shfrytëzues veç e veç dhe me afate të caktuara. Kjo metodë e kontrollit dhe verifikimit të të dhënave ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2025.

Përkrahje në projektin “Analizimi, korrigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaborateve të shpronësimit”

Në Republikën e Kosovës janë zhvilluar shumë procese të shpronësimit si nga niveli qendror ashtu edhe nga ai lokal, mirëpo shumica e tyre ende nuk janë të regjistruara në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokave të Kosovës (SIKTK). Përmes këtij projekti, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) synon regjistrimin e pronave të shpronësuara në SIKTK, bazuar në vendimet përfundimtare të shpronësimit dhe në studimin e plotë teknik të pronës së paluajtshme të shpronësuar.

Operatori Ekonomik (OE) ka realizuar një analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave të shpronësimit, duke krahasuar të dhënat e shpronësuara me të dhënat ekzistuese në SIKTK, si dhe me vendimet përfundimtare të shpronësimit. Në bazë të kësaj analize, OE ka përgatitur një raport të detajuar mbi gjendjen aktuale të të dhënave.

Gjatë vitit 2025, Drejtorati për Kadastër në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar informacione për të gjitha lëndët e regjistruara në SIKTK-T dhe SIKTK-HK, për periudha dhe afate të caktuara. Po ashtu, janë evidentuar edhe përdoruesit nga Operatorët Ekonomikë (OE) që kanë punuar në përpunimin dhe regjistrimin e këtyre të dhënave.



9

**BUXHET
DHE FINANCA**

9 BUXHET DHE FINANCA

9.1. Buxheti

Buxheti final i ndarë për AKK-në për vitin 2025 ka qenë në vlerë prej: 7,142,482.61 €, nga dy fonde të financimit, Granti i Qeverisë dhe Huamarrja.

Buxheti i shpenzuar në total nga dy fondet e financimit ka qenë: 5,071,479.22 €, apo 71%nga vlera e buxhetit.


Buxheti i ndarë dhe realizuar sipas kategorive

Totali 1. Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive, Fondi burimor 10,BK - Ndarja finale			
Destinimi	Buxheti i planifikuar nga AKK(€)	Buxheti i aprovuar(€)	Buxheti i rishikuar(€)
Pagat	673,730.04	459,979.00	569,158.89
Mallra dhe Shërbime	1,050,000.00	600,000.00	528,516.72
Shërbime Komunale	5,500.00	5,500.00	5,500.00
Pasuri jo Financiare	625,000.00	630,000.00	630,000.00
Totali:	2,354,230.04	1,695,479.00	1,733,175.61

Tabela 2. Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive, Fondi burimor 04-06, Huamarrja			
Destinimi	Buxheti	Shpenzimi	Buxhet / Shpenzim %
Mallra dhe Shërbime	842,100.00€	753,613.91€	90
Pasuri jo Financiare	4,567,207.00€	2,989,420.70€	65
Totali:	5,409,307.00€	3,743,034.61€	69

Realizimi i pagesave gjatë vitit 2025 sipas kategorive dhe numrit të lëndëve

- Mallra dhe shërbime – 208 lëndë
- Komunali – 11 lëndë
- Banka Botërore – 989 lëndë
- Klauzola investuese – 27 lëndë
- Kapitale – 3 lëndë




Numri i lëndëve të realizuara- pagesa gjatë vitit 2025 në total është: 1238 lëndë

TE HYRAT

Vlera e të hyrave për vitin 2025 është: 312,788.30€ nga dy kategoritë e te hyrave, licencave dhe produkteve tjera.

1. Pasqyra e të hyrave sipas kostos					
Kodet	Janar-Mars	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Dhjetor	Totali
50401	32,461.00 €	47,606.00 €	89,160.50 €	119,060.80 €	288,288.30 €
50201	11,200.00 €	5,300.00 €	3,800.00 €	4,200.00 €	24,500.00 €
BK	43,661.00 €	52,906.00 €	92,960.50 €	123,260.80 €	312,788.30 €

Te hyrat e vitit 2025



Numri i faturave të lëshuara për produkte dhe shërbime gjatë viti 2025 ka qenë **2925**

2.Sasia e produkteve sipas llojit		
Nr.	Emërtimi-Produktit-Shërbimit	Sasia
1	AKK, 04/2024 Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online, për një përdorues UEB aplikacione	1
2	AKK, 04/2024 Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online, për një përdorues UEB SHËRBIME si institucion	1
3	AKK, 04/2024 Parcela digjitale - shapefile, DWG - file (Për Institucionet e Republikës së Kosovës)	6,372
4	DK, 04/2024 Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	3
5	AKK, 04/2024 Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online, për një përdorues UEB aplikacione për person (Institucione)	4
6	DK, 04/2024 Regjistrimi i të drejtave në bazë të Aktvendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë apo Testamentit	104
7	DK, 04/2024 Regjistrimi i të drejtave bazë të Kontratës së dhurimit	12
8	DK, 04/024 Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat këtij Udhëzimi Administrativ	3
9	DK, 04/24 Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	20
10	DK, 04/2024 Korrigjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët	49
11	DK, 04/24 Regjistrimi i të drejtave në bazë të Kontratës së shitblerjes	29
12	AKK, 04/24 Pikat e kufijve të njësive kadastrale Y, X	55
13	AKK, 04/24 Tarifa vjetore për Web Shërbime dhe shërbime tjera(Certifikatë pronësie, kopje plani dhe informatë)	4
14	DK, 04/24 Tarifa për regjistrimin e njësisë së re kadastrale	95
15	DK, 04/2024 Kopja e planit	35
16	DK, 04/24 Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	10,947
17	DK, 04/24 Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona	15

18	DK, 04/24 Histori ati për njësi kadastrale - mbi pesë (5) njësi	1
19	DK, 04/24 Histori ati për njësi kadastrale - deri në pesë (5) njësi	8
20	DK, 04/24 Regjistrimi i të drejtave në bazë të vendimit të organit administrativ, gjyqësor dhe çdo dokumenti juridik që parashihet fitimi i pronësisë	29
21	AKK, 04/24 Tarifa 1 mujore për një shfrytëzues - RTK	8
22	AKK, 04/24 Tarifa 6 mujore për një shfrytëzues - RTK	19
23	AKK, 04/24 Tarifa 1 vjetore për një shfrytëzues Rinex dhe Postprocesim	2
24	AKK, 04/24 Tarifa 1 vjetore për një shfrytëzues - RTK	117
25	AKK, 04/24 Regjistrimi fillestar i një shfrytëzuesi	75
26	AKK, 04/24 CD-kompakt disku	7
27	AKK, 04/24 Pikat e kufijve të njësive kadastrale Y, X	690
28	AKK, 04/24 Tarifa për verifikimin e informacioneve për njësi kadastrale.	39,133
29	AKK, 04/24 Tarifa për verifikimin e informacioneve për person	4,737
30	AKK, 04/24 Regjistrimi i hipotekës	4,190
31	AKK, 04/24 Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online, për një përdorues UEB SHËRBIME si institucion	1
32	AKK, 04/24 Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online, për një përdorues UEB aplikacione	86
33	AKK, 04/24 Informata kadastrale për komunë-statistikë	38
34	AKK, 04/24 Informata për njësi kadastrale	8,091
35	AKK, 04/24 Transformimi i koordinatave	370
36	AKK, 04/24 Modeli digjital i terrenit - MDT 2018 për km2	20
37	AKK, 04/24 Harta topografike 2016 GjeoTIFF - Raster - për fletë te hartës	32
38	AKK, 04/24 Harta topografike 2016 1:25000 - PDF - për fletë te hartës	26
39	AKK, 04/24 Harta kadastrale digjitale - e vjetër	2
40	AKK, 04/24 Ortofoto digjitale rurale (viti 2024)	10,966
41	AKK, 04/24 Ortofoto digjitale urbane (viti 2024) 1X1km2	1,314
42	AKK, 04/24 Ortofoto - digjitale - rurale 40 pixel (viti 2001) - për imazh	1
43	AKK, 04/24 Ortofoto - digjitale - urbane 20 pixel. (viti 2001) - për imazh	1
44	AKK, 04/24 Printimi - A4 kolor	16
45	AKK, 04/24 Printimi - A4 bardh - zi	82
46	AKK, 04/24 Harta tematike- jpg	1
47	AKK, 04/24 Ortofoto â€” jpg - (1:500, 1:1000, 1:2500, 1:5000)	1
48	AKK, 2022. Ueb shërbime-Tarifa për verifikimin e informacioneve për njësi kadastrale	429
49	AKK, 2022. Ueb shërbime-Tarifa për verifikimin e informacioneve për person	18
50	SH_online, SH_Online Tarifa për verifikimin e informacioneve për njësi kadastrale	5
Totali:		88,265

9.2. Raporti vjetor financiar për vitin 2025

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka të regjistruar pasuri, në total në vlerë prej : **6,729,045.61€**

Gjatë viti 2025 janë regjistruar në total: **4,272,910.07€** si pasuri jo financiare.

1. Pasuria sipas kategorive ekonomike te regjistruara gjatë viti 2025		
Nr.	Kategoria	Vlera €
1.	Pajisje tjera	16,577.00 €
2.	Vetura zyrtare	65,914.00 €
3.	Pasuri të pa prekshme	1,846,403.73 €
4.	Investime në vijim	2,344,015.34 €
Totali:		4,272,910.07 €

9.3. Prokurimi publik

AKK ka përgatitur raportin vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike për aktivitetet e prokurimit publik të AKK-së për vitin fiskal 2025, të realizuara përmes Sistemit Elektronik të Prokurimit, në kuadër të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP).

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe paraqet një analizë të detajuar të të gjitha aktiviteteve të prokurimit publik të zhvilluara në AKK, sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit fiskal 2025.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2025, ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) Planifikimin Final të Prokurimit. Ky planifikim është hartuar në bazë të kërkesave të njësive kërkuese, të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe nga u.d. Drejtori Ekzekutiv, dhe ka qenë plotësisht në përputhje me buxhetin e miratuar të AKK-së për vitin fiskal përkatës.

Bazuar në Planifikimin Final të Prokurimit për vitin fiskal 2025, AKK ka zhvilluar gjithsej gjashtë (6) aktivitete të prokurimit publik, një (1) aktivitet të anuluar dhe një (1) ndërprerje të kontratës.

Çdo proces i prokurimit është administruar në përputhje me procedurat ligjore dhe ka kaluar nëpër fazat vijuese: planifikimi i prokurimit, parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës, përcaktimi i procedurës së prokurimit, përgatitja e dosjes së tenderit, publikimi, hapja dhe vlerësimi i tenderëve, dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, menaxhimi i kontratës.

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, AKK ka raportuar dhe paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara gjatë vitit fiskal 2025. Raporti në vijim pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2025 në AKK.

Prokurimi				
Nr.	Përshkrimi i kontratës	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Vlera e kontratës	Data e lidhjes së kontratës
1.	Sigurimi i veturës zyrtare	KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.	303.03€	27.03.2025
2.	Furnizim për zyrë - material zyrtar.	A.R.F. SH.P.K.	1,014.75€	21.05.2025
3.	Furnizim me licenca të VPN	InterAdria L.L.C.	559.50€	10.06.2025
4.	Avancimi i Infrastrukturës për TI (HW+SW) - Furnizim dhe Instalim i Sistemeve të Ftohjes.			Anulim - për shkak të një gabimi të pariparueshëm në specifikat teknike.
5.	Avancimi i Infrastrukturës për TI (HW+SW) - Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative.	" KOSPROD " SH.P.K.	35,118.00€	02.10.2025 Për shkak të mos-përmblotjes së kontratës, nga OE " KOSPROD " SH.P.K., AKK ka ndërprerë kontratën.
6.	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive në Republikën e Kosovës.	Lorenzo & Co Sh.p.k	294,000.00€	18.11.2025



10

TRAJNIMET
E OFRUARA

10 TRAJNIMET E OFRUARA

10.1. Trajnimet e stafit të ZKK-ve

Gjatë vitit 2025 janë trajnuar gjithsej 25 zyrtarë të Zyreve Kadastrale Komunale në SIKTK Tekstuale dhe SIKTK – Harta Kadastrale.

10.2. Trajnim për Stafin e Operatorëve Ekonomik - Projekti për Rindërtimin e Kadastrit

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), ka organizuar trajnim dedikuar enkas për stafin e operatorëve ekonomikë, përfshirë procedurat dhe aspektet praktike të realizimit të Projektit të Rindërtimit të Kadastrit.

Trajnimi u zhvillua në dy sesione kryesore:

Pjesa Juridike, trajtoi aspektet ligjore dhe procedurat që duhet të ndiqen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ofruar qartësi mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve.

Pjesa Teknike, përfshiu praktikën teknike dhe metodologjitë që duhen ndjekur në terren, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të punës.

Në këtë trajnim morën pjesë më shumë se 40 përfaqësues të Operatorëve Ekonomik.



11

LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODEZIKE

11 LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODEZIKE

11.1. Reformimi i procesit të licencimit

Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për licencimin e Gjeodetëve dhe Kompanive gjeodezike bazuar në Ligjin Nr. 08/-L-237 për Kadastër të pronës së paluajtshme. Me Udhëzimin Administrativ MMPHI nr.06/2024 për dhënien e lejes kompanive gjeodezike dhe licencimin e gjeodetëve, përcaktohen procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies së lejes kompanisë gjeodezike, dhe licencimit të gjeodetit, emërimi, përbërja dhe puna e Komisionit për leje dhe licencim si dhe tarifat për dhënien e lejes dhe licencës. Ndër ndryshimet kryesore është pragu i kalueshmërisë, mosha e pensionimit dhe kushtet për licencim. Ndryshime me këtë udhëzim janë bërë edhe në përbërjen e komisionit duke përfshirë një anëtar të propozuar nga Ministria dhe një nga Oda e Gjeodetëve, ku mandati i tyre është një vjeçar.

Testi për licencim nga viti 2024 ka ndryshuar strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e zhvillimit. Tashmë gjeodetët në përmbajtjen e testimit kanë të përfshirë edhe fushën e gjeodezisë përpos asaj të kadastrit. Në test gjeodetët testohen edhe me një detyrë në zgjidhjen e një rasti “të imagjinuar” nga terreni.

Gjatë vitit 2025 në Republikën e Kosovës janë licencuar: 61 gjeodetë dhe 10 kompani gjeodeze.

Sistemi për Licencimin e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodeze

(Aplikimi përmes platformës eKosova)

Fillimisht janë bërë ndryshimet në bazën ligjore ku janë nxjerrë UA-të e reja në mënyrë që të përshkruhet aplikimi i ri përmes platformës eKosova. Me këtë rast janë reduktuar procedurat e tepërta që kanë qenë për aplikim fizik dhe është krijuar infrastruktura e re për aplikim online, me anë të së cilës nuk ka nevojë për dorëzimin e dokumenteve në formë fizike meqenëse validohen në mënyrë digjitale përmes këtij aplikacioni dhe ndërlidhjes me sistemet tjera siç është eKosova.

Në kuadër të komponentës për reduktimin e barrës administrative, ky projekt është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe është implementuar nga GIZ-i gjerman. Pronësinë e këtij sistemi e ka Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe njëkohësisht është përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Nga janari 2025, janë hequr pengesat burokratike, është thjeshtuar procedura e licencimit, është hequr dokumentacioni i tepërt dhe është rritur efikasitetin, e në veçanti po kontribuojmë në mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave. Përdorimi i platformës ka rezultuar i suksesshëm qysh në fillim ku vetëm në afatin e janarit 2025 kanë aplikuar suksesshëm mbi 40 aplikant.

11.2. Trajnimet e gjeodetëve dhe shpërndarja e licencave

Gjatë vitit 2025 kanë qenë 4 afate të aplikimit për licencim sipas legjislacionit në fuqi. Në afatin e janarit nga 44 aplikues, kanë arritur që pas trajnimeve dhe hapave të përcaktuar për kontrollimin dhe kalueshmërinë e testimit të licencohen 3 kompani gjeodezike dhe 30 gjeodet, në afatin e prillit nga 47 aplikues janë licencuar 4 kompani gjeodeze dhe 11 gjeodet, në afatin e korrikut nga 25 aplikues janë licencuar 4 kompani dhe 6 gjeodet dhe në afatin e tetorit nga 28 aplikues janë licencuar 14 gjeodet.

Gjatë kësaj periudhe sipas përgjegjësisë të AKK-së është kryer monitorimi i gjeodetëve, ku janë lëshuar 2 vërejte dhe është revokuar një licencë. Në pritje për trajtim janë edhe dy licenca. Revokimi i licencave të gjeodetëve kryhen në bazë të konstatimit për shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin për kadastër të pronës së paluajtshme dhe UA në fuqi.







12

**MONITORIMI I ZYRAVE
KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE
TË LICENCUARA GJEODETE
DHE GJEODETËVE TË LICENUAR**

12

MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR

Konform Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve kadastrale të kryera sipas dispozitave të këtij ligji si dhe dhënien e rekomandimeve dhe urdhrave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë mbikëqyrje.

Gjatë vitit 2025, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka zhvilluar një cikël të plotë monitorimi të punëve dhe aktiviteteve kadastrale në 34 komuna të Republikës së Kosovës, duke mbuluar kështu shumicën e Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK). Përgjatë këtij intervali kohor janë kontrolluar deri në 500 lëndë për pjesën pronësore – juridike dhe pjesën grafike/teknike.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ka qenë kontrolli i kualitetit të lëndëve të regjistruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), identifikimi i mangësive procedurale, teknike dhe ligjore, si dhe parandalimi i përsëritjes së tyre në të ardhmen.

Ekipet profesionale të AKK-së gjatë monitorimit kanë analizuar mostra të regjistrimeve të lëndëve në sistem në secilën komunë, duke verifikuar përputhshmërinë e të dhënave me dokumentacionin ligjor, gjendjen faktike në terren dhe standardet e SIKTK-së.

Për secilën nga komunat e vizituara, ekipet përkatëse kanë përgatitur raporte individuale me rekomandime të detajuara, të cilat përfshijnë:

- korrigjimin e mangësive të identifikuara brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- organizimin e trajnimeve të specializuara për stafin e ZKK-ve;
- përmirësimin e kontrolleve automatike në SIKTK, etj.

Ky cikël monitorimi i vitit 2025 ka pasur një impakt të dukshëm pozitiv në funksionimin e sistemit kadastral dhe ka kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e objektivave strategjike të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke ofruar:

- Rritje të besueshmërisë së Regjistrimit të të dhënave kadastrale - Identifikimi dhe korrigjimi i mangësive të lëndëve të kontrolluara ka krijuar një bazë solide për një SIKTK më të saktë dhe azhure, duke forcuar sigurinë juridike të pronave.
- Mbrojtje efikase të të drejtave pronësore të qytetarëve - Duke eliminuar gradualisht gabimet gjatë regjistrimit përmes dokumentacionit jo të plotë, monitorimi ka rritur poashtu besimin e qytetarëve në sistemin kadastral dhe ka lehtësuar regjistrimet e transaksioneve e pronësore (shitblerjeve, hipotekave etj).
- Përmirësim i efikasitetit dhe shpejtësisë së shërbimeve - Rekomandimet për trajnime dhe përmirësim të kontrolleve automatike në SIKTK kanë ulur vonesat në ZKK-të dhe kanë rritur kapacitetin e stafit për të trajtuar regjistrime të reja me kualitet më të lartë.
- Forcimi i bashkëpunimit institucional - Koordinimi i ngushtë i krijuar me noterët, gjykatat dhe komunat ka krijuar një rrjet më të fortë bashkëpunimi, duke reduktuar mospërputhjet ligjore dhe duke parandaluar regjistrime të pasakta në sistem.
- Kontribut në zhvillimin ekonomik dhe investime - Një sistem kadastral më i besueshëm ul rrezikun për investorët vendas dhe të huaj, lehtëson aksesin në kredi bankare të garantuara me pronë dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
- Avancim drejt vizionit strategjik të AKK-së - Monitorimi është një hap konkret drejt realizimit të synimit për një regjistër pronësor digjital, të saktë dhe të qasshëm në kohë reale – duke e afruar Kosovën me standardet evropiane të infrastrukturës kadastrale dhe qeverisjes elektronike.

- Nga faza e 11 dhe e 12 e monitorimit të ZKK-ve dhe gjeodetëve/kompanive gjeodete të licencuara, të gjeturat ishin si më poshtë:

Për pjesën juridike:

- Skanimi i lëndëve nuk është i kualitetit të duhur, pasi që dokumentet nuk mund të lexohen, mungojnë dokumente të skenuara në bazë të cilave është vendosur në lëndë
- Lëndët janë regjistruar me vonesë në SIKTK nga data e aplikimit
- Nuk është respektuar afati i aprovimit të lëndës
- Mungon dëshmia e pagesës për regjistrim
- Afati për pezullimin e lëndës nuk është përcaktuar dhe arsyetimi nuk është bërë mbi bazën e dokumenteve të paraqitura;

Për pjesën teknike:

- Skanimi i lëndëve nuk është i kualitetit të duhur, pasi që dokumentet nuk mund të lexohen
- Lëndët janë regjistruar me vonesë në SIKTK nga data e aplikimit, vonesat janë edhe mbi një muaj në regjistrim
- Edhe pas ndryshimit të afatit për regjistrim të ndryshimeve për njësi kadastrale në 15 ditë në 3 ditë sa ka qenë, ende ka vonesa në regjistrim
- Pezullimet kryesisht janë të pa plotësuar për çështjen për plotësim, por vetëm shablloni nga sistemi
- Lëndët punohen me legjislacion dhe kornizë të vjetër
- Nga gjeodetët dhe palët kërkohen dokumente për të cilat AKK i ka liruar (certifikata e pronës, kopja e planit, licenca dhe letërnjoftimi i gjeodetit)
- Produktet e lëshuara nga ZKK janë të pa nënshkruara dhe pa vulosura
- Në Hartë Kadastrale nuk përditësohen të gjitha atributet e paraqitura nga gjeodeti (kuotat dhe kodet)
- Koordinatat e matura dyfish në të shumtën e rasteve janë me ndryshime 0
- Korrigjimi i sipërfaqes nuk është kryer
- Faturat për shërbimet e gjeodetit nuk janë sipas Udhëzimit në fuqi
- Pagesat e produkteve të lëshuara nga ZKK-të bëhet në ditën e dorëzimit të lëndës për regjistrim
- Aplikohet pagesa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta edhe pse me Udhëzim Administrativ janë të liruara

Kurse për çdo komunë veç e veç komentet janë të ndryshme dhe të njëjtat u janë përcjellë ZKK-ve.

Në përfundim, ky proces monitorimi nuk ka qenë thjesht një aktivitet kontrolli, por një investim strategjik që ka prodhuar vlera të prekshme për qytetarët, institucionet dhe ekonominë e Kosovës, duke vendosur themelet për një sistem kadastral modern dhe të besueshëm në vitet në vijim.

Statistikat nga lëndët e kontrolluara				
Komuna	Nr. Lëndëve juridike faza I	Nr. Lëndëve juridike faza II	Nr.Lëndëve teknike faza I	Nr.Lëndëve teknike faza II
Prishtinë	10	8	10	12
Mitrovicë	10	10	10	11
Skënderaj	05	05	8	8
Obiliq	05	05	6	4
Novobërdë	05	05	9	5
Prizren	10	10	10	8
Suharekë	05	07	10	9
Dragash	04	04	9	8
Shtërpçë	05	04	2	2
Shtime	05	05	9	5
Mamushë	07	08	4	1
Fushë Kosovë	10	05	10	10
Glllogoc	10	05	5	10
Podujevë	10	05	10	10
Gjilan	10	10	10	11
Kamenicë	05	05	7	7
Viti	05	05	10	10
Klllokot	05	05	2	2
Partesh	05	05	3	-
Ranillug	05	05	4	4
Rahovec	05	05	10	9
Vushtrri	05	05	10	10
Pejë	10	10	10	10
Istog	10	10	5	4
Klinë	05	05	10	8
Gjakovë	10	10	10	10
Junik	05	05	6	6

Malishevë	05	05	10	10
Deçan	08	10	10	9
Ferizaj	15	10	10	8
Graçanicë	07	10	8	8
Kaçanik	05	05	10	9
Han i Elezit	05	05	8	4
Lipjan	06	05	5	10
TOTAL:	232	206	270	242



13

PËRMBLEDHJE E SHËRBIMEVE
DHE STATISTIKAVE PËR
TË DHËNAT E OFRUARA
NGA AKK


13 PËRMBLEDHJE E SHËRBIMEVE DHE STATISTIKAVE PËR TË DHËNAT E OFRUARA NGA AKK

13.1. Statistika nga SIKTK

Në vitin 2025 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë lëshuar gjithsej 145,495 Certifikata , ku prinë Prishtina me 15,435 Certifikata të lëshuara, ndërsa e fundit është Kllokoti me 286 Certifikata të lëshuara.


Numri i njësive kadastrale në SIKTK deri me 31.12.2025 është:

- Parcela 2,263,702
- Ndërtesa 34,943
- Pjesë të Ndërtesave 156,068



Numri total i pronarëve : 655,439

- Meshkuj: 505,043 (77,05 %)
- Femra 137,747 (21,02 %)
- Persona Juridik 12, 649 (1,93%)



13.2. Statistika për numrin e kërkesave dhe nga institucionet dhe lëndëve të regjistruara nëpërmjet sistemeve nga përdoruesit e jashtëm

Ofrimi i Shërbimeve kadastrale online përmes platformës eKosova

Në platformën qeveritare eKosova janë të qasshme këto shërbimet kadastrale. Qytetarët të cilët janë të regjistruar në platformën eKosova dhe janë të verifikuar në nivelin 2, mund të konsumojnë këto shërbime:

- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme
- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme për anëtarë të familjes
- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme për biznese
- Koordinatat e njësisë kadastrale
- Koordinatat e njësisë kadastrale për anëtarë të familjes
- Koordinatat e njësisë kadastrale për biznes
- Kopja e planit për njësi kadastrale
- Kopja e planit për njësi kadastrale për anëtarë të familjes.
- Kopja e planit për njësi kadastrale për biznes.
- Gjeoportali Kosovës-pronarët
- Apliko për licencë të gjeodetit
- Apliko për leje të kompanisë gjeodezike
- Kërkesë për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit KOPOS

Statistika të cilat paraqesin nivelin e shfrytëzimit të këtyre shërbimeve janë si në vijim:

- Certifikata për person të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 21927
- Certifikata për njësi të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 169916
- Kopje plani për njësi të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 9120
- Koordinatat e njësisë të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 1298
- Aplikime në platformën eKosova për licencë të gjeodetit janë gjithsej 134
- Aplikime në platformën eKosova për licencë të kompanive gjeodezike janë gjithsej 10
- Aplikime në platformën eKosova për shërbimin KOPOS janë gjithsej 52

Shkëmbimi i të dhënave kadastrale

Shkëmbimi i të dhënave kadastrale me institucionet e tjera realizohet në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstytucional, të nënshkruara paraprakisht. Aktualisht, shërbimet kadastrale po konsumohen nga këto institucione: Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Oda e Përmbaruesve Privatë, Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, Oda e Ndërmjetësuesve, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia Kosovare e Privatizimit, Oda e Noterëve të Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, Agjencia Pyjore e Kosovës, gjeodetët privatë të licencuar, KEDS, Trepça, Ibër-Lepenc dhe Policia e Kosovës.

Shërbimi i adresave është i integruar në platformën eKosova dhe është i disponueshëm për të gjithë përdoruesit e interesuar. Po ashtu, Administrata Tatimore e Kosovës e shfrytëzon këtë shërbim për caktimin e adresës zyrtare të tatimpaguesve.

Gjatë këtij viti, pas nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit, konsumimin e shërbimeve digjitale kadastrale e kanë filluar edhe institucionet: KEDS, Trepça, Ibër-Lepenc dhe Ndërmjetësuesit.

Departamenti i Tatimit në Pronë, bankat, institucionet mikrofinanciare dhe ATK i konsumojnë shërbimet kadastrale përmes ueb-shërbimeve (API), ndërsa institucionet e tjera i konsumojnë shërbimet kadastrale përmes aplikacionit të zhvilluar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), i cili u dedikohet institucioneve që nuk kanë sisteme të veta për integrim përmes ueb-shërbimeve.

Përmes këtij aplikacioni (në formë GUI), shërbime kadastrale marrin rreth 457 përdorues nga të gjitha institucionet e lartcekura.

Gjatë këtij viti në këtë aplikacion janë krijuar 231 përdorues.

Për të gjitha institucionet që konsumojnë shërbimet kadastrale, përgatiten raporte mujore, ndërsa faturat për pagesë përcillen përmes Divizionit të Hyrave nga Produktet Kadastrale dhe Pasurisë tek institucionet përkatëse.

Gjatë vitit, është ofruar përkrahje e vazhdueshme teknike për përdoruesit që kyçen drejtpërdrejt në sistemet kadastrale të informacionit, si dhe për ata që konsumojnë shërbimet kadastrale përmes platformës eKosova.

Po ashtu, më 30 nëntor, Departamenti i Tatimit në Pronë, përmes ueb-shërbimeve të AKK-së, ka konsumuar të gjitha të dhënat kadastrale grafike dhe tekstuale, me qëllim të faturimit të tatimit në pronë për qytetarët. Gjatë gjithë këtij procesi, AKK ka ofruar përkrahje të vazhdueshme teknike dhe operative, duke asistuar aktivisht në fazën e shkarkimit dhe përpunimit të të dhënave, me synim sigurimin e saktësisë, integritetit dhe funksionimit të pandërprerë të procesit.

Për nevoja të brendshme, AKK konsumon të dhëna përmes ueb-shërbimeve nga institucionet: ARBK, ARC dhe OJQ. Ndërkohë, me bankat, institucionet mikrofinanciare, ATK-në, noterët, ndërmjetësuesit dhe përmbaruesit realizohet shkëmbim i ndërsjellë i të dhënave. Një pjesë e këtyre shërbimeve ofrohen përmes platformës qeveritare të interoperabilitetit (GG).

Zbatimi i këtyre ueb-shërbimeve ka kontribuar në mënyrë të ndjeshme në rritjen e cilësisë, saktësisë dhe përditësimit të të dhënave kadastrale.

Numri i shënime të regjistruara nga Noterët sipas Komunave			
PRISHTINË	9,008	KAÇANIK	790
FERIZAJ	4,736	ISTOG	781
PRIZREN	4,126	RAHOVEC	779
GJILAN	3,711	SKËNDERAJ	758
FUSHË KOSOVË	3,515	MALISHEVË	696
PEJË	2,959	DEÇAN	660
GJAKOVË	2,277	OBILIQ	626
VUSHTRRI	1,664	SHTËRPCE	485
VITI	1,492	MAMUSHË	224
GRAÇANICË	1,423	DRAGASH	191
SUHAREKË	1,355	MITROVICË VERIORE	184
NOVOBËRDË	1,171	RANILLUG	175
LIPJAN	1,162	HANI I ELEZIT	106
GLLOGOC	1,051	ZVEÇAN	88
MITROVICË	1,040	JUNIK	84
KAMENICË	952	LEPOSAVIQ	84
SHTIME	922	PARTESHË	68
PODUJEVË	878	KLLOKOT	50
KLINË	793	ZUBIN POTOK	32

Statistika për numrin e lëndëve të regjistruara nëpërmjet sistemeve nga përdoruesit jashtëm

Statistikat në vendosjen e shënimit në njësi kadastrale nga noterët dhe përmbaruesit për periudhën Janar - Dhjetor 2025 janë :

- Njësi me shënim Transaksion janë 113633 (shih në tabelë statistika sipas komunave)
- Njësi me shënim për Hipotekë janë 5886
- Njësi me shënim përmbarimi janë 158

Statistikat për periudhën Janar-Dhjetor 2025 për konsumin e shërbimeve nga platforma Online(GUI forme) janë si në vijim:

- Gjeodetët Privat në sistemin online kanë krijuar 32040 lëndë
- Policia e Kosovës në sistemin online kanë krijuar 154 lëndë
- Departamenti i Tatimit në Pronë në sistemin online ka krijuar 425 lëndë

- AKP nga sistemi online ka shkarkuar të dhëna për 5,700 persona ose njësi
- Përmbaruesit nga sistemi online kanë shkarkuar të dhëna për 539 persona ose njësi
- Noterët nga sistemi online kanë shkarkuar të dhëna për 12,660 persona ose njësi
- ATK nga sistemi online ka shkarkuar të dhëna për 143 persona ose njësi
- AKP nga sistemi online ka shkarkuar të dhëna për 49 persona ose njësi
- Ibër Lepenc nga sistemi online ka shkarkuar të dhëna për 19 persona ose njësi
- Trepça nga sistemi online ka shkarkuar të dhëna për 471 persona ose njësi
- KEDS nga sistemi online ka shkarkuar të dhëna për 93 persona ose njësi
- Ndërmjetësuesit nga sistemi online kanë shkarkuar të dhëna për 6 persona ose njësi

Statistikat për periudhën Janar-Dhjetor 2025 përmes sistemit online dhe eKadastrit për lëndët e krijuara:

- Administrata Tatimore e Kosovës në sistemin online ka krijuar 697 lëndë
- Përmbaruesit në sistemin online kanë krijuar 5 lëndë
- Noterët në sistemin online kanë krijuar 2,530 lëndë

Statistikat për periudhën Janar-Dhjetor 2025 përmes sistemit online për regjistrimin, modifikimin, fshirjen e hipotekave si dhe barrës tatimore janë si në vijim:

- Lëndë 'Regjistrim i hipotekës' janë 4382 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Modifikim i hipotekës' janë 172 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Fshirje e hipotekës' janë 2814 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Regjistrim i barrës tatimore' janë 443 lëndë të aprovuara
- Lëndë 'Fshirje e barrës tatimore' janë 194 lëndë të aprovuara

13.3. Statistika nga DL

Drejtoria Ligjore (DL) në kuadër të punëve dhe angazhimeve për vitin 2025 ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave si shkallë e parë për Komunitet Veriore. Statistikat për këto lëndë janë paraqitur në tabelën si mëposhtë:

Si shkallë e parë (Komuna Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq)		Totali
Aprovim	Refuzim	
205	6	211

13.4. Statistika nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të ZKK-së

Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të ZKK-së ka kompetencë që të shqyrtojë ankesat kundër vendimeve të Zyrtarë Kadastrale Komuna (ZKK). Ankesa paraqitet përmes ZKK-së dhe dërgohet në AKK për shqyrtim nga Komisioni.

Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave është përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, që do të thotë se ka efekt ligjor pa pasur nevojë për veprime të tjera administrative brenda AKK-së për zbatimin e tij.

Vendimi i Komisionit mund të kundërshtohet në procedurë të konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, nëse pala e pakënaqur nuk pajtohet me vendimin e Komisionit.

Mëposhtë janë statistikat mbi numrin e ankesave që ka shqyrtuar ky Komision në vitin 2025:

Si shkallë e dytë Komision për shqyrtimin e ankesave						
Heshtje administrative	Njoftim-përgjigje në kërkesë/ankesë	Përgjigje në padi	Seanca	Pezullim i procedurës	Dërgim në kompetencë	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit juridik të kuvendeve komunale
30	322	82	30	15	20	30
529						


13.5. Statistika nga DK

Në kuadër të punëve dhe angazhimeve gjatë vitit 2025 Drejtoria e Kadastrit në AKK ka përpunuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave dhe lëndëve nga palë private dhe institucione publike. Statistikat janë paraqitur në tabelën si mëposhtë:

Institucioni	Numri i kërkesave
Agjencia Antikorrupsion	9
AMIK	33
AKI	2
AKP	2
ATK	2
Gjykata Kushtetuese	1
Gjykata Themelore Gjakovë	2
Gjykata Themelore Gjilan	2
Gjykata Themelore Mitrovicë	4
Gjykata Themelore Mitrovicë-dega Skënderaj	2
Gjykata Themelore Mitrovicë-dega Vushtrri	1
Gjykata Themelore Malishevë	1
Gjykata Themelore Prishtinë	12
Gjykata Themelore Prizren-dega në Suhareke	5
Prokuroria Themelore Prizren	1
Gjykata Themelore Pejë	1
KEK	1
Këshilli gjyqësor	1
Këshilli prokurorial	3
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1
OJQ-Organizata e Invalidëve të Punës së Kosovës	1
Policia	110
Posta e Kosovës	1
Gjykata Themelore në Kotorr-Mali i Zi	1
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	2
ILECU	24
Unifikimi i Emërtimeve të institucioneve-Trepça dhe Zirat Banka	2

13.6. Statistika nga Sistemi i Pozicionimit Satelitor në Kosovë – KOPOS

Rrjeti permanent i pozicionimit global në Republikën e Kosovës (KOPOS) mbulon tërë territorin e vendit në përcaktimin e pozitës me një saktësi centimetrike në rrafshin horizontal dhe vertikal, bazuar në sistemin zyrtar referent KosovaRef01. Përveç 8 stacioneve permanente të sistemit KOPOS, në rrjet janë inkorporuar dhe përpunohen GNSS të dhënat edhe nga 8 stacione të shteteve fqinje, Shqipëri 3 stacione Kukës-Peshkopi-Tropojë, Maqedoni e Veriut 3 stacione Kumanovë-Tetovë-Shkup dhe Mali i Zi 2 stacione Plavë-Rozhajë), andaj shfrytëzuesit pranojnë të dhëna të korrekta në kohë reale nga të gjitha 16 pikat e rrjetit të sistemit KOPOS.



Në vitin 2025 janë regjistruar 42 përdorues të rinj të shërbimeve të KOPOS-it. Gjatë vitit, shërbimet e KOPOS-it janë përdorur nga gjithsej 196 shfrytëzues. Përdorimi mesatar ditor i shërbimeve të KOPOS-it është rreth 95 orë në ditë dhe mesatarisht 2860 orë në muaj, ndërsa numri i shfrytëzuesve në baza ditore është rreth 115.



STATISTIKAT 2025		
Muaji	Orë të shfrytëzimit	Shfrytëzues
Janar	1439	128
Shkurt	2032	135
Mars	2326	152
Prill	3013	142
Maj	2965	156
Qershor	2622	158
Korrik	3808	161
Gusht	4460	165
Shtator	3946	155
Tetor	3051	151
Nëntor	2154	148
Dhjetor	2487	138
Gjithsejtë	34302	196

13.7. Statistika nga DFA

Sistemi i Faturimit është sistem i bazuar në UEB dhe bënë lëshimin e faturave tek palët (klientët) për pagesa .Gjithashtu tek aplikacioni Faturimi bëhet regjistrimi i faturave të paguara / dorëzuara nga palët e ku prej tij nxirren edhe raporte për pagesat dhe bëhen krahasime të vlerave në xhirollogari të AKK-së dhe faturave të regjistruara.

Datat baza e modulit faturimi në mënyre automatike bëhet backup një herë në javë.

- Gjatë vitit 2025 janë lëshuar 3,507 fatura të paguara.
- Gjatë vitit 2025 janë shitur 88,265 artikuj të ndryshëm
- Gjatë vitit 2025 janë 0 fatura të pa paguara

Sistemi i Faturimit ka qenë i qasshëm **99.99%** të kohës.



14

MARRËDHËNIE
ME PUBLIKUN
DHE GJITHËPËRFSHIRJE

14 MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE GJITHËPËRFSHIRJE

14.1. Intervistat në media

Gjatë vitit 2025, Agjencia Kadastrale e Kosovës realizoi një sërë intervistash me qëllim të pasqyrit të arritjeve, sfidave dhe objektivave të saj. Qëllimi kryesor i këtyre intervistave ishte ofrimi i një pasqyre të hollësishme mbi zhvillimet më të fundit në menaxhimin e pasurive të paluajtshme, përmirësimin e shërbimeve të ofruara, digjitalizimin e të gjitha shërbimeve kadastrale, si dhe diskutimin e sfidave dhe planeve për të ardhmen.


Këto intervista u strukturuan për të krijuar një platformë të hapur dhe transparente, përmes së cilës qytetarët, si dhe palët e interesuara mund të kuptonin deri në hollësi veprimtarinë e agjencisë dhe njëherit të merrnin informacione të sakta mbi zhvillimet më të fundit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Gjithashtu, përmes këtyre intervistave u siguroi një raportim i vazhdueshëm, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet relevante dhe qytetarët.

Viti 2025 nisi me një intervistë të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, dhënë për Telegrafin në formatin e podcastit. Gjatë kësaj interviste, z. Ahmeti prezantoi një pasqyrë të detajuar duke elaboruar projektet e realizuara dhe prioritetet strategjike të institucionit. Ndër temat kryesore të trajtuara ishte Ligji i ri për Kadastrin, i cili përbën një hap të rëndësishëm drejt unifikimit dhe standardizimit të procedurave pronësore dhe njëashtu u theksua misioni dhe vizioni institucional për vitin 2025, me fokus të veçantë në modernizimin dhe digjitalizimin e plotë të shërbimeve kadastrale.



Gjatë mesit të vitit 2025, Agjencia Kadastrale e Kosovës realizoi edhe një podcast tjetër, për të informuar hollësisht qytetarët mbi fillimin e projektit të rindërtimit të kadastrit si dhe digjitalizimin e shërbimeve kadastrale, duke shpjeguar përfitimet për qytetarë nga projekti i RIK, si dhe mënyrën se si qytetarët mund të përfitojnë nga digjitalizimi i shërbimeve kadastrale, njëherit nga një sistem më i lehtë dhe më i sigurt me synim të reduktimit të procedurave burokratike, lehtësimit, dhe përshpejtimin të marrjes së shërbimeve për qytetarë, duke modernizuar kështu tërësisht mënyrën e ofrimit të shërbimeve kadastrale.





Po ashtu, në një intervistë ekskluzive për emisionin “Five” në TV Dukagjini, drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës shpjegoi në hollësi projektin e Rindërtimit të Zonave Kadastrale, duke theksuar rëndësinë strategjike që ky projekt ka për rregullimin dhe modernizimin e të dhënave pronësore në Republikën e Kosovës. Me këtë rast, ai njoftoi se ishte përmbyllur procesi i informimit publik të qytetarëve për katër grupet e para të komunave të përfshira në projektin e Rindërtimit të Zonave Kadastrale.

Gjatë një periudhe njëmuajore, ekspertët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës kishin qenë të pranishëm në të gjitha zonat përkatëse, duke u ofruar qytetarëve informacione të plota dhe sqarime të detajuara lidhur me përfitimet, procedurat dhe rëndësinë e këtij projekti.


Drejtori theksoi se, pas përfundimit të fazës së informimit publik, ishte hapur mundësia që qytetarët e këtyre zonave të bëheshin pjesë aktive e projektit, duke adresuar dhe zgjidhur çështjet pronësore përmes formalizimit dhe regjistrimit të pronave në regjistrat kadastral, pa asnjë kosto financiare. Në fund, ai theksoi se projekti i Rindërtimit të Kadastrit kishte për qëllim rritjen e sigurisë juridike të pronës, përmirësimin e cilësisë së të dhënave kadastrale dhe rritjen e vlerës së pronës për qytetarët, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe institucional të vendit.



Viti 2025 u përmbyll me një intervistë të rëndësishme në emisionin “Radar”, të moderuar nga znj. Edita Doli, ku u trajtuan zhvillimet më të fundit dhe arritjet kryesore të Agjencisë Kadastrale të Kosovës gjatë këtij viti.

Gjatë intervistës, drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, foli në detaje për procesin e digjitalizimit të shërbimeve kadastrale, për përfitimet konkrete për qytetarët, si dhe për ndikimin e këtij transformimi në rritjen e transparencës, efikasitetit dhe qasjes së qytetarëve në shërbimet kadastrale.

Po ashtu, ai ritheksoi se viti 2025 u vlerësua si një vit historik për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku u dëshmuua përkushtimi, vizioni dhe puna profesionale e stafit të AKK-së gjithnjë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.



14.2. Uebfaqja zyrtare e AKK-së

Viti 2025 qenë vazhdimësi e një trendi të rritjes së jashtëzakonshme në aktivitetin dhe performancën e ueb faqes së Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), duke ofruar një mundësi të fuqishme për palët e interesuara të aksesojnë informacione dhe shërbime të ndryshme. Ueb faqja është një platformë kyçe për qasje në aplikacionet e ndryshme të AKK-së, si: **KCLIS tekstual, KCLIS grafik, Geoportal, Sistemi Informativ i Regjistrimit të Adresave (ARIS)**, statistikave ditore dhe modulet që do të zhvillohen në të ardhmen.

Gjatë vitit **2025**, ueb faqja ka ofruar një pasqyrë më të pasur dhe më të detajuar të aktiviteteve të AKK-së, me **202 lajme të publikuara, 28 shpallje, 2 Udhëzues dhe 4 Raporte të monitorimit**.

Po ashtu, janë realizuar konfigurime të reja në sistemin e menaxhimit të përmbajtjes (CMS), duke mundësuar një përvojë më të lehtë dhe më efikase për përdoruesit.

Një aspekt i veçantë i vitit **2025** ka qenë rritja e jashtëzakonshme e vizitave, me **710,495 shikime dhe 29,000 përdorues të rinj**, me totalin prej **58,000 përdoruesve**. Ky përmirësim i dukshëm i angazhimit dhe interaktivitetit të përdoruesve tregon një rritje të besueshmërisë dhe interesit të vazhdueshëm për shërbimet dhe informacionet që ofron Agjencia Kadastrale e Kosovës.

14.3. Profili zyrtar i AKK-së në Facebook

Marrë parasysh se mediat sociale kanë marrë një rol të jashtëzakonshëm në informimin e shpejtë dhe gjithëpërfshirës të qytetarëve, Agjencia Kadastrale e Kosovës si kanal kyç për komunikim dhe shpërndarje të informacionit e ka profilin e saj zyrtar në Facebook, si një nga platformat më të rëndësishme, që karakterizohet me lajme më të shpejta, më të sakta e kredibile lidhur me aktivitetet dhe zhvillimet në fushën e kadastrës. Në vitin 2025, ky profil ka pësuar një rritje të dukshme, duke pasqyruar angazhimin dhe transparencën e AKK-së në lidhje me punën dhe shërbimet që ofron.

Facebook-u i AKK-së në vitin **2025** ka arritur një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2024. Sot, profili numëron **6,600 ndjekës**. Pjesëmarrja dhe angazhimi i përdoruesve është rritur gjithashtu, duke regjistruar **2,400,000 shikime**.

Në vitin **2025** janë realizuar **202 postime**, dhe janë bërë **8,512 like dhe 244 share**. Ky progres tregon edhe punën e palodhshme e dinamike që po bëhet në AKK, por edhe angazhimin e rritur të qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Agjencia Kadastrale e Kosovës falënderon secilin nga ndjekësit për mbështetjen dhe besimin që kanë në institucionin tonë dhe është e angazhuar të vazhdojë me punë dhe transparencë të lartë edhe në të ardhmen.

Administrimi i e-mailit zyrtar "AKK"

- E-maila të dërguar: 1,403
- E-maila të pranuar: 2,132

14.4. Gjeoportali shtetëror

Në vitin 2025 është publikuar Gjeoportali i ri shtetëror i cili vetëm në orët e para të publikimit ka shënuar rekord të përdorimit dhe klikimeve. Mund të konstatojmë se gjatë këtij viti edhe Gjeoportali paraprak ka qenë i qasshëm dhe funksional për 99.8% të kohës, duke mos pasur asnjë problem të madh që do të pengonte funksionimin e tij normal.

Edhe gjatë këtij viti, fokusi kryesor ka qenë përditësimi i të dhënave ekzistuese që janë tashmë të publikuara në Gjeoportal. Risi ka qenë publikimi i pronarëve në Gjeoportal, duke rritur ndjeshëm interesimin e përdoruesve për sistem.

Në të njëjtën kohë, është vazhduar me publikimin e të dhënave të reja nga institucione të ndryshme ku gjatë këtij viti janë publikuar edhe shtresa të reja në Gjeoportal, duke pasuruar më tej përmbajtjen dhe funksionalitetin e tij.

Më poshtë është treguar numri i klikimeve për 3 muajt e fundit.

Gjeoportal	Klikime
Shtator 2025	67 mijë klikime
Tetor 2025	110 mijë klikime
Nëntor 2025	423 mijë klikime
Dhjetor 2025	466 mijë klikime
Janar 2026	300 mijë klikime

14.5. Barazia gjinore

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2025, ka miratuar Udhëzimin Administrativ 03/2025 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve. Ky Udhëzim Administrativ tashmë është në fuqi dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 17 mars 2025.

Ky Udhëzim Administrativ është produkt i bashkëpunimit të ndërsjellë mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Agjencisë për Barazi Gjinore dhe palëve të tjera të interesit, me qëllim të avancimit të drejtave të grave në shfrytëzimin e të drejtave pronësore. Aktualisht, numri total i grave pronare të pronës së paluajtshme në Republikën e Kosovës është rreth 21%.


Megjithatë, që nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi për herë të parë në vitin 2016, numri i grave pronare ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke reflektuar përparimin në fuqizimin ekonomik dhe pronësor të grave në Kosovë. Miratimi dhe zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të barazisë gjinore dhe mbështetjes së grave për të realizuar të drejtat e tyre pronësore. Statistikat për regjistrimin e bashkëshortëve si bashkëpronar nëpër vite është:



VITI	Nr. Femrave me të drejtën Pronësi/Posedim i Përbashkët
2021	3,042
2022	4,230
2023	5,104
2024	5,526
2025	5,717

14.6. Qasja në dokumente publike

Agjencia Kadastrale e Kosovës është ndër institucionet më transparente në vend. Ajo ka të vendosur kontaktin e personit që jep përgjigje në uebfaqen e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Këtë vit dhjetëra kërkesa për qasje në dokumente, që kryesisht vijnë nga mediat, OJQ-të dhe qytetarët, kanë marrë përgjigje në kërkesat e tyre specifike.



15

PËRKUJTIM

15 PËRKUJTIM

Këtë vit dy kolegë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës u larguan nga kjo botë në moshë të re duke lënë boshllëk e dhimbje për gjithë kolektivin e AKK-së. Mëposhtë janë dy shkrime në përkujtim të tyre.

Hasim Pacolli (1973-2025)



“Largimi yt nga kjo jetë është një humbje e madhe jo vetëm për familjen dhe miqtë e tu, por edhe për të gjithë ne kolegët që patëm fatin të të njohim dhe të punojmë me ty.

Hasimi ishte një njeri i qetë, i urtë dhe i përkushtuar, një shembull i vërtetë i profesionalizmit dhe i vlerave njerëzore.

Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës u punësua në vitin 2002. Që nga dita e parë ai shfaqti interesim të jashtëzakonshëm për profesionin e gjeodezisë. Gjatë rrugëtimit profesional kaloi pothuajse në të gjitha proceset dhe punët që u zhvilluan gjatë viteve në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku edhe u pajis me përvojë të mirë profesionale, e cila do t'i shërbej për ngritje cilësore në profesion dhe në punën e tij të mëtejme.

Nga viti 2010 deri në vitin 2015, ai ushtroi me përgjegjësi të lartë detyrën e Drejtorit të Drejtoratit të Matjes, duke udhëhequr procese të ndërlikuara me maturi, korrektësi dhe vizion. Pastaj ishte Udhëheqës i Sektorit për KOPOS, ku edhe një herë dëshmoi përkushtimin, seriozitetin dhe etikën e tij të punës. Hasimi se fundmi ushtroi detyrën e Drejtorit të Departamentit të Kadastrit, ku vendimet e tij ishin gjithmonë të balancuara, të drejta dhe në shërbim të interesit të përgjithshëm.

Hasimi dinte të dëgjonte, të këshillonte dhe të merrte përgjegjësi, por edhe në punët dhe diskutimet me presion dinte ta shtensiononte situatën me humorin e tij të hollë, duke fituar kështu respektin e kolegëve dhe bashkëpunëtorëve.

Për të, puna nuk ishte thjeshtë detyrë, por mision dhe shërbim ndaj institucionit dhe shoqërisë.

Mbi të gjitha, Hasimi ishte njeri i mirë, i thjeshtë, i dashur, gjithmonë i gatshëm të ndihmonte pa zhurmë dhe pa kërkuar lavdi. Fjala e tij ishte e matur, sjellja shembullore, ndërsa respekti për të tjerët ishte vlerë e pandashme e karakterit të tij.

Kujtimi për Hasimin do të mbetet i gjallë në zemrat tona, në historinë e institucionit ku ai shërbeu me ndershmëri dhe në shembullin që la pas për brezat e ardhshëm. Ai la gjurmë jo vetëm me punën e tij, por edhe me njerëzinë, dinjitetin dhe qetësinë që e karakterizonin.

Kujtimi për Hasimin do të jetoj gjithmonë mes nesh.

I shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes Pacolli, miqëve, shokëve dhe kolegëve. Urojmë që të gjejnë forcë dhe ngushëllim në kujtimet dhe në veprën e mirë që la pas.

Prehu në paqe Hasim Pacolli”

Luljeta Vuthi (1970-2025)



Luljeta Vuthi lindi në vitin 1970 dhe gjatë gjithë jetës së saj u dallua për përkushtim, integritet dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie ndaj punës dhe shoqërisë. Karriera e saj profesionale lidhet ngushtë me zhvillimin institucional dhe modernizimin e administrimit kadastral në Republikën e Kosovës, ku ajo dha kontribut të çmuar përmes angazhimit të saj në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK).

Gjatë viteve të shërbimit në AKK, Luljeta ishte e përfshirë në angazhime me rëndësi strategjike për institucionin. Kontributi i saj u reflektua veçanërisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes hartimit dhe zbatimit të planeve konkrete të trajnimeve, të orientuara drejt forcimit të sistemit kadastral, përmirësimit të administrimit të dhënave pronësore dhe avancimit të standardeve të shërbimeve transparente për qytetarët.

Puna e saj karakterizohej nga saktësia, korrektësia procedurale dhe përkushtimi për arritjen e rezultateve të qëndrueshme. Ajo ishte pjesë aktive e grupeve punuese dhe mekanizmave koordinues që synonin rritjen e transparencës, efikasitetit dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe institucionet publike.

Përtej kompetencës së saj profesionale, Luljeta Vuthi u vlerësua lart për cilësitë e saj njerëzore. Ajo ishte një bashkëpunëtorë e përkushtuar, me aftësi të theksuara komunikimi dhe me një qasje gjithmonë konstruktive ndaj sfidave profesionale. Në çdo angazhim ku ishte e përfshirë, ajo dëshmoi aftësi për të punuar në ekip, për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe për të promovuar frymën e respektit reciprok dhe solidaritetit profesional.

Agjencia Kadastrale e Kosovës do ta kujtojë gjithmonë me respekt dhe mirënjohje të thellë për kontributin e saj të çmuar në zhvillimin dhe forcimin e institucionit. Emri i saj mbetet pjesë e historisë institucionale si simbol i profesionalizmit, përkushtimit dhe humanizmit në shërbim publik.

Në këto çaste të vështira, shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes Vuthi, miqve, shokëve dhe të gjithë atyre që patën fatin ta kenë pjesë të jetës së tyre. Kujtimi për të do të mbetet i paharruar.

Prehu në paqe, Luljeta Vuthi.



16

**KALENDARI ME
NGJARJE TË NDRYSHME**

16 KALENDARI ME NGJARJE TË NDRYSHME**30.01.2025****Takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore**

Agjencia Kadastrale e Kosovës zhvilloi një takim pune me përfaqësuesit e Bankës Botërore, i cili takim kishte për qëllim shqyrtimin e progresit dhe koordinimin e hapave të mëtejme në kuadër të Projektit për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme dhe Infrastrukturën Gjeohapësinore (REGIP).

Takimi u mbajt nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, i cili, së bashku me udhëheqësin e Njesisë për Implementimin e Projektit (NJIP) të REGIP-it, z. Muzafer Qaka, priti delegacionin e lartë të Bankës Botërore. Delegacioni përbëhej nga z. Paul Prettitore, lider i ekipit; znj. Lindita Lepaja, koordinatore e portofolit; znj. Elena Corman, specialiste e lartë e prokurimit; dhe z. Kushtrim Plakolli, specialist i prokurimit.

Gjatë takimit u diskutua progresi i deritanishëm i Projektit REGIP dhe u theksua rëndësia e zgjatjes së afatit të implementimit të projektit, e cila kishte për qëllim sigurimin e realizimit të plotë dhe të suksesshëm të të gjitha aktiviteteve kyçe të planifikuara, përfshirë proceset e modernizimit dhe rindërtimit të kadastrit në 115 zona kadastrale.

Po ashtu, u shqyrtua Plani i Veprimit për fazën e ardhshme të projektit, duke u vlerësuar përputhshmëria e aktiviteteve me planifikimin e miratuar dhe me standardet më të larta profesionale dhe institucionale.

Takimi shërbeu për të riafirmuar bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Agjencisë Kadastrale e Kosovës dhe Bankës Botërore, bashkëpunim i cili kishte kontribuar në arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në funksion të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.



16 KALENDARI ME NGJARJE TË NDRYSHME**03.02.2025****Mbledhja e parë e menaxhmentit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës për vitin 2025**

Në fillim të muajit shkurt, Agjencia Kadastrale e Kosovës mbajti mbledhjen e parë të menaxhmentit për vitin 2025, e cila kishte për qëllim diskutimin e planifikimit vjetor, përcaktimin e objektivave kryesore institucionale, si dhe shqyrtimin e vazhdimin të implementimit të Projektit REGIP të mbështetur nga Banka Botërore.

Gjatë kësaj mbledhjeje u trajtuan çështje të rëndësishme strategjike, përfshirë orientimin e aktiviteteve drejt realizimit të projekteve kapitale, forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me institucione dhe partnerë relevantë, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kadastral në Republikën e Kosovës.

Kjo mbledhje shënoi fillimin e një viti pune me objektiva të qarta dhe me angazhim të shtuar institucional për përmbushjen e planeve të parapara dhe avancimin e shërbimeve kadastrale në vend.

**03.02.2025****Pranimi i një dhurate simbolike nga profesori i gjeodezisë, z. Skënder Tullumi**

Agjencia Kadastrale e Kosovës pranoi një dhuratë simbolike nga profesori i nderuar i gjeodezisë, z. Skënder Tullumi, e cila iu dedikua institucionit në shenjë falënderimi dhe vlerësimi për bashkëpunimin e ndërsjellë të deritanishëm.

Profesori z. Skënder Tullumi e nderoi Agjencinë Kadastrale e Kosovës me një punim të tij unik artistik, një orë të dedikuar posaçërisht për Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Ky veprim përfaqësoi një shprehje të veçantë respekti dhe mirënjohjeje ndaj institucionit dhe bashkëpunimit profesional të zhvilluar ndër vite.

Dhurata simbolizoi jo vetëm vlerësimin reciprok, por edhe lidhjen e qëndrueshme ndërmjet profesionistëve të fushës së gjeodezisë dhe Agjencisë Kadastrale e Kosovës. Ky gjest domethënës reflektoi përkushtimin e vazhdueshëm dhe kontributin e çmuar të profesorit z. Skënder Tullumi në fushën e gjeodezisë dhe të kadastrit.



07.02.2025**Procesi i unifikimit të pronave të paluajtshme të Trepça Sh.A.**

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) finalizoi me sukses procesin e unifikimit të pronave të paluajtshme të Trepça Sh.A., duke i dhënë fund një sfide shumëvjeçare në fushën e regjistrimit dhe konsolidimit të aseteve pronësore. Ky proces rezultoi në krijimin e një regjistri të plotë dhe të unifikuar të pronave të ndërmarrjes, duke mundësuar menaxhim më transparent, planifikim strategjik dhe hapjen e mundësive për investime të reja.

Në kuadër të këtij procesi, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, ia dorëzoi zyrtarisht certifikatat e pronësisë Drejtorit Ekzekutiv të Trepça Sh.A., z. Faton Ahmeti. Me këtë rast, u theksua se AKK do të vazhdonte angazhimin për regjistrimin e plotë të të gjitha aseteve pronësore të Trepça Sh.A., me qëllim të forcimit të bazës së saj ligjore dhe ekonomike.

Rezultatet kryesore të fazës së parë të procesit të unifikimit përfshinë regjistrimin dhe unifikimin e 2,133 pronave në emër të Trepça Sh.A., si dhe konsolidimin e një sipërfaqeje prej 12.6 km² tokë nën menaxhimin e ndërmarrjes.

**11.02.2025****Takim virtual ndërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe EuroGeographics për forcimin e bashkëpunimit në shpërndarjen e të dhënave hartografike**

Agjencia Kadastrale e Kosovës zhvilloi një takim virtual me përfaqësuesit e EuroGeographics, organizatë prestigjioze ndërkombëtare që përfaqëson autoritetet kombëtare të hartografisë, kadastrit dhe regjistrimit të tokës në Evropë. Takimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh dhe avancimin e shpërndarjes së të dhënave hartografike për Hartën Regjionale Evropiane (Euro Regional Map) dhe Hartën Evropiane të Kufijve (Euro Boundary Map).

Gjatë takimit u diskutuan mundësitë për përmirësimin e cilësisë, saktësisë dhe qasjes në të dhënat gjeohapësinore, të cilat shërbyen për planifikim hapësinor, zhvillim të qëndrueshëm dhe vendimmarrje në nivel rajonal dhe evropian. Ky bashkëpunim u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të të dhënave kombëtare me standardet evropiane. EuroGeographics, si organizatë e pavarur jofitimprurëse, përfaqëson një rrjet të gjerë prej 61 agjencish kombëtare të hartografisë dhe kadastrit nga 46 vende evropiane. Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila është anëtare e kësaj organizate që nga viti 2003, vazhdon të kontribuon në mënyrë aktive në zhvillimin dhe shpërndarjen e të dhënave hartografike të standardizuara, duke forcuar rolin dhe praninë e saj në arenën ndërkombëtare.



14.02.2025**Agjencia Kadastrale e Kosovës publikoi ortofotot e reja në Gjeoportalin Shtetëror**

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) publikoi ortofotot e reja në Gjeoportalin Shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgjegjësitë e saj institucionale në fushën e aero-fotografimit, krijimit të modeleve digjitale të terrenit dhe prodhimit të ortofotove.

Në kuadër të këtij procesi, AKK realizoi një projekt të ri të aero-fotografimit, i cili kishte për qëllim pasqyrimin e ndryshimeve të ndodhura në territorin e Republikës së Kosovës gjatë periudhës 2018–2024. Ky projekt u planifikua dhe u zbatua duke marrë parasysh faktin se aero-fotografimi i fundit në nivel shtetëror ishte realizuar në vitin 2018 dhe se gjatë viteve pasuese ishin evidentuar ndryshime të konsiderueshme hapësinore dhe infrastrukturore.

Si rezultat i këtij projekti, në Gjeoportalin Shtetëror u publikuan ortofotot për zonat urbane me rezolucion prej 8 cm, të cilat ofruan një pamje të detajuar dhe të saktë të këtyre zonave. Njëkohësisht, AKK vazhdoi procesin e publikimit të ortofotove për zonat rurale me rezolucion prej 15 cm, me qëllim të sigurimit të një pasqyrimi të plotë dhe gjithëpërfshirës të territorit të Republikës së Kosovës.

Publikimi i ortofotove kontribuoi në përmirësimin e qasjes në të dhëna gjeohapësinore të përditësuara dhe cilësore, duke mbështetur planifikimin hapësinor, zhvillimin ekonomik, menaxhimin e territorit dhe nevojat e institucioneve publike dhe të qytetarëve.

Për më shumë informacione, të dhënat janë vënë në dispozicion përmes Gjeoportalit Shtetëror: <https://geoportal.rks-gov.net/>

**05.03.2025****Takim ndërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Bankës Botërore për avancimin e projektit të Rindërtimit të Kadastrit**

Agjencia Kadastrale e Kosovës zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore, të udhëhequr nga znj. Isolina Rossi, Ekonomiste dhe Drejtuese e Ekipit të Punës, si dhe z. Besart Myderrizi, Specialist i Zhvillimit të Sektorit Privat. Takimi kishte për qëllim shqyrtimin e progresit të zbatimit të Ligjit për Kadastrin dhe diskutimin e përgatitjeve për implementimin e projektit të Rindërtimit të Kadastrit në 115 zona kadastrale.

Gjatë këtij takimi, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, informoi të pranishmit mbi avancimin e aktiviteteve të zbatimit të Ligjit për Kadastrin, duke përfshirë edhe aktet nënligjore që mbështesin këtë proces. Palët diskutuan gjithashtu për hapat e nevojshëm për nisjen e implementimit të projektit, duke vlerësuar progresin e bërë deri më tani dhe nevojën për koordinim të mëtejshëm në fazat operacionale.

Takimi shënoi riafirmimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Bankës Botërore, në kuadër të reformave të rëndësishme në fushën e kadastrit, të cilat pritet të sjellin përfitime afatgjata për qytetarët dhe të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve kadastrale në vend.



11.03.2025

Publikimi i adresave zyrtare të Kosovës në Google Maps

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) finalizoi procesin e integritit të adresave zyrtare dhe kodeve postare të Kosovës në platformën Google Maps, duke siguruar aprovimin zyrtar dhe duke e bërë këtë informacion të disponueshëm për publikun brenda pak javëve pas finalizimit. Ky veprim kishte për qëllim lehtësimin e qasjes së qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve në shërbime publike dhe private, duke krijuar një sistem më të saktë, të besueshëm dhe funksional të adresave.

Në kuadër të këtij procesi, AKK punoi intensivisht për finalizimin e Sistemit të Adresave Zyrtare, duke siguruar që të dhënat të jenë të qasshme për të gjithë përdoruesit. Bashkëpunimi me Google Maps përfshiu përfshirjen e adresave të sakta në platformën ndërkombëtare të navigimit, duke garantuar që çdo vendndodhje në Republikën e Kosovës të jetë e lokalizueshme dhe e identifikueshme me saktësi.

Publikimi i adresave zyrtare në Google Maps kontribuoi në përmirësimin e lidhjes së qytetarit me adresën e tij zyrtar, eliminoi pasaktësitë dhe lehtësoi procesin e navigimit dhe të planifikimit urban dhe logjistik brenda vendit.



14.03.2025

Agjencia Kadastrale e Kosovës vazhdoi implementimin e Projektit REGIP të Bankës Botërore

Në kuadër të një bashkëpunimi të shkëlqyer dhe rezultateve konkrete të arritura, përfshirë këtu finalizimin e 11 projekteve, Agjencia Kadastrale e Kosovës mori dritën e gjelbër për vazhdimin e mëtutjeshëm të projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore (REGIP). Ky hap shënoi fillimin e një viti me ambicie të qarta për realizimin e projekteve kapitale dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit në vendin tonë.

Zgjatja e afatit të implementimit të Projektit ka rëndësi të veçantë për realizimin e aktiviteteve kyçe të projektit, me fokus në aktivitetet që janë pjesë e Planit Zhvillimor Kombëtar. Si pjesë e rëndësishme e planit të paraparë për këtë vit, ishte edhe modernizimi dhe rindërtimi i kadastrit në 115 zona kadastrale. Implementimi i projekteve kapitale dhe realizimi i objektivave të (AKK)-së, ka vazhduar të sjellë rezultate të prekshme për qytetarët tanë, njashtu rezultate konkrete në modernizimin e kadastrit, përkritazi digjitalizimin e të gjitha shërbimeve kadastrale.



18.04.2025**Agjencia Kadastrale e Kosovës publikoi ortofotot e reja për zonat rurale në Gjeoportalin Shtetëror**

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) realizoi publikimin e ortofotove të reja në Gjeoportalin Shtetëror për zonat rurale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgjegjësitë e saj institucionale në fushën e aero-fotografimit, krijimit të modeleve digjitale të terrenit dhe prodhimit të ortofotove.

Si rezultat i këtij projekti, në Gjeoportalin Shtetëror u publikuan ortofotot për zonat rurale me rezolucion prej 15 cm, të cilat ofruan një pamje të detajuar dhe të saktë të këtyre zonave, me qëllim të sigurimit të një pasqyrimi të plotë dhe gjithëpërfshirës të territorit të Republikës së Kosovës.

Publikimi i ortofotove kontribuoi në përmirësimin e qasjes në të dhëna gjeohapësinore të përditësuara dhe cilësore, duke mbështetur planifikimin hapësinor, zhvillimin ekonomik, menaxhimin e territorit dhe nevojat e institucioneve publike dhe të qytetarëve.

Për më shumë informacione, të dhënat janë vënë në dispozicion përmes Gjeoportalit Shtetëror: <https://geoportal.rks-gov.net/>

**06.05.2025****Trajnim mbi aplikimin e fotogrametrisë për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit / Dega e Gjeodezisë**

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) zhvilloi një trajnim të veçantë për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit / Dega e Gjeodezisë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet akademisë dhe institucioneve shtetërore, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të studentëve për t'u përgatitur për tregun e punës.

Në hapje të trajnimit, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, përshëndeti studentët dhe ndau përvojën e tij si student, duke vënë në pah sfidat dhe avancimet e arritura gjatë viteve në fushën e teknologjisë dhe metodologjive të punës.

Gjatë trajnimit, studentët u njohën me teknikat më të avancuara të fotogrametrisë dhe mënyrat praktike të zbatimit të tyre në aktivitetet e përditshme të AKK-së, përmes prezantimit gjithëpërfshirës të realizuar nga z. Avni Rustemi.

Ky trajnim dëshmoi përkushtimin e përbashkët të universiteteve dhe institucioneve publike për ndërtimin e një infrastrukture moderne dhe efikase të kadastrit në Kosovë.






08.05.2025

Digjitalizimi i Shkëmbimit të së Dhënave midis Noterisë dhe Kadastrit

Në një takim të frytshëm me Odën e Noterisë së Kosovës, në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, u diskutuan deri në imtësi dhe u elaboruan në çdo aspekt perspektivat dhe mundësitë për avancimin e bashkëpunimit në shkëmbimin e të dhënave në kohë reale ndërmjet zyreve noteriale dhe zyreve kadastrale komunale.

Ky partneritet ka dëshmuar një harmonizim të shkëlqyer, ndërsa synimi i përbashkët ishte që ky bashkëpunim i ndërsjellë të ngrihet në një nivel të ri të digjitalizimit dhe efikasitetit, me synimin që zyret noteriale të kenë mundësinë për të dorëzuar dosjet e plota, përfshirë aktet noteriale dhe dokumentacionin shoqërues, në formë digjitale drejt ZKK-ve, duke eliminuar kështu nevojën që palët të dorëzojnë fizikisht dokumentet në sportelet kadastrale.




14.05.2025**Kompletimi i Sistemit të Adresave dhe Projektet Strategjike në Katër Komunat Veriore të Republikës së Kosovës**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) u zhvillua një takim i rëndësishëm ndërmjet zyrtarëve të AKK-së, si dhe kryetarëve të komunave veriore: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Ky takim shënoi një hap vendimtar drejt kompletimit të Sistemit të Adresave në këto komuna, një proces thelbësor për përmirësimin e shërbimeve publike.

Në fjalën hyrëse, Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, fillimisht falënderoi kryetarët e komunave për bashkëpunimin e ndërsjellë, njëherit theksoi rëndësinë strategjike të kësaj nisme të rëndësishme për kompletimin e sistemit të adresave, integrimin administrativ dhe zhvillimin urban të komunave veriore, duke shprehur gatishmërinë e plotë të AKK-së për të ofruar mbështetje të pakushtëzuar gjatë gjithë këtij procesi.

Gjatë takimit, ekspertët e AKK-së prezantuan arritjet e deritanishme të Sistemit të Adresave në nivel kombëtar, duke veçuar qartësinë që ai sjell në identifikimin e pronave dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike. Njëkohësisht, u diskutuan detyrat konkrete që i takojnë komunave për finalizimin e këtij procesi, ku theksi u vendos te krijimi i komisioneve përkatëse për emërtimin dhe numerizimin e rrugëve. Përfaqësuesit komunalë shprehën angazhimin e tyre të plotë për realizimin e këtyre detyrave, duke u zotuar për themelimin e komisioneve brenda afateve të përcaktuara.

Përveç Sistemit të Adresave, pjesë e diskutimit ishin edhe projekte të tjera strategjike, si renovimi i Zyrave Kadastrale Komunale dhe krijimi i një Regjistri të Ndërtesave, projekte këto që pritet të rrisin cilësinë dhe transparencën e shërbimeve për qytetarët. Ky takim dëshmoi vendosmërinë e përbashkët për t'i sjellë komunat në veri në një stad të ri të zhvillimit urban dhe administrativ, duke siguruar një të ardhme më të rregullt dhe më të qasshme për të gjithë banorët.



20.05.2025**Takim me KEDS për bashkëpunim në shkëmbimin e të dhënave ndërinstitucionale**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), u zhvillua një takim me përfaqësuesit e KEDS-it, i cili kishte për qëllim diskutimin e fillimit të bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave dhe të dhënave ndërinstitucionale.

Gjatë takimit, palët u fokusuan në çështje kyçe lidhur me shkëmbimin e të dhënave për adresat zyrtare të qytetarëve, duke diskutuar vendosjen e adresave të sakta në faturat e energjisë elektrike për të garantuar përdorimin e të dhënave zyrtare dhe përmirësimin e cilësisë së informacionit për konsumatorët.

U trajtua gjithashtu qasja e KEDS-it në të dhënat kadastrale, e cila synonte verifikimin e saktë të njësive kadastrale dhe përcaktimin e statusit të pronave si publike ose private, duke përmirësuar planifikimin dhe menaxhimin e rrjetit të energjisë.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimit ishte edhe shkëmbimi i të dhënave për përçojat, ku u shqyrtuan specifikimet teknike, atributet e të dhënave dhe nevoja për mirëmbajtje të rregullt dhe të koordinuar në bashkëpunim me AKK-në.

**23.05.2025****Agjencia Kadastrale e Kosovës zhvilloi takim me Odën e Përmbauesve të Kosovës për thellimin e bashkëpunimit digjital**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Odës së Përmbauesve të Kosovës, i cili kishte për qëllim diskutimin e mundësive konkrete për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për avancimin e shkëmbimit digjital të të dhënave në kohë reale ndërmjet Zyrave Kadastrale Komunale dhe Zyrave të Përmbauesve.

Gjatë takimit u vlerësua bashkëpunimi i deritashëm ndërmjet këtyre dy institucioneve, i cili është dëshmuar si funksional dhe efikas, dhe u diskutua kalimi në një fazë më të avancuar të digjitalizimit të plotë të procedurave.

U vendos që zyrat përmbaimore të pajiseshin me të drejtën e dërgimit elektronik të plotë të dosjes përmbaimore, përfshirë urdhërin përmbaimor dhe të gjitha dokumentet përcjellëse. Kjo nismë do të eliminonte nevojën për paraqitje fizike të kërkesave për vendosje apo heqje të urdhrave në ZKK, duke e zhvilluar procesin në mënyrë të sigurt dhe të automatizuar nga zyra e përmbauesit.

Ky proces kishte për qëllim shkurtimin e kohës së procesimit të lëndëve, rritjen e cilësisë dhe integritetit të të dhënave, sigurimin e komunikimit të pandërprerë në kohë reale dhe respektimin e radhës. Iniciativa u konsiderua një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një administrate më efikase, më transparente dhe tërësisht të digjitalizuar.



24.06.2025**Takim me Odën e Inxhinierëve për forcimin e bashkëpunimit profesional**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Odës së Inxhinierëve, i cili kishte për qëllim forcimin e lidhjeve profesionale ndërmjet fushës së inxhinierisë dhe kadastrit.

Gjatë takimit u diskutuan mundësitë për nënshkrimin e një memorandumit bashkëpunimi ndërmjet AKK-së dhe Odës së Inxhinierëve, si dhe roli i gjeodetëve në projekte ndërtimore dhe inxhinierike.

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, prezantoi punën e përkushtuar të agjencisë, aktivitetet dhe projektet inovative të realizuara, duke theksuar se ky takim përfaqësonte një hap strategjik drejt forcimit të rrjetit profesional dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet kadastrit dhe inxhinierisë.

Ai gjithashtu vuri në pah vizionin e përbashkët, i cili synon të shërbejë si motor rritjeje për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve përkatës.

**25.06.2025****Takim Zyrtar me Përfaqësuesit e Postës së Kosovës**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Drejtori Ekzekutiv, z. Avni Ahmeti, zhvilloi një takim zyrtar me Kryeshefen Ekzekutive të Postës së Kosovës, znj. Nora Rraci, e cila ishte e shoqëruar nga bashkëpunëtorët e saj.

Tema kryesore e takimit ishte nevoja emergjente për qasje në të dhënat e Regjistrit të Adresave, me qëllim të saktësisimit, unifikimit dhe ndërlidhjes së të dhënave të adresave me sistemet postare të Postës së Kosovës.

Gjatë takimit, Drejtori Ahmeti theksoi përkushtimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës për bashkëpunim të ngushtë me Postën e Kosovës në këtë proces me rëndësi të veçantë, duke vënë theksin në ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare, zhvillimin e një aplikacioni mobil për adresa, si dhe në projekte të tjera që pritej të nisin në të ardhmen e afërt.

Po ashtu, u diskutua edhe çështja e unifikimit të emërtimeve të pronave të Postës së Kosovës, përmes një emërtimi të vetëm, unik dhe të saktë, i cili do të aplikohet në të gjitha pronat e kësaj ndërmarrjeje në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Nga ana e saj, znj. Rraci konfirmoi gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë ndërinstytucional, me qëllim të realizimit të përbashkët të objektivave dhe lehtësimit të shërbimeve për qytetarët.



01.07.2025

U Publikua Numri i Ri i Gazetës së Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Më 1 gusht 2026 u publikua numri i ri i gazetës periodike të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Agjencia Kadastrale e Kosovës kishte zhvilluar një sërë aktivitete, duke zbatuar projekte të rëndësishme, duke realizuar aktivitete të shumta në terren, si dhe duke forcuar bashkëpunimet ndërinstitucionale, të cilat kishin rezultuar me arritje konkrete.

Gazeta periodike përmbledhë të gjitha zhvillimet më të rëndësishme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës për periudhën Janar - Qershor, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të punës institucionale të realizuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, rrjedhimisht duke e afruar qytetarin me aktivitetet dhe rezultatet e AKK-së.



10.07.2025

AKK pjesë e Konferencës përmbyllëse të BIRN Kosova për trajnimet e akterëve të çështjeve pronësore

Në kuadër të përmbylljes së aktiviteteve të trajnimeve dhe punëtorive të zhvilluara me zyrtarët kadastralë, noterët, avokatët, përmbaruesit dhe ndërmjetësuesit – në kuadër të projektit të Bankës Botërore PIAKOS – BIRN Kosova organizoi Konferencë përmbyllëse, ku u diskutuan gjetjet kryesore dhe rekomandimet nga të gjitha sesionet e realizuara me këta akterë.

Pjesëmarrës përveç AKK-së ishin edhe përfaqësues nga:

- Oda e Noterëve
- Oda e Ndërmjetësuesve
- Oda e Përmbaruesve
- Avokatë
- Gjyqtarë
- Zyrtarë nga Zyret Kadastrale Komunale

Drenushë Januzi Kukaj nga Agjencia Kadastrale e Kosovës theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit të mirëfilltë ndërinstitucional për të arritur qëllimin e përbashkët: ofrimin e shërbimeve cilësore kadastrale për të gjithë qytetarët.

Ajo theksoi gjithashtu se AKK-ja, krahas reformave në kornizën ligjore – me Ligjin e ri dhe 11 Udhëzimet Administrative – ka publikuar së fundmi edhe dy Udhëzues pune: për Matje dhe për Rindërtimin e kadastrit.

AKK vlerësoi lartë gjetjet dhe rekomandimet e dala nga këto takime, si dhe diskutimet e frytshme që do të shërbejnë si bazë për reforma dhe avancime të mëtejshme në fushën kadastrale në të ardhmen.



25.08.2025

Takimi Virtual për Projektin e Rindërtimit të Kadastrit dhe Kontrollin e Kualitetit

Një takim virtual ndërmjet përfaqësuesve të Agjencisë Kadastrale e Kosovës, Bankës Botërore dhe Operatorëve Ekonomikë është mbajtur lidhur me projektin e Rindërtimit të Kadastrit dhe kontrollin e kualitetit të tij.

Gjatë këtij takimi u diskutua progresi i deritanishëm i zbatimit të projektit, si dhe u shtjelluan mënyrat për tejkalimin e sfidave të hasura gjatë implementimit, me qëllim që projekti të përfundonte me sukses të plotë dhe në përputhje me standardet e përcaktuara.

Ky bashkëveprim i vazhdueshëm ndërmjet palëve dëshmoi përkushtimin dhe mirëbesimin e ndërsjellë, si dhe vullnetin e përbashkët për të siguruar rezultate konkrete dhe afatgjata në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës. U theksua se takime të tilla do të vazhdonin edhe në të ardhmen, me synimin e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe garantimit të cilësisë në zbatimin e projekteve kadastrale.



25.08.2025

Takimi i Grupit Teknik të Ekspertëve në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për Analizimin e Çështjeve të Komacsonit të Tokave Bujqësore

Është mbajtur takimi i Grupit Teknik të Ekspertëve në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me qëllim të analizimit të problemeve të ndërlidhura me komacsonin e tokave bujqësore, me theks të veçantë në komacsonin e papërfunduar të viteve '80.

Takimi është zhvilluar në një atmosferë konstruktive dhe profesionale, duke shërbyer si platformë për koordinim ndërinstitucional dhe për shkëmbim të thelluar të njohurive profesionale ndërmjet akterëve relevantë, lidhur me avancimin e procesit të komacsonit.

Gjatë takimit janë nxjerrë konkluzione me rëndësi për përcaktimin e hapave të ardhshëm, ndërsa është theksuar domosdoshmëria e konsolidimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, si parakusht thelbësor për arritjen e rezultateve konkrete dhe të qëndrueshme në këtë fushë.

Në takim kanë marrë pjesë përfaqësues nga komunat dhe institucionet përkatëse, përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Programi i takimit ka përfshirë fjalën hyrëse nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, prezantimin e politikave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga z. Idriz Gashi, Shef i Divizionit për Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore, prezantimet e anëtarëve të Grupit Teknik lidhur me gjendjen aktuale dhe dokumentacionin për komacsonin e papërfunduar të viteve '80, si dhe konkluzionet përfundimtare dhe mbylljen e takimit.



15.09.2025

Republika e Kosovës Përfundon Sistemin e Adresave

Pas disa vitesh pune dhe përkushtimi të vazhdueshëm, mes sfidave të shumta, Agjencia Kadastrale e Kosovës, në bashkëpunim me komunat, arriti me sukses që për herë të parë në Republikën e Kosovës, të gjitha komunat t'i emërtuan rrugët në përputhje me ligjet në fuqi.

Me mbështetjen dhe koordinimin e këtij institucioni, komunat e Novobërdës, Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut përfunduan këtë proces të rëndësishëm, i cili shënoi kompletimin e Sistemit të Adresave në të gjithë vendin. Ky përfundim përmirësoi qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve publike, lokalizimin e adresave dhe sistemet e navigimit.

Digjitalizimi i emërtimeve të rrugëve në Sistemin e Adresave (ARIS) përfundoi, ndërsa u realizua edhe procesi i digjitalizimit të shenjave dhe numrave të objekteve, duke sjellë standarde më moderne dhe të qëndrueshme për të gjithë qytetarët. Kjo arritje historike shënoi një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi adresash të organizuar dhe funksional për të gjithë qytetarët dhe kontribuoi në përmbushjen e një prej parakushteve për integrim evropian.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Catastral Agency

REPUBLIKA E KOSOVËS PËRMBYLL SISTEMIN E ADRESAVE ME EMRA TË RRUGËVE

Për herë të parë në histori

Të gjitha komunat e Kosovës kanë emërtuar rrugët e tyre sipas ligjeve të Republikës.

Digjitalizimi në sistemin ARIS

- ☒ Emrat e rrugëve janë futur në sistemin e adresave.
- ☒ Në proces: shenjat dhe numrat e objekteve.

23.09.2025

Delegacioni i Bankës Botërore Vizitoi Agjencinë Kadastrale të Kosovës për Projektin REGIP

Delegacioni i Bankës Botërore, nën drejtimin e z. Caleb Travis Johnson, zhvilloi një vizitë treditore në Kosovë, gjatë së cilës vizitoi Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) për të njohur nga afër dhe për të diskutuar në tërësi ecurinë e Projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe Infrastrukturën Gjeohapësinore (REGIP).

Gjatë takimit u konkretizuan prioritetet për vitin 2025, u evidentuan sfidat kyçe dhe u riafirmua mbështetja e Bankës Botërore për përmbylljen e projektit në vitin 2026. Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Avni Ahmeti, prezantoi të gjitha arritjet dhe rezultatet e deritanishme, duke përfshirë përmbylljen e 13 projekteve madhore dhe sukseset e vazhdueshme në iniciativat kyçe që po transformonin kadastrin dhe qasjen e qytetarëve në shërbime moderne.

Ai veçoi progresin domethënës të projekteve në vijimësi, përfshirë Rindërtimin e Kadastrit, zhvillimin e Gjeoportalit (NSDI dhe Gjeoportali Shtetëror), Ndërlidhjen e Qytetarit me Adresë Zyrtare dhe avancimin e sistemeve kadastrale, të cilat po realizoheshin me ritme të qëndrueshme, duke gjeneruar rezultate të matshme dhe ndikim të prekshëm në terren.

Përfaqësuesit e Bankës Botërore vlerësuan ritmin dhe efektivitetin e implementimit dhe konfirmuan mbështetjen e mëtejshme, ndërsa AKK rikonfirmoi përkushtimin për të përfunduar këtë proces transformues. Vizita dëshmoi suksesin e partneritetit strategjik ndërmjet AKK-së dhe Bankës Botërore në konsolidimin e projekteve kadastrale dhe zhvillimin e infrastrukturës gjeohapësinore në Republikën e Kosovës.



26.09.2025**Republika e Kosovës Vendosi në Funksion Sistemin e Ri të Adresave**

Pas disa muajsh pune dhe angazhimi të vazhdueshëm të stafit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në bashkëpunim me kompaninë zhvilluese, u vu në funksion Sistemi i ri i Adresave të Republikës së Kosovës (ARIS).

Ky sistem u zhvillua me teknologjinë më të fundit dhe me një infrastrukturë të përmirësuar, e cila ofroi stabilitet, siguri dhe performancë të lartë për të gjitha shërbimet që lidhen me adresat.

Me mbi 100 përdorues aktivë, të cilët siguruan menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të të dhënave, ARIS-i menaxhoi:

- **23,594 rrugë (emra rrugësh)**
- **561,874 pika të adresave**
- **46,498 shenja të emrave të rrugëve**

Ky hap përfaqësoi një avancim të rëndësishëm të ndërmarrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në drejtim të modernizimit të sistemeve dhe shërbimeve, duke krijuar një platformë të besueshme për institucionet dhe shërbimin e qytetarëve.

ARIS-i ishte gjithashtu sistemi i parë që u implementua në kuadër të projektit për Avancimin e Sistemeve Kadastrale, pjesë e të cilit përbëjnë edhe sisteme të tjera që pritej të publikoheshin së shpejti.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Catastral Agency

Agjencia Kadastrale e Kosovës lanson
Sistemin e ri të Adresave të Kosovës

30.09.2025**Takimi Ndërmjet Ekspertëve të AKK-së dhe Noterëve për Zhvillimin e Sistemeve Digjitale**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës u mbajt takimi i radhës ndërmjet ekspertëve të AKK-së dhe noterëve, në kuadër të procesit të zhvillimit të sistemeve digjitale.

Gjatë këtij takimi, O.E. prezantoi versionin e parë të sistemit të ri, i cili është parashikuar të përdoret nga institucionet publike dhe private. Ky sistem synon të lehtëson ndjeshëm procedurat, nga momenti i marrjes së të dhënave deri te përpunimi i tyre, duke mundësuar gjithashtu komunikim në kohë reale me zyrat kadastrale. Të gjitha aktet noteriale do të përpunohen fillimisht nga noterët dhe më pas do trajtohen nga zyrtarët e ZKK-ve, duke rritur efikasitetin dhe transparencën e procesit.

U parashikua që takime të tjera gjithëpërfshirëse me noterë dhe akterë të tjerë relevant të mbahen për përdorimin e sistemit të ri. Ky vit shënoi një hap vendimtar drejt digjitalizimit të shërbimeve kadastrale, duke krijuar bazat për një të ardhme më efikase, më transparente dhe më të qasshme për qytetarët dhe institucionet. Agjencia Kadastrale e Kosovës rikonfirmoi përkushtimin e saj për ta bërë digjitalizimin një realitet të prekshëm për çdo shërbim, në partneritet me të gjitha palët e interesit.



16.10.2025**Takim me Presidentin e Shoqatës Ndërkombëtare të Hartografisë, Prof. Dr. Georg Gartner**

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) priti në takim profesorin e njohur të hartografisë dhe presidentin e Shoqatës Ndërkombëtare të Hartografisë (ICA), Prof. Dr. Georg Gartner, nga Universiteti i Teknologjisë së Vienës (TU Wien).

Gjatë takimit u diskutuan zhvillimet më të fundit në fushën e hartografisë moderne dhe të teknologjive GIS, si dhe mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet AKK-së dhe institucioneve akademike ndërkombëtare.

Profesori Gartner, autoritet i njohur në fushën e hartografisë, erdhi në Kosovë për një vizitë akademike, njëherit për të bashkëpunuar me ekspertë të gjeoinformacionit. Përfaqësuesit e AKK-së e njoftuan profesorin Gartner për projektet aktuale të Agjencisë, me fokus në digjitalizimin e shërbimeve dhe të dhënave gjeohapësinore, si dhe në avancimin e Gjeoportalit, si pjesë e modernizimit të sistemit kadastral në Kosovë.

**17.10.2025****Takime Intensive të AKK-së Pak Ditë Para Lansimit të Sistemeve të Reja Kadastrale**

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, drejtori ekzekutiv, z. Avni Ahmeti, priti kryetarin e Odës së Noterisë së Kosovës, z. Shpend Haskaj.

Ky takim u zhvillua në kuadër të intensifikimit të punës dhe angazhimit të javëve të fundit për përmbylljen e projektit "Zhvillimi dhe Avancimi i Sistemeve të Informacioneve Kadastrale".

Gjatë takimit u zhvillua një diskutim mbi mundësitë dhe perspektivat për përf forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në shkëmbimin e të dhënave në kohë reale midis Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK) dhe zyrave noteriale, përkatësisht për azhurnimin e të dhënave të aktit noterial në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (RDPP) nga vetë noterët.



20.10.2025

Takim Pune në Agjencinë Kadastrale të Kosovës me Përfaqësues të Zyrës për Administrimin e Pronës Publike nga ZKM

Në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës u mbajt një takim pune me përfaqësues nga Zyra për Administrimin e Pronës Publike (ZAPP), që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Gjatë takimit u theksua rëndësia e koordinimit të institucioneve përkatëse për një administrim më efikas dhe transparent të pronës publike.

Diskutimet u përqendruan në përmirësimin e proceseve të identifikimit dhe regjistrimit të parcelave të tokës, si dhe në forcimin e partneritetit ndërmjet AKK-së dhe ZAPP-it. Ky bashkëpunim vie si rrjedhojë e krijimit të një sistemi më të qëndrueshëm dhe të qartë për menaxhimin e të dhënave kadastrale dhe pronësore.



26.10.2025

Ekspeditë Njëditore e Stafit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Parkun e Blinajës

Stafi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës kaloi një ditë në Parkun e Blinajës, për të shijuar ajrin e pastër, qetësinë dhe gjallërinë që natyra ofron. Gjatë kësaj ekspedite, stafi u angazhua në aktivitete që nxisin bashkëpunimin dhe frymën ekipore, duke përforcuar marrëdhëniet profesionale dhe personale mes kolegëve.

Përtej angazhimeve të përditshme profesionale, kjo ditë u shfrytëzua për të forcuar miqësinë, mirëkuptimin dhe harmoninë brenda ekipit, si elemente thelbësorë për një organizatë funksionale dhe të suksesshme.



05.11.2025

Takim me Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, priti në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës.

Tema kryesore e takimit ishte zhvillimi i modulit të ri për gjeodetë përmes sistemeve digjitale kadastrale, me qëllim të lehtësimit dhe avancimit të punës profesionale të gjeodetëve.

Gjatë takimit u diskutuan edhe çështje të tjera që lidhen drejtpërdrejt me profesionin e gjeodetit, me theks të veçantë mbi bashkëpunimin e mëtijshëm ndërmjet AKK-së dhe Shoqatës për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e shërbimeve në fushë e gjeodezisë.



06.11.2025


Delegacioni i FMN-së Viziton Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, z. Avni Ahmeti, priti në takim delegacionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Në përbërje të delegacionit ishin z. David Amaglobeli, Shef i Misionit të FMN-së për Kosovën, z. Phakaëa Jeasakul, Senior Ekonomist në Departamentin Evropian, znj. Ana Lariau, Ekonomiste në të njëjtin departament, dhe z. Selim Thaçi, Ekonomist në Zyrën e Përfaqësuesit Rezident në Kosovë.

Gjatë takimit, Drejtori Ahmeti i njoftoi përfaqësuesit e FMN-së mbi zhvillimet e fundit në Agjenci, me theks të veçantë në digjitalizimin e plotë të sistemeve dhe shërbimeve kadastrale. Ai bëri të ditur se shumë shpejt të gjitha shërbimet kadastrale do të jenë plotësisht të qasshme në formë digjitale, duke eliminuar nevojën për paraqitjen fizike të qytetarëve në sportele. Po ashtu, u informuan se janë zhvilluar trajnime profesionale mbi avancimet dhe zhvillimet e reja të sistemeve kadastrale, ku morën pjesë rreth 1,250 zyrtarë nga institucione të ndryshme. Delegacioni u njoftua edhe për lansimin më të fundit, atë të Gjeoportalit të ri shtetëror, i cili përfshin funksione të reja dhe rrit ndjeshëm transparencën dhe qasjen e qytetarëve në të dhënat kadastrale.

Takimi u përmbyll me vlerësime pozitive për arritjet e deritanishme dhe me zotimin për vazhdimin e bashkëpunimit në drejtim të modernizimit të mëtijshëm të sistemit kadastral në Kosovë.





17

**PLANI I PUNËS PËR
VITIN 2026 - REFORMA
DHE PROJEKTET**

17 PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026 - REFORMAT DHE PROJEKTET

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e saja, Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2026 do të vazhdojë me dinamikën e implementimit të aktiviteteve të filluara gjatë vitit 2025 për zhvillimin dhe modernizimin e Kadastrit, sipas Strategjisë dhe Planit të Biznesit të AKK-së 2021- 2025.

Këto aktivitete kryesisht janë pjesë e projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), i financuar nga kredia e Bankës Botërore. Ky projekt ka për qëllim të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, vazhdimin e punëve për rindërtimin e kadastrit në 115 Zona Kadastrale, krijimin e kadastrit të përçojave, përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK), kompletimin e Sistemit të Adresave, zhvillimin e mëtejshëm të Teknologjisë Informative të AKK-së, dhe zbatimin e Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH) në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu Agjencia Kadastrale gjatë vitit 2026 planifikon të vazhdojë edhe me zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të nivelimit, avancimin e Infrastrukturës së TI-së, mirëmbajtjen e SIKTK-së etj.

Nr.	Aktivitetet kryesore	Periudha Kohore
1.	Hartimi i strategjisë për implementimin e ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme	2026
2.	Korrektimi i të dhënave në SIKTK	2026
3.	Rindërtimi i Kadastrit, në 115 Zona Kadastrale	2025 - 2026
4.	Kontrolli i Kualitetit për projektin e Rindërtimit të Kadastrit	2025 - 2026
5.	Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik	2024 - 2026
6.	Renovimi i Zyreve Kadastrale Komunale në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës	2025 - 2026
7.	Finalizimi i sistemit të adresave në Komunitet Veriore	2026
8.	Zhvillimi i pilot projektit për kadastrin e përçojave	2026
9.	Lidhja e sistemit të adresave me regjistrin civil	2025 -2026
10.	Zhvillimi i mobil aplikacionit/navigacionit për Kosovë (ARIS Mobile)	2025 - 2026
11.	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive – Rendi i dytë	2025 - 2026
12.	Mirëmbajtja e sistemit të informacioneve kadastrale të tokave të Kosovës	2025 -2026
13.	Avancimi i Infrastrukturës së TI-së	2026





Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency